

# Praktikat e mira evropiane në lidhje me zbatimin e metodologjive të vlerësimit të jashtëm

*PËRGATITUR NGA NISMA E EVROPËS JUGLINDORE PËR REFORMËN  
ARSIMORE (ERI SEE) NË KUADRIN E PROJEKTIT “RRITJA E CILËSISË  
SË ARSIMIT DHE FORMIMIT NË EVROPËN JUGLINDORE”,  
FINANCUAR NGA AGJENCIA AUSTRIAKE PËR ZHVILLIM ME FONDET  
E BASHKËPUNIMIT AUSTRIAK PËR ZHVILLIM*

Botues: Nisma e Evropës Juglindore për Reformën Arsimore, Dečanska 8, 11000 Beograd, Serbi

Recensues: Herman Franssen

Redaktorë: Herman Franssen, Tina Šarić

Koordinator: Milica Grahovac

Autorët:

Andreeva, Aneliya, Inspektorati Kombëtar i Arsimit (IKA), Bullgari

Arhiliuc, Liudmila, Agjencia Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsim dhe Kërkim (AKSCAK), Moldavi

Arnott, Mamta, Inspektorati i Madhërisë së Tij për Arsimin dhe Formimin, Uells

Baati, Mounir, Fondacioni Evropian i Trajnimit

Babović, Vesna, Instituti i Arsimit, Mali i Zi

Barata, Isabel, Inspektorati i Përgjithshëm i Arsimit dhe Shkencës, Portugali

Berilažić, Dragan, Instituti i Arsimit, Mali i Zi

Conneely, Suzanne, Departamenti i Arsimit, Irlandë

Čaprić, Gordana, Instituti për Cilësinë dhe Vlerësimin e Arsimit, Serbi

Çobaj, Teuta, Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), Shqipëri

Đelić, Jasmina, Ministria e Arsimit, Serbi

Fetiu Mjeku, Valbona, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Kosovë\*

Franssen, Herman, Ekspert për sigurimin e cilësisë, Holandë

Gashi, Defrim, Inspektorati i Arsimit, Kosovë\*

Gološ, Enisa, Instituti Pedagogjik Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë

Göthner, Anna, Universiteti i Stokholmit, Suedi

Gocevaska, Valentina, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Maqedonia e Veriut

Grabovac, Saša, Shkolla e mesme profesionale SSK Livno, Bosnje dhe Hercegovinë

Hoxhallari, Sara, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), Shqipëri

Hempel, Steffi, Agjencia e Cilësisë në Departamentin e Arsimit Shkollor në Shtetin Bavarez, Gjermani

Isahi Palloshi, Ardijana, Qendra për Arsim dhe Aftësim Profesional, Maqedonia e Veriut

Kaçuli, Etleva, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), Shqipëri

Koprivica, Vladislav, Qendra për Arsim dhe Aftësim Profesional, Mali i Zi

Krivokuća, Milja, Ministria e Arsimit, Serbi

Mac Fhlannchadha, Pádraig, Departamenti i Arsimit, Irlandë

Marković, Ivan, Qendra për Arsim dhe Aftësim Profesional, Mali i Zi

McEwan, Tracie, Inspektorati i Madhërisë së Tij për Arsimin, Skoci,

Micaelo, Rosa, Inspektorati i Përgjithshëm i Arsimit dhe Shkencës, Portugali

Nedeljković, Jelena, Instituti për Cilësinë dhe Vlerësimin e Arsimit (ICVA), Serbi

Nimani Binçe, Donjeta, Agjencia Kombëtare për Arsim, Aftësim Profesional dhe Kualifikime (AKAAPK), Kosovë\*

Oideachais, An Roinn, Departamenti i Arsimit, Qeveria Irlandeze

Orehovschi, Sergiu, Agjencia Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsim dhe Kërkim (AKSCAK), Moldavi

Petrov, Elena, Agjencia Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsim dhe Kërkim (AKSCAK), Moldavi

Popović, Biljana, Agjencia për Arsimin Parafillor, Fillor dhe të Mesëm të Ulët, Bosnjë dhe Hercegovinë

Preteni, Imer, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Kosovë\*

Reka, Fadil, Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), Shqipëri

Richet, Bertrand, Këshilli Francez për Vlerësimin e Shkollës, Francë

Schmidbauer, Margit, Agjencia e Cilësisë në Departamentin e Arsimit Shkollor në Shtetin Bavarez, Gjermani

Stojanoska, Antonela, Inspektorati Shtetëror për Arsim, Maqedonia e Veriut

Šaponjić, Vesna, Ministria e Arsimit, Serbi

Thornberg, Lars, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Suedi

Tonu, Tamara, Agjencia Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsim dhe Kërkim (AKSCAK), Moldavi

Vinell, Suzanne, Departamenti i Arsimit, Suedi

Vuković, Snežana, Ministria e Arsimit, Serbi

Për botuesin: Tina Šarić, Sekretariati i ERI SEE

Botuar: Beograd, prill 2024

ISBN-978-86-902616-6-6

# PRAKTIKAT E MIRA EVROPIANE NË LIDHJE ME ZBATIMIN E METODOLOGJIVE TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përmbajtja

PRAKTIKAT E MIRA EVROPIANE NË LIDHJE ME ZBATIMIN E METODOLOGJIVE TË VLERËSIMIT TË JASHTËM .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pjesa I.....	7
Hyrje.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pjesa II: Procesi i vlerësimit të jashtëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
A. Nisja e procesit të vlerësimit të jashtëm të një institucioni – Veprimtaritë përgatitore .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Bookmark not defined.</b>	
1. Zhvillimi i planit vjetor të vlerësimit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.1. Nisja e procesit të vlerësimit të jashtëm me bazë riskun – Bullgari.. .....	8
1.2. Përgatitja e vlerësimit të jashtëm (mbledhja e të dhënave dhe lidhja ndërmjet vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm) – Maqedonia e Veriut.....	10
1.3. Përgatitja e vlerësimit të jashtëm (mbledhja e të dhënave, analiza, caktimi i detyrave, përdorimi i rezultateve të anketës gjatë vlerësimit) – Mali i Zi.....	12
1.4. Rëndësia e të dhënave të dokumentit "Konteksi i Shkollës" në procesin e planifikimit të vlerësimit - Shqipëri .....	13
2. Komunikimi me shkollën për vizitën e inspektimit dhe mbledhja e rezultateve të vlerësimit të brendshëm për përgatitjen për inspektimin .....	15
2.1. Përgatitja për inspektimin e shkollave - Skoci.....	15
2.2. Takimi vjetor me drejtorët - Portugali .....	17
B. Vizita në terren/institucion .....	18
1. Organizimi i vizitës në terren .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.1. Shembull i metodologjisë së përbashkët dhe vizitës së përbashkët në terren si për arsimin e përgjithshëm ashtu edhe për AFP-në - Mali i Zi.....	18
1.2. Organizimi i vizitës në terren - Francë .....	20
1.3. Organizimi dhe kryerja e vlerësimit të jashtëm – Kosovë* .....	23
2. Vëzhgimi i procesit mësimor.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.1. Vëzhgimi i përbashkët në klasë me përfshirjen e vlerësuesit/ve të jashtëm dhe punonjësve të shkollës – Holandë .....	25
2.2. Vlerësimi i performancës së mësuesve – Kosovë*.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

2. 3. Studimi i modelit të vëzhgimi të orës së mësimi – Zyra për Standardet në Arsim, Shërbimet e Fëmijëve dhe Aftësitë (Ofsted) – Mbretëria e Bashkuar.....	28
3. Intervistat me aktorët përkatës (drejtuesit, mësuesit, nxënësit dhe palët e interesuara)....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.1. Intervistat shumëdimensionale – Bosnjë dhe Hercegovinë .....	32
3.2. Intervistat me drejtuesit e shkollës, mësuesit dhe nxënësit: Mbështetja e dialogut - Flanders/Holandë .....	34
3.3. Intervistat me bizneset, mentorët dhe instruktorët (udhëzimet për intervistat) – Moldavi .....	38
4. Nxjerrja e konkluzioneve nga vizita në terren.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1. Nxjerrja e konkluzioneve përfundimtare: Çfarë duhet bërë kur ka mospërputhje të të dhënave/evidencave – Maqedonia e Veriut .....	39
4.2. Përgatitja e konkluzioneve të vlerësimit të jashtëm: Si të garantojmë konsistencën dhe transparencën – Portugalia.....	42
C. Komunikimi i gjetjeve të vlerësimit të jashtëm .....	43
1. Takimi përmbyllës me shkollën për ndarjen e gjetjeve të vlerësimit të jashtëm.....	43
1.1. Si ta bëjmë më interaktiv takimin përmbyllës pas vlerësimit të jashtëm – Holandë.....	43
2. Raporti i shkruar nga vlerësimi i jashtëm .....	44
2.1. Veprimet e ndërmarra për të garantuar cilësinë e raporteve të vlerësimit të jashtëm të shkollave - Portugali.....	44
2.2. Manual për raportin e vlerësimit të jashtëm të shkollës: Standardizimi i mënyrës së shkrimit/përpilimit të tij – Portugali .....	46
2.3. Pse është i rëndësishëm publikimi i përmbledhjeve të raporteve nga vlerësimi i jashtëm – Maqedonia e Veriut .....	46
D. Specifikat e AFP-së.....	48
1. Vëzhgimi i mjedisit mësimor, mjeteve dhe pajisjeve – Kosovë* .....	48
2. Treguesit e bashkëpunimit mes shkollave dhe bizneseve - Bavari – Gjermani .....	50
3. Gjurmimi i të diplomuarve - Uells .....	53
4. Treguesit përkatës për vlerësimin e jashtëm të programeve të arsimit dhe formimit profesional dual - Moldavi.....	54
5. Treguesit specifike për AFP-në në kuadër të AFP-së së përbashkët dhe metodologjisë së përgjithshme – Mali i Zi.....	57
6. Kontrollimi i kushteve të mjedisit mësimor në biznese dhe në shkolla dhe i mënyrës se si punojnë operatorët e biznesit me fëmijët gjatë praktikës profesionale - Kosovë* .....	59
7. Vlerësimi i jashtëm i programeve të studimit të AFP-së - Moldavi .....	61
8. Standardet dhe treguesit rajonalë të cilësisë për AFP-në dhe Të Nxënët nëpërmjet Punës në shkolla dhe në biznese – projekti EQET SEE .....	63

Pjesa III: Puna pas vlerësimit të jashtëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
A. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit të jashtëm në nivel shkolle .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. Hartimi dhe zbatimi i Planit për Zhvillimin e Shkollës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.1. Hartimi i planeve strategjike institucionale të institucioneve të AFP-së – Bosnjë dhe Hercegovinë .....	63
1.2. Hartimi dhe zbatimi i Planit për Zhvillimin e Shkollës – Uells .....	66
1.3. Plani i zhvillimit të shkollës bazuar në raportet e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm – Shqipëri .....	67
2. Monitorimi i punës për zbatimin e planit të zhvillimit të shkollës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.1. Roli i Vlerësimit të Brendshëm në monitorimin e punës për realizimin e Planit të Zhvillimit të Shkollës dhe të rekomandimeve të dala nga Vlerësimi i Jashtëm - Uells .....	70
B. Mbështetja e shkollave në punën për realizimin e përmirësimeve ..	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. Realizimi i Raportit të Vetëvlerësimit dhe mbështetja për shkollat me performancë më të ulët – Skoci .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2. Mbështetja e shkollave me performancë më të ulët për përmirësimin e cilësisë së arsimit të tyre: Brigada Fluturuese – Holandë .....	72
3. Mbështetja nga kolegët - Serbi .....	74
PIESA IV: Vlerësimi i jashtëm në nivel sistemi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. Raportet vjetore për cilësinë e arsimit .....	77
1.1. Ndikimi strategjik i raportimit vjetor dhe ciklik mbi cilësinë e shkollave dhe të sistemit arsimor – Serbi .....	77
1.2. Gjendja e Arsimit: Raportet vjetore që vlerësojnë mënyrën e funksionimit të sistemit arsimor në tërësi – Holandë .....	80
2. Vlerësimi tematik .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.1. Vlerësimi tematik/ fokusimi në fusha ose tema specifike - Suedi .....	84
2.2. Parimet e inspektimit tematik dhe zbatimi i tij – Skoci .....	85
3. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe metodologjisë së vlerësimit të jashtëm – Serbi ..	87
3.1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor – Uells .....	89
4. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit arsimor për të marrë pjesë në vlerësimin e jashtëm ..	90
4.1. Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve të aktorëve të shkollës për të marrë pjesë në inspektim/vlerësim të jashtëm dhe vetëvlerësim - Irlandë .....	90
4.2. Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve të inspektorëve përfaqësues të shkollave – Uells .....	92
4.3. Zhvillimi i njohurive dhe aftësive në fushën arsimore - Uells .....	93

4.4. Roli i inspektorëve vullnetarë dhe përfaqësuesve të shkollave në ekipet e vlerësimit të jashtëm dhe ngritja e kapaciteteve të tyre - Uells.....	94
PJESA V. Sigurimi i cilësisë së procesit të vlerësimit të jashtëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. Rregullat dhe procedurat e brendshme në nivel të agjencive përgjegjëse për sigurimin e cilësisë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.1. Procedurat e brendshme për ekipin e vlerësimit të jashtëm – Kosovë* .....	95
1.2. Procedurat e brendshme të agjencisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë që rregullon zbatimin e vlerësimit të jashtëm - Mali i Zi .....	97
2. Mbikëqyrja e vlerësimit të jashtëm .....	99
2.1. Mbikëqyrja e raporteve të vlerësimit të jashtëm – Maqedonia e Veriut .....	99
2.2. Hapat e ndërmarrë për të garantuar cilësinë e raporteve të vlerësimit të jashtëm – Skoci .....	100
2.3. Çfarë bën Inspektorati për të kontrolluar, monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e punës së tyre? – Holanda .....	102
2.4. Shembuj të aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në nivelin e agjencisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë – Francë .....	106
3. Besueshmëria e gjykitimit dhe përdorimi i kritereve të përbashkëta. <b>Error! Bookmark not defined.</b>	
3.1. Shembuj të peshimit të standardeve sipas rëndësisë së tyre – Mali i Zi .....	108
3.2. Ndërtimi i konsensusit dhe i koncepteve të përbashkëta në Vlerësimin e Jashtëm të Shkollave në Portugali .....	110
4. Trajnimet dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) i vlerësuesve të jashtëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1. Trajnimet dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) i vlerësuesve të jashtëm me ushtrime simulimi – Shqipëri .....	111
4.2. Modulet e trajnimeve dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZHVP) të vlerësuesve të jashtëm – Serbi .....	114
4.3. Trajnimet dhe ZHVP i vlerësuesve të jashtëm dhe përmbajtja e tyre – Moldavi .....	116
5. Pavarësia e vlerësimit të jashtëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.1. Pavarësia e vlerësimit të jashtëm dhe besueshmëria e gjykimeve – Shqipëri .....	119
5.2. Pavarësia e vlerësimit të jashtëm – Maqedonia e Veriut .....	122
6. Reagimet/mendimet nga shkollat për të përmirësuar vlerësimin e jashtëm.. <b>Error! Bookmark not defined.</b>	
6.1 Reagimet/mendimet nga shkollat për të përmirësuar vlerësimin e jashtëm - Serbi .....	123
6.2. Reagimet/mendimet nga shkollat pas inspektimit dhe si përdoren ato më tej – Holandë .....	125
6.3. Reagimet/mendimet nga shkollat dhe nga vlerësuesit përmes pyetësorëve online – Portugali .....	127
7. Mbikëqyrja e vlerësimit të jashtëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

7.1. "Praktikoni atë që predikoni" - Vlerësimi i inspektoratit përmes auditimeve të jashtme dhe të brendshme - Holandë.....	128
8. Vlerësimi nga kolegët.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
8.1. Vizitat e kolegëve në kontekstin e forumit të ETF-së për Sigurimin e Cilësisë.....	130
8.2. Vëzhgimi i punës së kolegëve në praktikë nga inspektorët për të përmirësuar cilësinë e punës – Holandë.....	132
9. Digjitalizimi i proceseve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
9.1. Digjitalizimi i proceseve për raportin e vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së – Kosovë*.....	133
9.2. Zbatimi digjital i vizitës në terren - Bullgari.....	135
9.3. Sistemi për Menaxhimin Elektronik të Inspektimeve – Bullgari.....	136
Pjesa VI: Aspektet mjedisore, sociale dhe gjinore.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. Përfshirja sociale dhe mirëqenia.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.1. Procesi i vlerësimit të mirëqenies, barazisë dhe përfshirjes sociale - Skoci.....	138
1.2. Standardet dhe treguesit për përfshirje sociale - Serbi.....	139
1.3. Njohja e pabarazive sociale dhe gjinore.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2. Treguesit për tolerancën zero ndaj dhunës (përfshirë dhunën digjitale).....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.1. Sigurimi dhe monitorimi i një sistemi që mbështet tolerancën zero ndaj dhunës – Serbi.....	141
3. Treguesit për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta/ shkollave të arsimit special.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.1. Treguesit për vlerësimin e arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta/ shkollat e arsimit special – Holandë.....	144
3.2. Treguesit për vlerësimin e praktikave gjithëpërfshirëse të shkollave – Portugali.....	148
4. Aspektet mjedisore.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1. Edukimi për Zhvillimin e Qëndrueshëm – Projekti EQET SEE.....	150

# Pjesa I

## Hyrje

Ky material sjell para jush një përmbledhje të praktikave të mira, të ilustruara me shembuj të ndryshëm të punës për zbatimin e metodologjive të vlerësimit të jashtëm në rajonin e Evropës Juglindore, në Republikën e Moldavisë dhe në disa vende të Bashkimit Evropian. Ky publikim synon të bëjë të mundur krahasimin ndërmjet proceseve, të prezantojë disa praktika novatore, interesante dhe të dobishme për vlerësimin e jashtëm dhe të frymëzojë zhvillimet dhe përmirësimet e mëtejshme në punën për zbatimin e metodologjive ekzistuese nëpërmjet integritit dhe përshtatjes së praktikave të disa vendeve në metodologjitë e vendeve të tjera.

Ky publikim është rezultat i analizës së metodologjive ekzistuese për vlerësimin e jashtëm në Evropën Juglindore dhe në Republikën e Moldavisë, identifikimin e nevojave kritike për përmirësim si dhe të praktikave të mira, dhe hartëzimin e praktikave të mira evropiane që mund të kontribuojnë në përmirësimin e mëtejshëm të këtyre proceseve në rajonin e Evropës Juglindore.

Publikimi përfshin një numër mbresëlënës kontributesh dhe praktikash – ai është përgatitur në bashkëpunim me më shumë se 20 institucione të ndryshme me ekspertizë të nivelit të lartë dhe përvojë të gjatë në çështjet e sigurimit të cilësisë. Si rezultat, ai përmban më shumë se 70 shembuj konkretë të segmenteve të ndryshme të praktikave të vlerësimit të jashtëm. Struktura e tij ndjek rendin e zakonshëm të procesit të vlerësimit të jashtëm, që nga fazat përgatitore, vizitat në terren, analizimi i të dhënave, komunikimi me shkollat, dorëzimi i drafteve e deri tek raportet përfundimtare. Publikimi përmban edhe disa këndvështrime të ndryshme në lidhje me relevancën më të gjerë të vlerësimit të jashtëm – ndikimin e tij në sistemet arsimore dhe në politikëbërje. Gjithashtu, ai përmban edhe një kapitull të posaçëm për sigurimin e cilësisë së vetë proceseve të vlerësimit të jashtëm – institucionet përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm duhet që, me anën e shembullit të tyre dhe fokusimit të punës tek cilësia dhe siguri i cilësisë, të shërbejnë si fanarë për institucionet e tjera dhe të udhëheqin me anën e shembullit. Praktikant shoqërohen me shtojca ose linqe ku mund të gjeni informacion më të detajuar për temën në fjalë. Shtojcat mund të gjenden në formë digjitale në:

<https://eqet.erisee.org/analysis-of-external-evaluation-methodologies/> dhe <https://www.erisee.org/erisee-publications/>.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit 'Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit dhe Formimit në Evropën Juglindore' (EQET SEE), që zbatohet nga Nisma e Evropës Juglindore për Reformën Arsimore (ERI SEE) si partner kryesor, dhe në bashkëpunim me agjencitë përgjegjëse për arsimin dhe sistemet e vlerësimit të jashtëm në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë\*, Mal të Zi, në Republikën e Moldavisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Serbi.<sup>1</sup> Projekti financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fonde nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe bashkëfinancohet nga ERI SEE.

---

<sup>1</sup> Ato janë: ASCAP - Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Shqipëri; AKAFPK - Agjencia Kombëtare për AFP-në dhe Kualifikimet, Shqipëri; AAPFM - Agjencia për Arsimin Parashkollor, Fillor dhe të Mesëm të Ulët, Bosnjë dhe Hercegovinë; AKK – Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Kosovë\*; AKSCAK – Agjencia Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsim dhe Kërkim, Moldavi; BSHA – Byroja për Shërbime Arsimore, Mali i Zi;

Me qëllim përmirësimin e analizës së cilësisë dhe përdorimin e të dhënave për politikëbërje, forcimin e kulturës së cilësisë në nivel shkolle dhe të cilësisë së punës së vlerësuesve të jashtëm në arsimin para-terciar në rajonin e EIL-së, pjesa e projektit **EQET SEE** që mbulon çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm të institucioneve fokusohet në punën për **mbështetjen e zhvillimeve të jashtme të cilësisë dhe kulturës së cilësisë në nivel shkolle**, nëpërmjet zhvillimit të mjeteve dhe instrumenteve mbështetëse për zbatimin e metodologjive ekzistuese të vlerësimit të jashtëm.

Si e tillë, mendohet se kjo **përmbledhje e praktikave të mira evropiane në lidhje me zbatimin e metodologjive të sigurimit të cilësisë (SC), instrumenteve dhe mjeteve përkatëse shoqëruese**, do të kontribuojë në aktivitetet bashkëpunuese ndërmjet shkollave, agjencive të sigurimit të cilësisë, përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm të institucioneve, dhe palëve të tjera të interesit; do të shërbejë si burim reflektimi, analize dhe frymëzimi për formëzimin e proceseve të reja; do të mundësojë pilotimin e këtyre proceseve në situata reale, si dhe do të mbështesë punën për përmirësimin e proceseve të vlerësimit të jashtëm.

Të gjithë termat e përdorura në këtë material (inspektor, vlerësues, mësues, prind, nxënës, drejtor etj.) i referohen si gjinisë femërore ashtu dhe asaj mashkullore.

## Pjesa II: Procesi i vlerësimit të jashtëm

### A. Nisja e procesit të vlerësimit të jashtëm të një institucioni – Veprimtaritë përgatitore

Ky kapitull përmbledh praktikën e përbashkëta midis ekonomive të EIL-së dhe Moldavisë si dhe vendeve të BE-së që zhvillohen në fillim të vlerësimit të jashtëm të një institucioni dhe përpara vizitës në terren/institucion. Vlerësimi përfshin:

#### 1. Hartimi i planit vjetor të vlerësimit

##### *1.1. Nisja e procesit të vlerësimit të jashtëm me bazë riskun – Bullgari*

Autor: Aneliya Andreeva, PhD

Parimet dhe metodat e përzgjedhjes janë pjesë e planit të inspektimit për vitin e ardhshëm shkollor. Këto parime janë: lokaliteti, lloji i institucionit, metoda e “analizës së riskut”.

Metoda e “analizës së riskut” është pjesë e procesit të menaxhimit të riskut. Analiza e riskut përfshin shqyrtimin e arsyeve dhe burimeve të riskut, si dhe faktorët që mund të ndikojnë në pasojat dhe

---

Qendra për AFP, Mali i Zi; ISHA – Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Maqedonia e Veriut; BZHA - Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Maqedonia e Veriut; Qendra e AFP-së, Maqedonia e Veriut; ICVA – Instituti për Cilësinë dhe Vlerësimin e Arsimit, Serbi.

probabilitetin e skenarëve që paraqesin rrezikshmëri. Gjithsesi, prania e faktorëve të riskut nuk nënkupton se një kopsht apo shkollë nuk ofron arsim cilësor, por vetëm rrit probabilitetin që të mos ndodhë.

Faktorët e riskut në procesin e mësimdhënies dhe të organizimit të veprimtarive në një kopsht/shkollë do të indentifikohen duke përdorur burimet përkatëse të informacionit si të **dhënat historike, përvoja, reagimet/mendimet, vëzhgimet, analizat dhe vlerësimet e ekspertëve**. Analiza e ndikimit të këtyre faktorëve do të kontribuojë në përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të riskut, një element thelbësor që duhet përfshirë në planin e inspektimit.

Nëpërmjet zbatimit të **metodës së “analizës së riskut”**, Inspektorati Kombëtar Bullgar i Arsimit (IKA) ka përgatitur **një model që përbëhet nga kriteret e mëposhtme:**

1. Vlerësimi nga inspektimet e mëparshme: niveli më i ulët i vlerësimit: i pakënaqshëm ose i kënaqshëm.
2. Specifikat e kopshtit/shkollës:
  - numri i fëmijëve dhe nxënësve nga grupet vulnerabël;
  - grupmosha të përziera;
  - orë mësimi me nivele të përziera;
  - numri i fëmijëve/nxënësve nën nivelet standarde;
  - përqindja e nxënësve që përsërisin të njëjtin vit për shkak të rezultateve të dobëta, etj.;
3. Rezultatet vazhdimisht të ulëta mësimore dhe rezultatet e dobëta në vlerësimet e jashtme kombëtare pas çdo faze arsimore: klasa e 4-të, e 7-të dhe e 10-të/ provimet e maturës shtetërore për 4 vitet e mëparshme.
4. Përqindja e të diplomuarve të shkollave të mesme në krahasim me numrin e përgjithshëm të të diplomuarve.
5. Informacioni për kushtet e kopshteve/shkollave.
6. Rezultatet nga vlerësimet e brendshme (vetëvlerësimi) të cilësisë së ofertës arsimore (pas hyrjes në fuqi të Urdhëresës për Menaxhimin e Cilësisë Institucionale).

Vlerësimi i jashtëm është një instrument që mund të ketë ndikim mbi faktorët e riskut. Inspektimi do të ndihmojë për identifikimin e prioriteteve në lidhje me riskun dhe nevojat për zhvillim, shoqëruar më pas edhe me udhëzimet përkatëse për përmirësimin e aktiviteteve të caktuara. Inspektorët do të ndihmojnë ekipin e kopshtit/shkollës për të menaxhuar më mirë faktorët e riskut dhe për të minimizuar pasojat e tyre nëpërmjet zbatimit të masave specifike dhe ndjekjes së disa hapave të caktuar.

Gjatë vitit akademik 2023/2024, Inspektorati Kombëtar do të kryejë inspektime të përsëritura për të verifikuar zbatimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna dhe për të vlerësuar cilësinë e ofertës arsimore në nivel parashkollor dhe shkollor në ato shkolla që kanë marrë një vlerësim të kënaqshëm në njërën nga tre fushat dhe në shkollat që kanë marrë një vlerësim të pakënaqshëm në njërën nga tre fushat. Ekipi i inspektimit kontrollon se si janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin e mëparshëm dhe bën sërish një vlerësim të plotë të cilësisë.

Përgatitja e vlerësimit të jashtëm (mbledhja e të dhënave, analiza, caktimi i një ekipi të veçantë për vlerësimin e jashtëm për një shkollë dhe program specifik).

## *1.2. Përgatitja e vlerësimit të jashtëm (mbledhja e të dhënave dhe lidhja ndërmjet vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm) – Maqedonia e Veriut*

Autorë: Antonela Stojanoska, Valentina Gocevska, Ardijana Isahi Palloshi

Në procesin e zbatimit të vlerësimit integral, një nga gjërat shumë të rëndësishme që duhet patur parasysh është marrja e mendimit të të gjitha palëve të përfshira në procesin mësimor të institucionit arsimor ku do të kryhet vlerësimi integral (matja e cilësisë së punës së atij institucioni).

Për këtë qëllim organet e vlerësimit të jashtëm kanë përgatitur një numër të madh instrumentesh, të cilat i dorëzohen institucionit arsimor 15 ditë përpara procesit të fazës së zbatimit. Drejtuesi i grupit të inspektimit që kryen vlerësimin integral viziton shkollën të paktën 15 ditë përpara fillimit të këtij vlerësimi, e njej drejtorin e shkollës me të gjitha objektivat dhe aktivitetet që do të kryhen gjatë fazës së zbatimit dhe më pas i dorëzon atij të gjitha instrumentet dhe pyetësorët që duhet të plotësohen gjatë fazës përgatitore dhe t'i dërgohen përsëri drejtuesit të ekipit të inspektimit. Të gjitha këto synojnë njohjen e të gjithë anëtarëve të ekipit të inspektimit me rezultatet e instrumenteve dhe pyetësorëve përpara se të paraqiten në shkollë për zhvillimin e vlerësimit integral.

Si praktikë e mirë, pyetësori është një instrument në të cilin drejtori i institucionit arsimor duhet të shprehë vëzhgimet/vërejtjet e tij për të gjitha segmentet e punës së shkollës dhe të paraqesë perceptimin e tij për cilësinë e punës në institucionin që drejton.

Ai duhet të shprehë vëzhgimet e tij dhe vlerësimin e punës bazuar në elemente të tilla si:

- dokumentacioni i shkollës;
- informacioni i regjistruar në procesverbalin pedagogjik të mbajtur në shkollë;
- vizitat vëzhguese të orëve të mësimin në shkollë;
- realizimi i trajnimit praktik;
- vetëvlerësimi i kryer në shkollë;
- përfshirja e shkollës në projekte, e të tjera.

Duke vepruar kështu, drejtori do të arrijë të bëjë një vlerësim sa më real të shkollës dhe do të tregojë se në çfarë niveli janë situatat dhe aktivitetet e paraqitura në pyetësor të përfaqësuara në punën e përditshme të shkollës.

Drejtori duhet të thotë se çfarë ka të veçantë shkolla e cila drejtohet nga ai dhe çfarë e bën atë të dallohet nga shkollat e tjera.

Përveç kësaj, pyetjet e pyetësorit shoqërohen me vlerësimin sipas shkallës: *jo i kënaqshëm, 1, 2, 3, 4 ose shkëlqyeshëm*, dhe atij i duhet të mbështesë secilin prej vlerësimeve me provat përkatëse.

*Shembull. Cilat janë rezultatet e mësimdhënies: jo të kënaqshme, 1,2,3,4 ose të shkëlqyera*

*Nga e dini këtë? Në cilët tregues bazohet mendimi juaj?*

Pyetësori drejtuar drejtorit përmban pyetje nga të shtatë fushat e vlerësuara gjatë fazës së zbatimit.

Gjatë plotësimit të pyetësorit, drejtori duhet të ketë parasysh edhe vetëvlerësimin e kryer në shkollën e tij, dhe me siguri anët e mira dhe të dobëta të identifikuara nga vetëvlerësimi do ta ndihmojnë për të dhënë përgjigjet e tij në mënyrë sa më realiste.

Pas përfundimit të fazës së zbatimit, ekipi i inspektimit zhvillon një takim përfundimtar me drejtorin e shkollës, gjatë të cilit drejtuesi i grupit të inspektimit e informon atë në lidhje me gjetjet e para të konstatuara nga procesi i vlerësimit të cilësisë së punës edukative në shkollë.

Natyrisht, brenda tre javësh pas përfundimit të fazës së zbatimit, ka një fazë njoftimi ku shkollës i dorëzohet Raporti për vlerësimin e integruar, përmes të cilit të gjitha palët e interesuara në shkollë njoftohen në lidhje me vlerësimin përfundimtar të punës së shkollës, se sa përkon ai me vetëvlerësimin e shkollës dhe me mendimin e drejtorit të institucionit për punën dhe procesin edukativo-mësuesor.

**Shtojca:**

- Pyetësor për drejtorin e shkollës.
- Pyetësor për mësuesit.
- Pyetësor për prindin/kujdestarin e nxënësit.
- Pyetësor për nxënësit.



### *1.3. Përgatitja e vlerësimit të jashtëm (mbledhja e të dhënave, analiza, caktimi i detyrave, përdorimi i rezultateve të anketës gjatë vlerësimit) – Mali i Zi*

Autor: Dragan Berilažić

Përgatitja e vlerësimit të jashtëm – parambikëqyrja – përfshin (ndër të tjera) zhvillimin e anketës në formë elektronike me nxënësit, mësuesit dhe prindërit e shkollës/institucionit ku po kryhet vlerësimi. Drejtuesi i ekipit të vlerësimit, përgjegjës për një institucion të caktuar, kryen anketën elektronike nëpërmjet kodeve QR për nxënësit, mësuesit dhe prindërit, të cilat mblidhen më pas dhe ruhen në një bazë të dhënash të posaçme që i referohet institucionit përkatës. Rezultatet e anketës vihen në dispozicion të të gjithë anëtarëve të ekipit të vlerësimit. Zhvillimi paraprak i anketës e ndihmon drejtuesin e ekipit të vlerësimit për të caktuar detyrat sipas fushave kryesore, bazuar në rezultatet e anketës dhe në problematikat e evidentuara nga rezultatet e anketës (p.sh. nëse rezultatet e anketës flasin për një tendencë negative në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e institucionit, ajo pjesë e vlerësimit do t'i delegohet një vlerësuesi që ka më shumë përvojë ose lidhje me atë fushë të caktuar kyçe, etj.).

Zakonisht drejtuesi i ekipit të vlerësimit evidenton dhe thekson para anëtarëve të ekipit të gjitha aspektet negative të identifikuar në anketë, në mënyrë që t'u kushtohet vëmendje e veçantë gjatë procesit të vlerësimit. Gjatë vlerësimit, vlerësuesit zhvillojnë diskutime të thelluara me nxënësit, mësuesit dhe përfaqësuesit e prindërve në lidhje me një problematikë të caktuar. Për shembull, nëse rezultatet e anketës flasin për praninë e formave të ndryshme të dhunës mes nxënësve, gjatë vizitës së tyre në institucion vlerësuesit do të insistojnë në kryerjen e intervistave të thelluara me përfaqësuesit e Parlamentit të Nxënësve të të gjitha klasave, ndoshta në një seancë të plotë, pastaj me organet profesionale dhe drejtuesit e institucionit. Në raste të tilla, vëmendje e veçantë i kushtohet shqyrtimit të dokumentacionit për të krijuar një tablo të qartë në lidhje me një problem të caktuar dhe për të siguruar që rekomandimet që do t'i jepen institucionit të reflektojnë siç duhet mënyrën e korrigjimit të mangësive. Bisedat sistematike me nxënësit dhe prindërit, gjatë qëndrimit të tyre në institucion, mund të ndihmojnë për të kuptuar më me saktësi problematikat e shumta që ekzistojnë në nivel institucioni (p.sh. zhvillimi i orëve shtesë dhe plotësuese, respektimi i kohës së lirë, aktivitetet jashtëshkollore, etj.). Shembujt e lartpërmendur në lidhje me komunikimin formal dhe joformal e ndihmojnë ekipin e vlerësimit për nxjerrjen e konkluzioneve dhe vlerësimin e duhur të fushave kryesore.

#### **Shtojca:**

- Pyetjet e anketës për nxënësit.
- Pyetjet e anketës për mësuesit.
- Pyetjet e anketës për prindërit.

#### 1.4. Rëndësia e të dhënave të dokumentit "Konteksti i shkollës" në procesin e planifikimit të vlerësimit - Shqipëri

Autorë: Teuta Çobaj, Fadil Reka

Procesi i vlerësimit të të gjithë shkollës në sistemin arsimor shqiptar kalon në tre faza që janë evidente edhe në përvojat e sistemeve të tjera arsimore: faza e paravlerësimit/inspektimit, faza e inspektimit të shkollës dhe faza e shkrimit/përpilimit të raportit.

##### *Dokumentacioni që duhet të sigurohet nga shkolla në fazën e paravlerësimit*

Institucioni vlerësues i kërkon drejtorit të shkollës paraqitjen e të dhënave në lidhje me veprimtarinë mësimore-edukative të shkollës. Shkolla i dërgon të dhënat brenda 2-3 ditëve nga njoftimi i marrë për kryerjen e procesit të vlerësimit. Dokumentacioni që kërkohet nga shkolla është:

- Konteksti i shkollës;
- Plani afatmesëm i shkollës;
- Plani vjetor i shkollës;
- Plani i përmirësimit;
- Raporti vjetor i shkollës;
- Raporti i vlerësimit të brendshëm të shkollës;
- Analiza vjetore;
- Lista e personelit mësimor dhe ngarkesa mësimore;
- Orari mësimor;
- Vlerësimi nga drejtori i shkollës;
- Vlerësimi nga mësuesit;
- Zhvillimi profesional dhe plani i ekipit lëndor;
- Plani i psikologut/punonjësit social/oficerit të sigurisë;
- Planet e organeve kolegjiale;
- etj.

Në dosjen e dokumenteve të mësipërme, dokumenti 'Konteksti Shkollor' përbën një risi. Në këtë dokument shkolla duhet të paraqesë disa të dhëna të strukturuar të detyrueshme, të cilat bëjnë të mundur kryerjen e një analize sa më objektive të shkollës, e cila shërben më pas si bazë për të dy proceset: vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm. Të dhënat e strukturuar pasqyrojnë ndryshimet e ndodhura si në sistemin arsimor ashtu edhe në shkollë gjatë tre viteve të fundit.

Dy nga karakteristikat më të rëndësishme të dokumentit "Konteksti shkollor":

##### **a) Vlerësimi i brendshëm i shkollës për tre vitet e fundit**

Fushat e cilësisë	2016-2017	2017-2018	2018-2019
Drejtimi dhe menaxhimi			
Cilësia e mësimdhënies dhe të nxënësve			
Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve			
Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve			

Vlerësimi i brendshëm i shkollës			
----------------------------------	--	--	--

**b) Arritjet e nxënësve sipas lëndëve për çdo klasë në fund të një viti shkollor, gjatë tre viteve të fundit (Shembulli i mëposhtëm mbulon vetëm një fushë. Shkolla dërgon të dhëna për arritjet e nxënësve për të gjitha fushat kurrikulare)**

Fushat kurrikulare	Arritjet e nxënësve (në %)	Klasa ____				Klasa ____				Klasa ____				Në nivel shkolle		
		2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2016-2017	2017-2018	2018-2019
Gjuha dhe komunikimi	Nxënësit e vlerësuar me notat 9 dhe 10															
	Nxënësit e vlerësuar me notat 7 dhe 8															
	Nxënësit e vlerësuar me notat 5 dhe 6															
	Nxënësit mbetës															

**Vënia në dispozicion e të dhënave kontekstuale e ka bërë më të lehtë procesin e vlerësimit të shkollës, pasi ka ndihmuar në punën për përcaktimin e programit të aktiviteteve dhe të metodologjisë efikase që do të përdoret gjatë procesit të vlerësimit.**

Shtojcë:

- Strukturimi i të dhënave në dokumentin "Konteksti i shkollës".

## 2. Komunikimi me shkollën për vizitën e inspektimit dhe mbledhja e rezultateve të vlerësimit të brendshëm për përgatitjen e inspektimit

### 2.1. Përgatitja për inspektimin e shkollave - Skoci

Autor: Tracie McEwan

Agjencia *Education Scotland* përpiqet të sigurojë që përvoja e inspektimit të jetë sa më pozitive që nga fillimi i procesit të inspektimit. Administratori i inspektimit fillimisht informon autoritetin arsimor vendor në lidhje me inspektimin që do të kryhet. Vetë shkolla informohet me anën e postës elektronike të paktën dy javë e gjysmë përpara fillimit të inspektimit.

Në ditën kur dërgohet njoftimi i inspektimit, administratori i caktuar për kryerjen e inspektimit i telefonon drejtorit për të diskutuar në lidhje me ndikimin e mundshëm të inspektimit në aktivitetin e shkollës. Kjo përfshin edhe qartësimin e kërkesave tona për shkollën, si për shembull, plotësimi i formularit të vetëvlerësimit, mbledhja e të dhënave për treguesit e cilësisë dhe përgatitja e një relacioni në lidhje me aktivitetet e tyre për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve. Ky është kontakti i parë me shkollën në lidhje me inspektimin, kështu që administratorët tanë përpiqen të sillen sa më ngrohtë dhe në mënyrë miqësore. Ata do të njihen me drejtorin dhe do të garantojnë që ky i fundit të ndihet sa më i qetë gjatë të gjithë procesit.

Menjëherë pas kësaj, Inspektori Administrativ (IA) planifikon zhvillimin e një takimi me përfaqësuesit e shkollës. Kjo tani zakonisht bëhet virtualisht nëpërmjet takimit në distancë në internet. Takimi i parë mund të zgjasë deri në një orë dhe do të shërbejë për qartësimin e procesit për shkollën dhe drejtorin vetë. Kjo zakonisht realizohet rreth dhjetë ditë para inspektimit.

Inspektori Administrativ planifikon edhe një telefonatë ose takim virtual me drejtorin. Kjo ndodh rreth pesë ditë para inspektimit.

Inspektorët e Madhërisë së Tij përdorin një qasje ndërpersonale të quajtur korniza *PRAISE*. Kjo kornizë i mbështet inspektorët për zhvillimin e bisedave pozitive dhe konstruktive me punonjësit e shkollës gjatë kohëzgjatjes së inspektimit. Kjo fillon me një telefonatë fillestare nga një punonjës i administratës tonë dhe përforcohet me telefonatën/takimin fillestar ndërmjet drejtuesit të shkollës dhe Inspektorit Administrativ.

Parimet e mëposhtme - **korniza *PRAISE*** (në gjuhën angleze akronim për parimet e mëposhtme) - janë identifikuar si parimet bazë për praktikatat më të mira:

**Qëllimi** – të qenit të qartë në lidhje me qëllimin e përgjithshëm të inspektimit/vlerësimit dhe ruajtja e kësaj qartësie gjatë gjithë kohës. Përgatitja e një agjende të përbashkët midis personelit të organizatës dhe anëtarëve të ekipit të inspektimit/vlerësimit.

**Marrëdhëniet** – ndërtimi dhe ruajtja e marrëdhënieve konstruktive gjatë gjithë procesit, si bazë për garantimin e një inspektimi/vlerësimi sa më cilësor.

**Ndërgjegjësimi** – ruajtja e nivelit të lartë të ndërgjegjësimit për kontekstin në të cilin punon personeli, për ndjenjat dhe reagimet e tyre ndaj procesit dhe për qasjen e vetë inspektorit dhe ndikimin e saj.

**Mbledhja e informacionit** – drejtimi i kujdesshëm i pyetjeve për të mbledhur dhe analizuar të dhënat/evidencat. Mbajtja e një qëndrimi objektiv, testimi i supozimeve dhe asimilimi i të dhënave përpara vlerësimit.

**Ndarja e informacionit** – komunikimi efektiv gjatë gjithë procesit për të përgatitur dhe informuar personelin. Inkurajimi i personelit për të qenë sa më të hapur në shprehjen e mendimit dhe këndvështrimit të tyre dhe ndarja e gjetjeve edhe gjatë procesit të inspektimit/vlerësimit.

**Krijimi i mundësive** - trajtimi i njerëzve me respekt, angazhimi i tyre në dialog profesional, njohja e përpjekjeve të tyre dhe shkëmbimi i gjetjeve në mënyrë konstruktive për të inkurajuar përgjegjësisë dhe lehtësuar të nxënit.

## 2.2. Takimi vjetor me drejtorët - Portugali

Autorë: Isabel Barata dhe Rosa Micaelo

Në Portugali, shkollat informohen paraprakisht nga Inspektorati se do t'i nënshtrohen vlerësimit të jashtëm.

Në fund të çdo viti shkollor, Kryeinspektori iu dërgon një mesazh informues të gjitha shkollave që do të vlerësohen gjatë vitit të ardhshëm akademik. Më pas, shumë më herët, drejtorët e shkollave që do të vlerësohen marrin pjesë në takime të ndryshme në secilin prej rajoneve përkatëse, të organizuara dhe të drejtuara nga krerët rajonalë të Inspektoratit.

Këto takime kanë për qëllim qartësimin e përfaqësuesve të shkollave në lidhje me metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të jashtëm, ofrimin e mbështetjes për përgatitjen e tyre për këtë proces dhe sqarimin e çdo dyshimi të mundshëm. Informacioni i dhënë në këto takime është shumë i qartë dhe përvoja e drejtuesve rajonalë të Inspektoratit i ndihmon ata për të marrë përgjigje paraprakisht për çdo pyetje të mundshme. Pyetjet e ngritura nga drejtorët i referohen aspekteve specifike të secilës shkollë, si për shembull:

- nëse është i mundur shkëmbimi ose përfshirja e elementeve të tjera, përtej atyre që janë përcaktuar më parë, në grupin e të intervistuarve;
- çfarë duhet bërë në rastet kur ndonjëri nga dokumentet udhëzuese të shkollës është në rishikim e sipër;
- cilat dokumente të tjera mund të dorëzohen përveç atyre të përcaktuara;
- nëse duhen njoftuar në mënyrë specifike mësuesit, orët e të cilëve do të vëzhgohen.

Për të kontribuar në angazhimin më të madh të shkollave, për të lehtësuar adoptimin e kornizave dhe për të rritur transparencën e procesit, të gjitha informacionet dhe dokumentet në lidhje me vlerësimin e jashtëm i gjeni në faqen e internetit të Inspektoratit:

[Inspectorate's website](https://www.igec.mec.pt/)

[\(https://www.igec.mec.pt/content\\_01.asp?BtreeID=03/01&treeID=03/01/03/00&auxID=&newsID=2762#content\)](https://www.igec.mec.pt/content_01.asp?BtreeID=03/01&treeID=03/01/03/00&auxID=&newsID=2762#content).

Dokumentet e publikuara sistemojnë informacionin në lidhje me shtrirjen, parimet dhe objektivat e vlerësimit të jashtëm të shkollave, kornizën, udhëzimet për përgatitjen e dokumentit të prezantimit të shkollës, shkallën e vlerësimit, metodologjinë dhe agjendat (tetë versione, të diferencuara sipas llojit të shkollës që vlerësohet).

## B. Vizita në terren/në institucion

Kapitulli me pasqyrën e procesit të vlerësimit të jashtëm që ndodh brenda shkollës (duke përfshirë shkollat speciale dhe shkollat AFP me komponentë të të nxënësve nëpërmjet punës).

### 1. Organizimi i vizitës në terren/në institucion

#### *1.1. Shembull i metodologjisë së përbashkët dhe vizitës së përbashkët në terren si për arsimin e përgjithshëm ashtu edhe për AFP-në - Mali i Zi*

Autor: Dragan Berilažić

Në kuadrin e procesit të vlerësimit të cilësisë së punës në institucionet arsimore, në periudhën e mëparshme Instituti i Arsimit në Malin e Zi (IA) ka kryer një vlerësim të jashtëm të pavarur të shkollave të mesme profesionale për sa i përket lëndëve të arsimit të përgjithshëm dhe të gjitha fushave kyçe (gjithsej 6). Gjithashtu, i njëjti lloj vlerësimi i jashtëm është kryer edhe nga një ekip mbikëqyrësish të emëruar nga Qendra për Arsimit dhe Formim Profesional (Qendra AFP) për sa i përket arsimit profesional dhe të gjitha fushave kyçe. Gjatë asaj periudhe, shkollat e përfshira morën **dy raporte** krejtësisht të pavarura, të cilat, në shumicën e rasteve, ndryshonin ndjeshëm me njëri-tjetrin për sa i përket informacionit të dhënë për të njëjtat fusha kryesore dhe të njëjtën metodë vëzhgimi, si për shembull: niveli më i lartë i arritjeve të **mësimdhënies së lëndëve profesionale** (i konstatuar zakonisht në shkollat e mesme të AFP-së), shoqërohej me nivelin më të lartë të vlerësimit për fushat e tjera kyçe dhe një raport i tillë ishte pozitiv dhe vlerësohej me sukses nga Qendra e AFP-së. Vlerësimi i jashtëm nga IA përfshiu vlerësimin e arritjeve të grupit të lëndëve të arsimit të përgjithshëm brenda fushave kyçe. Ata shpesh kanë marrë vlerësim më të dobët për komponentët e arsimit të përgjithshëm të fushave kyçe. Prandaj, shkollat e mesme të AFP-së morën vlerësime të ndryshme për të njëjtat fusha kyçe (vlerësimi i arsimit të përgjithshëm dhe i AFP-së). Duhet theksuar se shkollat e mesme të AFP-së praktikisht i janë nënshtruar 2 inspektimeve të jashtme gjatë një periudhe katërvjeçare, gjë që përbën disavantazh për ta, krahasuar me institucionet e tjera. Gjithashtu, duhet theksuar se të gjitha aktivitetet gjatë periudhës së parambikëqyrjes, mbikëqyrjes dhe pas mbikëqyrjes për këto shkolla janë dyfishuar (anketimi, dorëzimi i dokumentacionit, intervistat me organet drejtuese, etj.), të cilat kishin një efekt disi stresues në jetën dhe punën e vetë shkollës, pra të punonjësve të saj.

Metodologjia e përbashkët (me specifikat e treguesve të caktuar që lidhen me arsimin profesional) dhe vlerësimi i jashtëm i përbashkët nga Qendra e AFP-së dhe IA janë përkthyer në një praktikë shumë pozitive:

1. Ekipi i Qendrës së AFP-së dhe IA-së kryejnë së bashku inspektimin e jashtëm të shkollave të mesme të AFP-së sipas një plani të paracaktuar, i cili është i harmonizuar me Planin Vjetor të Mbikëqyrjes të të dy institucioneve.
2. Fushat kyçe vlerësohen sistematikisht duke i **ndarë ato** mes mbikëqyrësve të Qendrës së AFP-së dhe IA-së, duke shmangur kështu vlerësimet e ndryshme të cilësisë për të njëjtat fusha kyçe.
3. Gjatë periudhës së parambikëqyrjes, kryhet një anketë me nxënës, mësues dhe prindër në nivel shkolle (ndryshe nga praktika e mëparshme).

4. Dhe në fund, shkolla merr **një raport të vetëm** të unifikuar për të gjitha fushat kryesore, me përjashtim të disa specifikave që lidhen me mësimdhënien e lëndëve të arsimit të përgjithshëm dhe mësimdhënien e lëndëve profesionale.
5. Qendra e AFP-së dhe ekipi i IA-së punojnë për organizimin e parambikëqyrjes, mbikëqyrjes dhe për **konsolidimin** e Raportit (shënim: **drejtuesi i ekipit** për shkollat e mesme të AFP-së është një nga mbikëqyrësit e qendrës së AFP-së, dhe **koordinatori** është një nga mbikëqyrësit e IA-së, dhe detyra e përbashkët e tyre lidhet me organizimin e të gjitha aktiviteteve parambikëqyrëse dhe mbikëqyrëse deri në përfundimin e Raportit, siç parashihet me akt të veçantë për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve me rastin e përcaktimit të cilësisë së punës edukativo-pedagogjike brenda institucioneve: “RREGULLAT DHE PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT MIDIS INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE QENDRAVE TË ARSIMIT PROFESIONAL”.
6. Barra e shkollave dhe mësuesve të përfshirë në këtë formë të vlerësimit të jashtëm është dukshëm më e vogël në krahasim me praktikën e mëparshme, gjë që i vendos ata në pozitë të barabartë me institucionet e tjera arsimore.

## 1.2. Organizimi i vizitës në terren - Francë

Autor: Dr Bertrand Richet

### **Takimi fillestar dhe organizimi i vizitës në terren (përfshirë përzgjedhjen e mësuesve ku do të kryhet vëzhgimi i orës së mësimi)**

Në rastin e Këshillit Francez për Vlerësimin e Shkollave (KVSH), koordinatori i ekipit të jashtëm të vlerësimit kontakton drejtorin e shkollës për organizimin e vizitës, e cila bazohet në problematikat që dalin nga analiza e të dhënave të shkollës dhe raporti i vetëvlerësimit. Zhvillimi i vizitave në orët e mësimi nuk është i detyrueshëm. Disa i konsiderojnë ato si të domosdoshme, madje iu dërgojnë vlerësuesve edhe kalendarin e vëzhgimeve, ndërsa disa të tjerë frikësohen se kjo mund të kthehet në inspektim individual të mësuesve, që është një proces krejtësisht i ndryshëm. Disa të tjerë e shikojnë këtë si një opsion, veçanërisht kur bëhet fjalë për vëzhgimin e aktiviteteve specifike në lidhje me një projekt të caktuar në shkollë. Ideja është që të 'shihet shkolla' përmes mësimi, jo mësuesit.

Vizitat në terren zhvillohen vetëm fizikisht dhe jo në distancë. Sa i përket vlerësimit të shkollave të arsimit bazë, meqenëse Franca ka 50,000 shkolla të arsimit bazë, është paraparë kryerja e vlerësimit të përbashkët të grupeve të përbëra nga 5 shkolla secili. Ky vlerësim ka nisur vitin e kaluar (në vitin 2022) dhe madhësia mesatare e grupimeve është rreth 2.5 shkolla për momentin. Këshilli për Vlerësimin e Shkollës ka deklaruar se nuk është e nevojshme të vizitohen të gjitha shkollat e të njëjtit grupim, megjithëse vlerësuesit dhe shkollat mendojnë ndryshe, duke theksuar rëndësinë e takimeve ballë për ballë për 'të ndjerë' atmosferën e shkollës. Kryerja e vizitave në distancë nëpërmjet internetit po shihet si një mundësi që duhet eksploruar më tej.

Në procesin e vlerësimit përfshihen plotësisht palët e interesit, veçanërisht nxënësit dhe prindërit, të cilët prej kohësh kanë qenë të përjashtuar nga vendimet e shkollës edhe pse ata janë përfituesit parësorë dhe dytësorë të shkollimit. Shkollat janë konsideruar prej kohësh si entitete të bazuara vetëm te mësuesit, ku stafi jo mësuesor, nxënësit dhe prindërit janë zhvendosur në role dytësore.

Stafi jo mësuesor përfshin personelin "kombëtar" të punësuar nga Ministria e Arsimit (kontabilistë, personel administrativ, punonjës shëndetësie, etj.) dhe personelin 'lokal' të punësuar nga bashkitë, departamentet (qarqet) ose rajonet për mensën, receptionin ose mirëmbajtjen. Njohuritë e tyre për shkollën dhe nxënësit janë jashtëzakonisht të vlefshme.

Në mënyrë paradoksale, vlerësimi mund të jetë jo tematik edhe tematik. Ai konsiderohet jo tematik në rastet kur është projektuar për të qenë sa më i plotë, d.m.th. kur përfshin të gjitha aspektet e mësimdhënies, të nxënësve, jetës dhe strategjisë në shkollë, pra të katër fushat që duhen marrë parasysh në kontekst. Është tematik në rastet kur nevojat e nxënësve duhet të jenë pika fillestare e çdo reflektimi nga palët e interesuara dhe ato varen nga konteksti (mjedisi shkollor, profilet e nxënësve, etj.) dhe vendimet përkatëse të marra nga shkolla. Një shkollë mund të ketë nevojë të përmirësojë imazhin dhe emrin e saj, ndërsa një tjetër duhet të përqendrohet në punën për reduktimin e izolimit të saj gjeografik, etj. Vlerësimi i jashtëm e ndihmon shkollën për të identifikuar më mirë problematikat e tilla ose për të marrë masa për zgjidhjen e tyre, falë ekspertizës së vlerësuesve.

## **Përdorimi i të dhënave**

Drejtoria e Ministrisë për Vlerësimin, Planifikimin dhe Monitorimin e Performancës (DEPP, *Direction de l'évaluation, de la prospective et de la performance*) dhe filialet e saj rajonale (SSA, *Services statistiques Academics*, Departamentet Rajonale të Statistikave) i pajisin shkollat me të dhëna të përditësuara për karakteristikat dhe performancën e shkollës, së bashku me mjetet për vizualizimin e të dhënave dhe krahasimin e tyre në kohë dhe hapësirë. Të dhënat duhet të ndahen me të gjitha palët e interesuara gjatë vetëvlerësimit dhe të përdoren nga vlerësuesit e jashtëm, në mënyrë që shkolla dhe vlerësuesit të përdorin të njëjtat të dhëna dhe kornizë reflektimi.

Çështja kryesore ka të bëjë me kombinimin e të dhënave, këndvështrimeve dhe vëzhgimeve në mënyrë që shkollave t'u ofrohen analiza vlerësuese efektive dhe rekomandime të posaçme, për të mos e bazuar reflektimin e dikujt vetëm në njërin anë të trekëndëshit të provave. Megjithatë, të dhënat janë qartësisht një pikë e dobët për momentin, edhe pse solide dhe të disponueshme, pasi analiza e bazuar tek treguesit nuk është ende plotësisht pjesë e kulturës arsimore. Kjo situatë mund të ndodhë për shkak të tre arsyeve të ndryshme: 1. Treguesit na kujtojnë disa prej operacioneve të sektorit privat, të cilat nuk janë pjesë e mënyrës së të menduarit të shërbimit publik; 2. Disa të tjerë besojnë se arsimi është thjesht një proces njerëzor dhe shifrat e "çnjerëzojnë" arsimin; 3. Statistikat janë një pjesë e paeksploruar e botës së arsimit, njerëzit janë të pakënaqur me shifrat dhe nuk dinë t'i përdorin apo t'i shfrytëzojnë në maksimum.

### **Nxjerrja e konkluzioneve nga vizita në terren**

Të dhënat e mbledhura nga intervistat dhe vëzhgimet, duke përfshirë vizitën në ambientet e institucionit, ndahen midis vlerësuesve dhe krahasohen me analizën e vetëvlerësimit dhe çështjet e tjera përkatëse si dhe hipotezat vlerësuese. Vlerësuesit shpenzojnë edhe pak kohë së bashku, në terren ose më vonë, për të diskutuar në lidhje me atë që kanë parë dhe dëgjuar. Puna për hartimin e raportit ose ndahet mes anëtarëve të ekipit, ku secili vlerësues harton një pjesë të tij, ose bëhet i centralizuar nga koordinatori, ku vlerësuesit e tjerë pasurojnë kontributin e këtij të fundit.

### **Takimi përmblyës/për ndarjen e gjetjeve/vërejtjeve me shkollën**

Pas hartimit të raportit paraprak, koordinatori kontakton drejtorin e shkollës për të organizuar takimin për ndarjen e gjetjeve/vërejtjeve. Raporti i dërgohet drejtorit, shoqëruar edhe me një prezantim ku përmbledhen të gjitha gjetjet e konstatuara nga vlerësimi në një formë vizualisht më tërheqëse. Kjo bëhet në prani të të gjithë palëve të interesuara (në varësi të mundësisë dhe kohës së tyre në dispozicion) që kanë marrë pjesë në vetëvlerësim dhe/ose në procesin e vlerësimit të jashtëm, zakonisht në orët e vona të pasdites për të siguruar pjesëmarrje më të gjerë. Prezantimi i gjetjeve pasohet nga komentet dhe vërejtjet përkatëse. Koha e planifikuar për zhvillimin e takimeve të tilla duhet jetë e mjaftueshme për shkëmbimin e frytshëm të informacionit me qëllim përmirësimin e raportit përfundimtar. Ky nuk është momenti kur vlerësuesit duhet të arrijnë në konkluzione të caktuara, por thjesht të prezantojnë gjetjet e tyre.

### **Raporti me shkrim nga vlerësimi i jashtëm**

Raporti përfundimtar i vlerësimit përfshin një prezantim të shkurtër të metodologjisë së përdorur gjatë vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm, të kontekstit të shkollës (d.m.th. gjithçka që ka të bëjë me

shkollën: konteksti gjeografik, social, ekonomik, kulturor dhe vendimet e marra nga autoritetet), analizën e nevojave të nxënësve, vendimet përkatëse së bashku me objektivat dhe rezultatet e tyre, si dhe perspektivat për planin e ardhshëm të shkollës që do të ndiqen nga autoritetet rajonale arsimore.

### **Metodologjia dhe vizita në terren për shkollat e përgjithshme dhe shkollat e AFP-së**

Në Francë, shkollat profesionale ose janë pjesë e shkollave të mesme të përgjithshme (*Lycée polyvalent*, shkolla e mesme polivalente/ e përzier) ose janë subjekte të veçanta (*Lycée professionnel*, shkolla AFP). Prandaj, vlerësimi mund të jetë i përbashkët ose individual, sipas rastit.

Këshilli për Vlerësimin e Shkollave ka përgatitur korniza specifike për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e jashtëm për shkollat e përgjithshme dhe për shkollat e AFP-së, ku trajtohen disa çështje specifike, si monitorimi i braktisjes shkollore, orientimi i nxënësve, profilet e nxënësve dhe praktikantëve, aksesit në arsimin e lartë dhe integrimi profesional, por perspektiva metodologjike është e njëjtë, gjë që lë vend për diskutim në lidhje me çështje të tilla si identifikimi i nevojave të nxënësve në bazë të kontekstit, vendimet e shkollës, matja e ndikimit dhe reagimet përkatëse.

### **Treguesit specifikë që përdoren, listat e kontrollit, dokumentet model (për intervista ose aktivitete të ngjashme)**

Shumica e këtyre elementeve janë vetëm në gjuhën frënge. Treguesit janë në pronësi të Drejtorisë për Vlerësimin, Planifikimin dhe Monitorimin e Performancës (*DEPP, Direction de l'évaluation, de la prospective et de la performance*) në ministri dhe të filialeve të saj në nivel rajonal (*SSA, Services statistiques académiques, Departamentet Rajonale të Statistikave*). Struktura bazë e raporteve të vlerësimit përmendet në kornizën e vlerësimit, megjithëse nuk është e detyrueshme për t'u përdorur në nivel kombëtar (autoritetet rajonale arsimore mund të përgatisin modele të tjera specifike). Edhe modelet e intervistave (nxënës, prindër, mësues, personel jo mësimdhënës për shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të larta) janë vënë në dispozicion të palëve të interesuara në faqen e internetit të Këshillit Francez për Vlerësimin e Shkollave.

(<https://www.education.gouv.fr/media/112421/download>; dhe <https://www.education.gouv.fr/conseil-d-evaluation-de-l-ecole-305080>)

### **Hartimi dhe zbatimi i Planit për Zhvillimin e Shkollës**

Hartimi i planit pesëvjeçar për zhvillimin e shkollës është një vendim që merret në shkollë. Raporti i vlerësimit përmban vetëm rekomandime për shkollën të cilat kjo e fundit është e lirë t'i zbatojë ose jo, megjithëse nuk ka asnjë arsye për të mos i zbatuar, veçanërisht nëse procesi i vlerësimit ka shkuar mirë. Vlerësimi i ardhshëm, që do të zhvillohet pas pesë vitesh, nuk do të kontrollojë nivelin e zbatimit të rekomandimeve: vlerësuesit do ta konsiderojnë shkollën ashtu siç është në atë moment, siç kanë bërë edhe pesë vite më parë.

Këshilli për Vlerësimin e Shkollave nuk ka asnjë lloj autoriteti mbi planin e shkollës dhe, për këtë arsye, nuk ofron burime specifike. Kjo është detyrë e shkollës, mundësisht e orientuar nga autoritetet rajonale arsimore, megjithëse është shumë e rëndësishme që të ndahet drejtimi i brendshëm (me të cilin ka të bëjë plani i shkollës) nga drejtimi i jashtëm (që vjen nga autoriteti arsimor rajonal).

### 1.3. Organizimi dhe kryerja e vlerësimit të jashtëm – Kosovë\*

Autorë: Dr.sc. Defrim Gashi, Mr.sc. Imer Preteni

Procesi i vlerësimit të performancës së shkollës kryhet në bazë të legjislacionit në fuqi. Për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës, shkolla duhet të ketë kryer vlerësimin e brendshëm, i cili është i detyrueshëm të kryhet çdo vit që nga viti 2017.

Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës kryhet në të gjitha fushat e cilësisë sipas Kornizës për Sigurimin e Cilësisë së Performancës së Shkollave në Kosovë:

- menaxhimi dhe qeverisja;
- kultura dhe mjedisi;
- mësimdhënia dhe të nxënët;
- zhvillimi profesional i mësuesve;
- performanca e nxënësve;

dhe bazuar në kriteret e vlerësimit për të gjitha parimet e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar:

- gjithëpërfshirja;
- zhvillimi i kompetencave;
- proceset e integruara të mësimdhënies dhe të nxënët;
- autonomia dhe fleksibiliteti;
- përgjegjësia dhe llogaridhënia.

Në datën e caktuar, ekipi i vlerësimit të jashtëm të shkollës takohet me drejtorin e shkollës dhe ekipin e vetëvlerësimit. Në këtë takim diskutohen detajet e procesit të vlerësimit, si më poshtë:

- caktimi i datave për mbledhjen e të dhënave;
- përzgjedhja e nxënësve që do të jenë pjesë e vlerësimit të jashtëm;
- përzgjedhja e mësuesve që do të jenë pjesë e vlerësimit të jashtëm;
- përzgjedhja e prindërve që do të jenë pjesë e vlerësimit të jashtëm;
- pajisja e ekipit të vlerësimit të jashtëm me dokumentacionin bazë që do të shqyrtohet përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave.

Teknikat dhe instrumentet që përdoren gjatë vlerësimit përfshijnë intervistat, anketat dhe pyetësorët me nxënës, mësues dhe prindër. Ekipi përgjegjës për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës përbëhet nga inspektorë arsimorë. Nëse është e nevojshme, në këtë proces angazhohen edhe ekspertë të jashtëm.

Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, roli dhe përgjegjësitë e shkollës janë mjaft të theksuara. Shkolla është përgjegjëse për:

- përzgjedhjen e nxënësve, mësuesve dhe prindërve që do të jenë pjesë e vlerësimit të jashtëm;
- pajisjen e ekipit të vlerësimit të jashtëm me dokumentacionin bazë që do të shqyrtohet përpara fillimit të punës për mbledhjen e të dhënave;
- sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e këtij procesi.

Përzgjedhja e nxënësve për intervista dhe fokus grupe bëhet nga të gjitha klasat dhe përfshin nxënës të gjinive, moshave, shtresave social-ekonomike, niveleve të ndryshme të të nxënët (arritjeve) etj. Prindërit që do të jenë pjesëmarrës në intervista, fokus grupe dhe në pyetësorë janë prindërit e nxënësve të

përzgjedhur. Mësuesit që do të jenë pjesë e intervistave, fokus grupeve dhe pyetësorëve janë mësues të nxënësve të përzgjedhur. 60-90% e mësuesve të shkollës zgjidhen për t'u monitoruar/vëzhguar në klasë.

Vlerësimi i jashtëm i shkollës i merr ekipit vlerësues 17-21 ditë pune në muaj. Në fund, inspektori i arsimit harton raportin përfundimtar, i cili përmban gjetjet për secilën fushë të cilësisë, trendin e performancës, avantazhet (arritjet), pikat e dobëta, si dhe rekomandimet afatgjata për përmirësimin e punës. Raporti diskutohet në një takim të përbashkët me personelin dhe organet drejtuese të shkollës.

## 2. Vëzhgimi i procesit mësimor

### 2.1. Vëzhgim i përbashkët në klasë që përfshin vlerësues të jashtëm dhe punonjës të shkollës – Holandë

Autor: Herman Franssen

#### Qëllimi:

- Mbledhja e informacionit për të vlerësuar cilësinë e procesit mësimor;
- Rritja e mbështetjes për rezultatet e vlerësimit të jashtëm;
- Forcimi i cilësisë së vlerësimit të brendshëm (vetëvlerësimit) të shkollës/institutit.

#### Si funksionon?

Gjatë vlerësimit të jashtëm mblidhen të dhëna për të gjitha llojet e treguesve të kornizës. Një nga treguesit është cilësia e procesit mësimor (mësimdhënia dhe të nxënit). Vlerësuesit e jashtëm kryejnë vëzhgime në klasë për të krijuar një ide në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Për këtë qëllim shpesh përdoret një formular vëzhgimi (shtojca 1).

Në këtë qasje holandeze, vlerësuesi i jashtëm kryen edhe vëzhgime në klasë, por së bashku me një punonjës të shkollës (për shembull me drejtorin). Ata vëzhgojnë orët e mësimit së bashku dhe në mënyrë të pavarur krijojnë një mendim në lidhje me cilësinë e mësimit duke përdorur një formular vëzhgimi të orës së mësimit. Pas vëzhgimeve, ata diskutojnë në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e njëri-tjetrit, si edhe për pikat e forta dhe aspektet që duhet të zhvillohen më tej.

Kjo qasje shërben për mbështetjen e shkollës në lidhje me gjykimet e vlerësuesve të jashtëm. Punonjësi dhe vlerësuesi i jashtëm kanë bërë të njëjtat vëzhgime dhe shpesh mund të arrijnë në të njëjtat konkluzione pas diskutimit të gjetjeve.

Për vëzhgimin e orëve të mësimit, mund të përdoret formulari i vëzhgimit që është pjesë e kornizës së hartuar nga agjencia përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm. Ndonjëherë, për vetëvlerësimin e tyre shkollat përdorin instrumente të përgatitura nga vetë ato. Por në këtë rast përdoret instrumenti i lartpërmendur.

Në Holandë, vëzhgimi i orëve të mësimit nga punonjësit e shkollës, si pjesë e sigurimit të brendshëm të cilësisë së shkollës dhe për t'u informuar në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, është diçka e zakonshme. Shpesh mund të ndodhë që drejtuesit/drejtorët ose menaxherët e nivelit të mesëm të vëzhgojnë të njëjtin mësues disa herë në vit. Ky aktivitet është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve. Shumë shpesh kjo është pjesë e zbatimit të modelit të ri të mësimdhënies. Vëzhgimi i orës së mësimit ka për qëllim të mbështesë mësuesin, dhe jo ta kontrollojë atë. Vëzhguesi bën vërejtjet përkatëse për mësuesin dhe bën sugjerime për zhvillimin e tij të mëtejshëm. Përveç kësaj, vëzhgimi i orëve të mësimit iu shërben drejtuesve të shkollave për të krijuar një tablo sa më të qartë në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në nivel shkolle.

Gjithashtu, vëzhgimi i përbashkët i orës së mësimit i krijon mundësinë vlerësuesit të jashtëm për të diskutuar në lidhje me vëzhgimet e bëra nga punonjësi i shkollës. A është gjykimi i punonjësit të shkollës

shumë i ashpër? A po i shikon ai gjërat në mënyrë shumë sipërfaqësore? A është gjykimi i punonjësit shumë pozitiv apo shumë kritik? Kjo i jep mundësinë vlerësuesit të jashtëm për të shprehur mendimin e tij në lidhje me cilësinë e vëzhgimit të kryer nga punonjësi i shkollës. Në këtë mënyrë, procesi i vlerësimit të jashtëm mbështet edhe cilësinë e procesit të vlerësimit të brendshëm.

## 2.2. Vlerësimi i performancës së mësuesve – Kosovë\*

Autorë: Dr.sc. Defrim Gashi, Mr.sc. Imer Preteni

Procesi i vlerësimit të performancës së mësuesve realizohet në bazë të Ligjit 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës si dhe të Udhëzimit Administrativ 14/2018 për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve. Për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës, mësuesit duhet të plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:

- të jenë të punësuar në momentin kur i nënshtrohen procesit të vlerësimit;
- të kenë licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit;
- të kenë kryer të paktën 100 orë trajnime në programe të akredituara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (minimumi 70% nga programet bazë dhe 30% nga programet plotësuese).

Vlerësimi i performancës së mësuesve kryhet në dy faza:

### I. Vlerësimi i brendshëm, i cili kryhet nga mësuesi dhe drejtori i shkollës:

1. Vetëvlerësimi - mësuesi, bazuar në treguesit përkatës, vlerëson performancën e tij për:

a. katër fusha profesionale:

- vlerat, qëndrimet dhe sjelljet profesionale;
- njohuritë profesionale;
- aftësitë dhe praktikat profesionale;
- të nxëniet dhe angazhimi profesional.

b. shtatë standarde:

- njeh dhe mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë përcaktuar nga MASHTI/përgjegjësia për detyrat dhe përgjegjësitë e punës;
- demonstroi qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve;
- demonstroi njohuri për përmbajtjen e kurrikulës/lëndës dhe metodologjinë e didaktikës profesionale të lëndës;
- planifikon zbatimin efektiv të proceseve të mësimdhënies dhe të nxëniet;
- planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të nxënë), bën vërejtje/jep mendime dhe raportin për ecurinë e nxënësve në procesin mësimor;
- angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
- angazhohet profesionalisht me kolegët, prindërit dhe komunitetin.

2. Vlerësimi nga drejtori i shkollës: në bazë të treguesve përkatës, ai vlerëson performancën e mësuesit në të gjitha fushat profesionale dhe standardet e lartpërmendura.

Për një javë, vetëvlerësimi mund të bëhet nga të gjithë mësuesit që i nënshtrohen këtij procesi, ndërsa drejtori i shkollës vlerëson të paktën katër mësues.

### II. Vlerësimi i jashtëm, i cili kryhet nga inspektori i arsimit:

1. Vlerësimi i orës së mësimi në bazë të protokollit përkatës për vëzhgimin e orës së mësimi – inspektori i arsimit, bazuar në treguesit dhe gjetjet përkatëse gjatë vëzhgimit të mësimi, vlerëson performancën e mësuesit në lidhje me shtatë dimensionet:

- Klima pozitive në klasë;
- Menaxhimi i kohës;
- Angazhimi i nxënësve në veprimtari mësimore;
- Strukturimi i situatave kuptimplote të nxëniti;
- Zhvillimi i të kuptuarit të nxënësve;
- Vlerësimi i të kuptuarit dhe arritjeve të nxënësve;
- Zhvillimi i autonomisë.

2. Vlerësimi i komponentit të planifikimit dhe i përgatitjes me shkrim për orët e mësimi - inspektori i arsimit, bazuar në treguesit dhe gjetjet përkatëse gjatë vlerësimit të portofolit të mësuesit, vlerëson performancën e mësuesit për tre produkte:

- planet e detajuara për tre deri në pesë njësi mësimore të njëpasnjëshme brenda një teme mësimore;
- vlerësimi i nivelit të të kuptuarit dhe arritjeve të nxënësve;
- reflektimi në lidhje me mësimdhënien e tij.

Në fund, inspektori i arsimit harton një raport me rekomandime dhe vendos nëse mësuesi duhet të vazhdojë të mbajë licencën për ushtrimin e profesionit.

Shtojca:

- Shtojca A: Fusha profesionale, standardet dhe treguesit.
- Shtojca B: Formulari i vetëvlerësimit nga mësuesi.
- Shtojca C: Formulari i vlerësimit nga drejtori i shkollës.
- Shtojca D: Planifikimi dhe përgatitja me shkrim.
- Shtojca E: Protokollin e vëzhgimit të orës së mësimi.

### *2. 3. Studim i një modeli të përdorur për vëzhgimin e orës së mësimi – Zyra për Standardet për Arsimin, Shërbimet për Fëmijët dhe Aftësitë (Ofsted) – Mbretëria e Bashkuar*

Autor: Herman Franssen<sup>2</sup>

Që nga muaji shtator 2019, Ofsted ka filluar të përdorë një kornizë të re për inspektimin - Korniza e Inspektimit të Arsimit (KIA). Ofsted ka publikuar një dokument shpjegues që lidhet veçanërisht me

---

<sup>2</sup> Ky artikull është përshkrimi i një praktike të mirë, bazuar në:

- <https://lessonslearned.com/new-ofsted-criteria-lesson-observation/>
- 'How valid and reliable is the use of lesson observation in supporting judgements on the quality of education?' Ofsted, 2019.

vëzhgimin e orës së mësimi dhe mënyrën se si do të përdoret ai në inspektimet e reja: "Sa i vlefshëm dhe i besueshëm është përdorimi i vëzhgimit të orës së mësimi në mbështetje të gjykimeve për cilësinë e arsimit? (2019)

### **Qëllimi i vëzhgimit dhe modeli i vëzhgimit**

Ofsted e pranon se klasat janë mjedise komplekse dhe të përpiqesh të kapësh gjithçka që ndodh aty nuk është as e mundur dhe as e dëshirueshme. Ata gjithashtu e dinë se vëzhgimi i orës së mësimi është vetëm një mjet në morinë e metodave të vlerësimit që ekzistojnë për matjen e efektivitetit të punës së mësuesve dhe vlerësimet e informuara duhet të bazohen në të dhënat e trianguluara.

Ky model është krijuar për të kontribuar në zhvillimin e vlerësimit në nivel shkolle dhe jo në vlerësimin e një mësuesi të vetëm, duke qëndruar në këtë mënyrë përkrah vlerësimit të kurrikulës dhe duke ndikuar në mënyrë më efektive mbi gjykimin e cilësisë së arsimit. Kjo do të thotë se lënda ose departamenti (ose një strukturë e ngjashme) është njësia kryesore e interesit ku do të kryhen vizitat/vëzhgimet e orës së mësimi. Kjo njihet si "zhytja e thellë". Qëllimi i "zhytjes së thellë" është krijimi i mundësisë për inspektorët për të mbledhur sa më shumë të dhëna dhe evidenca për të bërë një vlerësim të saktë të mënyrës se si rrjedh edukimi nga synimi tek zbatimi dhe, në fund, tek impakti brenda një shkolle.

Në shkollat e arsimit bazë, inspektorët e përdorin gjithmonë këtë qasje në lëndën e leximit si dhe në një ose më shumë lëndë bazë. Kjo përfshin gjithmonë një lëndë që është duke u zhvilluar në shkollë në kohën kur inspektorët janë në terren. Shpesh kjo qasje përdoret edhe në lëndën e matematikës. Për shkollat e mesme, "zhytja e thellë" zakonisht fokusohet në një kampion të përbërë nga katër deri në gjashtë lëndë, me qëllim vlerësimin e një grupi sa më të larmishëm nxënësish në vite të ndryshme të shkollimit, që janë pjesë e këtij kampioni.

Metodologjia fillestare e zhvilluar për vëzhgimin e orës së mësimi përmbante tetëmbëdhjetë tregues, në fusha të tilla si: Kurrikula, Mësimdhënia dhe Sjellja.<sup>3</sup>

Këto tregues u testuan në një sërë shkollash (22) dhe kolegësh (15). Gjatë periudhës së testimit, inspektorët përdorën një shkallë vlerësimi prej pesë pikësh, pikë së pari, për të shmangur referimin në

---

<sup>3</sup> **Kurrikula:** Mësuesit përdorin ekspertizën lëndore, njohuritë dhe aftësitë praktike për të ofruar mundësi për të nxënë; Mësuesit sigurojnë që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta për t'iu qasur çdo mësimi, si bazë për kurrikulën më të gjerë; Janë zhvilluar strategji për të mbështetur lëndët e leximit/fjalorit/aritmetikës për nxënësit që kanë nevojë/nuk mund të kenë qasje te kurrikulat përkatëse; Përmbajtja e mësimi është relativisht e vështirë; Përmbajtja e mësimi është e përshtatshme për grupmoshën dhe nuk ul pritshmëritë; Mësimi ndjek një sekuencë logjike; Mësuesit ofrojnë mundësi për të kujtuar dhe praktikuar aftësitë dhe njohuritë e mësuara më parë; Vlerësimi ofron informacion të përshtatshëm, të qartë dhe të dobishëm në lidhje me aftësitë dhe njohuritë aktuale të nxënësve. **Mësimdhënia:** Mësuesit demonstrojnë aftësi të mira komunikimi; Përdorimi i prezantimit nga ana e mësuesve i ndihmon nxënësit për të zhvilluar njohuritë e tyre dhe për krijuar lidhjet; Mësuesit përdorin burimet përkatëse dhe të përshtatshme gjatë prezantimit për t'i qartësuar nxënësit në lidhje me konceptet; Mësuesit zotërojnë aftësi të mira për drejtimin e pyetjeve; Mësuesit bëjnë vërejtje të qarta, të detajuara dhe konstruktive në klasë; Mësuesit verifikojnë nivelin e të kuptuarit nga ana e nxënësve. **Sjellja:** Mësuesit krijojnë klasa mbështetëse të fokusuar tek të nxënit; Mësuesit krijojnë klasa të fokusuar përmes pritshmërive të tyre të larta për nxënësit; Mësuesit komunikojnë pritshmëri të qarta dhe të qëndrueshme të cilat kuptohen dhe ndiqen nga nxënësit; Sjellja e nxënësve kontribuon për fokusimin në procesin e të nxënit.

grykimet aktuale dhe, së dyti, për të rritur mundësitë e ndryshueshmërisë në pikëzëim. Kjo sërisht do të jetë pjesë e testimit të mëtejshëm.

## **Rezultatet**

### **Vlefshmëria dhe besueshmëria**

Sipas të dhënave, përdorimi i këtij modeli vëzhgimi ka rezultuar në vlerësime të vlefshme.

Vëzhguesit arritën të gjykonin se cilët tregues rezultuan të ishin më shumë ose më pak të dobishëm. Sipas disa të dhënave, diapazoni ishte tejte i madh dhe mund të shkaktonte "mbingarkesë konjitive për vëzhguesin". Reduktimi i numrit të treguesve mund të çojë në një qasje më të qëndrueshme dhe, për rrjedhojë, në një gjykim më solid.

Në gjykimin e vlefshmërisë, vëzhguesit u përqendruan më shumë në vlerësimin e treguesve të fushës së Sjelljes se sa të treguesve të fushës së Mësimdhënies dhe Kurrikulës (që replikon modelin e konstatuar në shumicën e modeleve të vëzhgimit).

Gjithashtu, përsëri sipas të dhënave të gjeneruara, ka rezultuar se sa më i gjatë vëzhgimi, aq më i lartë niveli i besueshmërisë së vlerësimit.

Të gjitha të dhënat nga studimet ndërkombëtare sugjerojnë se vëzhguesit e shumtë në numër (mund të jenë dy) janë më efektivë nëse modeli synon zhvillimin e mësuesve dhe jo një model vlerësimi gjykues.

Besueshmëria lidhet me numrin e orëve të mësimin që vëzhgohen. Zhvillimi i vetëm një vizite vëzhguese mund të çojë në vlerësimin e gabuar. Në rastet kur vëzhgimi synon të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të mësuesit dhe jo thjesht në vlerësimin e tij, nevojitet kryerja e vëzhgimit të disa orëve mësimore.

Sipas të dhënave dhe informacionit të mbledhur, edhe ora e ditës dhe madje edhe periudha e vitit kur zhvillohet vëzhgimi mund të ndikojnë në vlerësimet e vëzhguesve, prandaj përsëri vlen të theksohet që vëzhgimet e shumta në numër do të ishin më të dobishme për të krijuar një tablo më të plotë të punës së një mësuesi. Nga ana tjetër, vizitat e shumta të inspektorëve në orën e mësimin të mësuesit përkatës mund të ndikojnë në procesin mësimor. Sigurisht, shkollat duhet ta kenë këtë parasysh gjatë punës për zhvillimin e modelit të tyre. Kjo kërkon që drejtuesit të zhvillojnë në shkollë kulturën e përmirësimit, ku mësuesit e shohin procesin e vëzhgimit si diçka që kontribuon në të drejtën e tyre si nxënës profesionistë dhe jo si diçka që u bëhet atyre pa asnjë qëllim zhvillimor.

### **Treguesit Specifikë për Lëndën ose Treguesit Gjenerikë**

Ende nuk është arritur një marrëveshje nëse treguesit duhet të jenë gjenerikë apo specifikë për një lëndë të caktuar. Sipas Ofsted-it vendosja e treguesve specifikë të lëndëve është shumë e vështirë për shkak të nevojës për rritjen e masave të trajnimit dhe të numrit të ekspertëve të lëndëve. Edhe për modelin gjenerik, Ofsted tashmë e njej nevojën për trajnim fillestar cilësor për vëzhguesit në mënyrë që të sigurohet besueshmëria e vazhdueshme e gjykimeve dhe vlerësimeve

### **Treguesit më të dobishëm**

Nga analizimi i rezultateve të testimit ka dalë se, në përgjithësi, numri i treguesve me nivel të lartë besueshmërie është i reduktuar. Treguesit me besueshmëri të ulët rezultuan të tillë kryesisht për shkak

se bëhet fjalë për tregues që kanë të bëjnë me aspekte të një ore mësimore që janë të vështira për t'u vlerësuar me një nivel të sigurtë konsistence. Gjithsesi, janë vërejtur disa dallime në këtë aspekt midis shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm, dhe veçanërisht kolegjeve.

Në përgjithësi, tetë treguesit e mëposhtëm janë identifikuar si tregues me nivele më të larta besueshmërie dhe do të përdoren me prioritet nga Ofsted-i gjatë zhvillimit të vizitave të mëtejshme pilot përpara marrëveshjes përfundimtare dhe përfshirjes në Kornizën për Inspektimin e Arsimit.<sup>4</sup> Reduktimi i numrit të treguesve do të zbuste edhe riskun e mbingarkesës në aspektin njohës.

### **Tetë treguesit kryesorë janë:**

#### Fusha e Kurrikulës

- Mësuesit përdorin ekspertizën e tyre lëndore për të ofruar mundësi efektive të të nxënit.
- Përmbajtja e mësimit është e përshtatshme për grupmoshën dhe nuk ul pritshmëritë.
- Mësimi ka rrjedhë logjike.

#### Fusha e Mësimdhënies

- Mësuesit demonstrojnë aftësi të mira komunikimi.
- Mësuesit zotërojnë aftësi të mira për drejtimin e pyetjeve.
- Mësuesit bëjnë vërejtje të qarta, të detajuara dhe konstruktive në klasë.

#### Fusha e Sjelljes

- Mësuesit krijojnë klasa mbështetëse të fokusuara tek procesi i të nxënit.
- Sjellja e nxënësve kontribuon për fokusimin në procesin e të nxënit.

### **Lidhje të dobishme**

[https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/811808/Inspecting\\_education\\_quality\\_Lesson\\_observation\\_report.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/811808/Inspecting_education_quality_Lesson_observation_report.pdf)

---

<sup>4</sup> Pa i caktuar vlerë ose peshë asnjërit prej treguesve.

### 3. Intervistat me aktorët përkatës (drejtuesit, mësuesit, nxënësit dhe palët e interesuara)

#### 3.1. Intervistat shumëdimensionale – Bosnjë dhe Hercegovinë

Autorë: Dr Enisa Gološ, Saša Grabovac, Biljana Popović

Grupi i propozuar i formularëve përfshin të dhëna të shumta në lidhje me treguesit e nivelit të arritur të cilësisë. Informacioni i mbledhur nëpërmjet formularëve do të shërbejë për njohjen e kontekstit në të cilin funksionon institucioni. Të gjithë palët e interesuara duhet të jenë të informuara në lidhje me cilësinë e punës së institucionit, që ndikon në politikën e regjistrimeve dhe në zgjedhjen e profesionit në shkollat e arsimit të mesëm profesional.

Përdorimi i formularëve të duhur ndihmon për marrjen e rezultateve të vlerësimit të jashtëm në mënyrë që të arrihet matja e saktë e nivelit të cilësisë së arritur. Disa formularë janë të rëndësishëm edhe për përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm, sepse përfaqësojnë pikënisjen e zakonshme ose janë një komponent i përgatitjes për vlerësimin e jashtëm. Grupi i formularëve të ofruar kërkon angazhimin e ekipit të anëtarëve të emëruar për vlerësimin e jashtëm (vlerësuesit e jashtëm) për të garantuar, në këtë mënyrë, objektivitetin e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Formularët e ofruar janë duke u përdorur për takimet me:

- Mësues të përzgjedhur
- Punonjës të tjerë të institucioneve
- Nxënës
- Prindër
- Punëdhënës dhe anëtarë të komunitetit lokal

Pjesë e këtij grupi formularësh është edhe formulari që përdoret për vëzhgimet e përgjithshme dhe për mbajtjen e shënimeve gjatë vizitës së vlerësuesve të jashtëm në institucion.

Gjatë vlerësimit, në pjesën që i referohet takimeve me palët e interesuara, vlerësuesit e jashtëm duhet t'i trajtojnë bashkëbiseduesit në mënyrë profesionale, duke respektuar të gjithë pjesëmarrësit në procesin e vlerësimit, duke pasur parasysh se çdo bashkëbisedues është po aq i rëndësishëm në procesin e vlerësimit dhe që cilësia e vlerësimit (nga nisja e procesit e deri te raportimi) varet nga cilësia e punës, që është në fund të fundit edhe qëllimi i vlerësimit.

Po aq e rëndësishme është që, gjatë bisedës, bashkëbiseduesi të garantohet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale dhe, gjatë mbledhjes së informacionit, të theksohet rëndësia e dialogut të hapur, duke respektuar mendimin e bashkëbiseduesit, pa shtuar fjalë që mund të kanë karakter sugjerues dhe duke lënë jashtë mendimin personal të vlerësuesit.

Edhe sinqeriteti gjatë një bisede është veçanërisht i rëndësishëm dhe këshillohet që përgjigjet të shoqërohen me argumentimin përkatës. Gjithashtu, bashkëbiseduesit duhet të evidentojnë pikat e forta dhe të dobëta të institucionit, si dhe të analizojnë statusin aktual të punës së institucionit.

Gjatë vëzhgimit të orës së mësimi, në klasë janë të pranishëm tre vlerësues të jashtëm, të cilët ndjekin, sipas të njëjtit formular, realizimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë orës së mësimi dhe, në bazë të tij, secili prej tyre individualisht shkruan një raport. Një qasje e tillë kontribuon për mbështetjen e shkollës gjatë gjykimit të punës.

Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, ekipi i vlerësimit të shkollës takohet me palët e interesuara, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë janë përgjegjëse për cilësinë e punës së institucionit. Detyra e tyre është e konceptuar në detaje dhe konsiston në grumbullimin e mendimeve dhe provave në lidhje me nivelin e cilësisë së punës (ku janë tani - situata aktuale në punën e institucionit) dhe sigurimin e cilësisë sipas standardeve të përcaktuara të cilësisë (ku duhet të jetë institucioni për të arritur cilësinë e dëshiruar).



#### Shtojca:

- Raporti konfidencial për vëzhgimin e mësuesit si pjesë e vlerësimit të jashtëm.
- Formulari për takimin me personelin mësimdhënës.
- Formulari për takimin me personelin mbështetës.
- Formulari për takimin me nxënësit.
- Formulari për takimin me prindërit.
- Formulari për takimin me punëdhënësit lokalë dhe anëtarët e komunitetit.
- Vëzhgime dhe shënime të përgjithshme gjatë vizitës së vlerësuesve të jashtëm.
- Vëzhgimi i një takimi të drejtuesve të institucionit të AFP-së gjatë vizitës së vlerësuesve të jashtëm.
- Vëzhgime të përgjithshme gjatë takimit me drejtorin e shkollës dhe drejtuesit e tjerë të shkollës në procesin e vlerësimit të jashtëm.

### 3.2. Intervistat me drejtuesit e shkollës, mësuesit dhe nxënësit: Mbështetja e dialogut - Flanders/Holandë

Autor: Herman Franssen<sup>5</sup>

#### Qëllimi:

- Mbledhja e informacionit për të bërë të mundur vlerësimin e treguesve dhe standardeve;
- Rritja e përfshirjes së personelit në procesin e vlerësimit;
- Rritja e mbështetjes për gjykimet e vlerësimit të jashtëm.

#### Si funksionon?


Gjatë vizitave në terren, intervistat ose bisedat janë një burim i rëndësishëm për mbledhjen e informacionit për vlerësimin e treguesve. Këto biseda shumë shpejt mund të përfundojnë në pyetje të njëanshme: vlerësuesi i jashtëm bën pyetje, shkolla përgjigjet. Bisedat që zhvillohen më shumë në formën e dialogut rrisin kontributin dhe përfshirjen e pjesëmarrësve. Kjo ndikon në mënyrë pozitive edhe në cilësinë e informacionit.

Një qasje e thjeshtë që mund të përdoret për të inkurajuar zhvillimin e intervistës në formë dialogu, është të punohet me një tabak letre përpara (shih Figurën 1), ku janë të vizualizuara temat e diskutimit dhe pyetjet përkatëse në formën e një diagrami. Në këtë mënyrë, përfaqësuesit e shkollës e dinë paraprakisht se cilat tema do të diskutohen dhe kanë të drejtë të zgjedhin vetë rradhën e diskutimit të tyre. Diagrami i paraqitur përmban të gjitha aspektet e një treguesi ose standardi të caktuar të cilësisë që po vlerësohet, kështu që pyetjet/temat e përfshira në të mbulojnë të gjitha aspektet e një treguesi ose standardi të cilësisë.


Figura 1: Diagrami për Monitorimin Standard të Arritjeve dhe Mbështetjes së Nxënësve

---

<sup>5</sup> Artikulli bazohet në një praktikë të mirë nga Inspektorati i Flanders.



Një hap më tej për të inkurajuar dialogun është qasja në të cilën pjesëmarrësve u kërkohet të kryejnë një lloj vetëvlerësimi gjatë bisedës. Korniza dhe treguesit paraqiten vizualisht. Përfaqësuesve të shkollës u kërkohet që të organizojnë dhe rendisin disa shirita letre (që përmbajnë tregues ose deklaratë) dhe të shpjegojnë renditjen e tyre. Për këtë, mund të zgjidhen notat ose pikët e përdorura në vlerësimin e jashtëm. E rëndësishme është që përfaqësuesve të shkollës t'u jepet mundësi e mjaftueshme për të shpjeguar renditjen e tyre. Gjatë kësaj bisede duhet që vlerësuesit e jashtëm, para së gjithash, të tregohen të përmbajtur, flet shkolla. Pastaj ata mund të drejtojnë edhe pyetje të tjera.





### 3.3. Intervistat me bizneset, mentorët dhe instruktorët (udhëzime për intervistat) – Moldavi

Autor: Liudmila Arhiliuc

#### Qëllimi i intervistave:

- Plotësimi i informacionit në lidhje me procesin e formimit të aftësive profesionale në fushën e trajnimit (p.sh. ekonomi, mjekësi);
- Formulimi i konkluzioneve në lidhje me rëndësinë e programit në tregun e punës;
- Përcaktimi i kapaciteteve për punësim të specialistëve të rinj në moshë në sektorin e mirëfilltë të ekonomisë dhe brenda subjektit mësimor.

Vizita e vlerësuesve të jashtëm realizohet në kuadër të procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së programeve të arsimit teknik profesional dual, gjatë së cilës kryhen intervista me përfaqësues të punëdhënësve potencialë, agjentë ekonomikë (subjekte mësimore<sup>6</sup> brenda arsimit dual), palët e interesuara nga sektori ekonomik për të cilin kryhet trajnimi. Gjatë intervistave me përfaqësuesit e subjektit mësimor, vëmendje e veçantë i kushtohet vlerësimit të standardit 2 dhe 3 të akreditimit, i cili i referohet hartimit të programit të studimit, rëndësisë së tij për ekonominë kombëtare, metodave të vlerësimit të procesit mësimor, zhvillimit të aftësive praktike të përgjithshme dhe specifike për degët në të cilat zhvillohet mësimi.

Komisionet e vlerësimit të jashtëm drejtojnë pyetje (sipas përmbajtjes së Udhëzuesit për Vlerësimin e Jashtëm të Programeve të Formimit Profesional në Arsimin Teknik Profesional) në lidhje me aspektet e mëposhtme:

- Dispozitat e kontratës së bashkëpunimit me institucionin. Garancitë dhe aspektet e ofruara nga njësia mësimore;
- Mundësitë e harmonizimit të veprimtarive mësimore me aktivitetet prodhuese të realizuara nga nxënësit;
- Pajtueshmëria me legjislacionin e punës në lidhje me nxënësit (përfshirë edhe 15-17 vjeçarët);
- Efikasiteti i të nxënit lidhet me kompetencat e parashikuara nga programi dhe proceset e prodhimit.

Në përputhje me përgjigjet e formuluar, vlerësohet shkalla e arritjes së treguesve të tillë të performancës:

2.2.3. Rëndësia e programit të formimit profesional;

3.2.1. Organizimi i praktikave profesionale;

3.2.2. Ekzistenca e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet të cilat janë baza për praktikat profesionale;

3.3.2. Organizimi i vlerësimit të praktikave profesionale;

6.1.2. Pajisjet dhe qasja tek ambientet mësimore;

9.1.3. Vlerësimi i programit të formimit profesional nga nxënësit, të diplomuarit, punëdhënësit dhe përfituesit e tjerë.

---

<sup>6</sup> Sipas ligjit nr. 110/2022 për arsimin dual – termi ‘subjekt mësimor’ në arsimin dual (në tekstin e mëtejme - subjekti) nënkupton: çdo person juridik sipas të drejtës publike dhe/ose private, pavarësisht nga lloji i pasurisë dhe formës juridike të organizimit, dhe/ose person fizik që plotëson kushtet e përcaktuara për formimin profesional të nxënësve, të parashikuara nga programi përkatës i formimit profesional nëpërmjet arsimit dual.

Në fazën tjetër, informacioni i mbledhur nga intervistat krahasohet me provat e paraqitura nga institucioni i vlerësuar. Dhe e fundit, anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Jashtëm formulojnë rekomandime për përmirësimin e programit të formimit profesional dual.

**Shtojcë:**

- [Ghidul de evaluare externë a programelor de formare profesională în învățământul profesional tehnic](#)

#### 4. Nxjerrja e konkluzioneve nga vizita në terren

##### *4.1. Nxjerrja e konkluzioneve përfundimtare: Çfarë duhet bërë kur ka mospërputhje të të dhënave/evidencave – Maqedonia e Veriut*

Autorë: Antonela Stojanoska, Valentina Gocevaska, Ardijana Isahi Palloshi

Gjatë fazës së zbatimit, Inspektorët Shtetërorë të Arsimit kryejnë një numër të madh aktivitetesh:

- Takime me drejtorin;
- Takime me stafin ndihmës mësimor në shkolla (pedagog, psikolog, sociolog, asistent për arsimin special);
- Fokus grup me mësues;
- Fokus grup me nxënës;
- Takimi me Këshillin e Prindërve;
- Takimi me anëtarët e Bordit të Shkollës;
- Shqyrtimi i dokumentacionit të shkollës;
- Shqyrtimi i evidencave që mbahen në shkollë;
- Organizimi i vizitave vëzhguese në klasa;
- Organizimi i vizitave në orët e mësimin praktik;
- Këqyrja e të gjithë hapësirës së shkollës dhe klasave;
- Informimi në lidhje me bibliotekën;
- Informimi në lidhje me operacionet financiare të shkollës;
- Bisedë me personin përgjegjës për arsimin nga bashkia etj.

Nga të gjitha aktivitetet e sipërpërmendura që kryhen në fazën e zbatimit, është e nevojshme që të dilet me një vlerësim real dhe të drejtë të punës së shkollës, që do të reflektojë cilësinë e punës në procesin mësimor.

Ky është një proces i gjatë dhe i mundimshëm, dhe për çdo fjalë të shkruar, pretendim, vlerësim, **kryhet triangulimi - për çdo gjë kërkohen tre prova.**

***Pra, secili prej pretendimeve tona mbështetet nga tre prova: çfarë shohim, çfarë dëgjojmë dhe çfarë është në dokumentacionin e shkollës.***

Shumë herë ndodh që tre llojet e provave të përkohshme me njëra-tjetrën, por ka pasur edhe devijime. Prandaj, për verifikimin e tyre duhen zhvilluar aktivitete shtesë.

Shembulli më poshtë e ilustron një rast të tillë:

Në një shkollë, për sa i përket arritjeve të nxënësve, u evidentuan mospërputhje, si më poshtë:

- Nga dokumentacioni u konstatua se shkolla kishte arritje dhe rezultate të larta;
- Fokus grupi i nxënësve me të cilët biseduam u shpreh shumë i kënaqur me punën e mësuesve të tyre;
- Përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve theksuan se janë pjesërisht të kënaqur me punën e mësuesve, por gjithsesi ata u treguan të përmbajtur.
- Atmosfera në klasa nuk ishte në nivelin e duhur.
- Gjatë orëve të mësimi, mësuesit nuk caktonin detyra dhe aktivitete të veçanta për nxënësit e talentuar, kështu që tek disa prej nxënësve vihej re një mungesë interesi.

Nga gjithë sa u pa, ne nuk arritëm të vlerësojmë punën e mësuesve të lëndëve që sipas dokumentacionit kishin arritje të larta.


Për këtë qëllim, Inspektorët Shtetërorë të Arsimit zhvilluan edhe disa aktivitete të tjera shtesë:

- Morën dokumentacionin me evidencat e arritjeve;
- Organizuan një takim me dy fokus grupe të reja me nxënës të përzgjedhur në mënyrë rastësore;
- Organizuan një takim me nxënësit që kishin marrë pjesë në konkurse të ndryshme dhe që kishin arritur rezultate të larta;
- Zhvilluan një takim me një fokus grup të prindërve të nxënësve që kanë marrë pjesë në konkurse të ndryshme dhe kanë arritur rezultate të larta.

Informacioni i mbledhur (konkluzioni i arritur) pas zhvillimit të këtyre aktiviteteve ishte krejtësisht i informacioni i ri:

- Rezultatet e arritjeve janë të larta,
- por prindërit e nxënësve që morën pjesë në konkurse theksuan se para konkurseve nxënësit ndiqnin orë mësimi shtesë jashtë shkollës, të cilat i kanë ndihmuar ata për të arritur rezultate të larta.

Pas kësaj, nuk ishte e vështirë të vlerësohej se performanca e mësuesve ishte në nivelet më të ulëta.



#### *4.2. Përgatitja e konkluzioneve të vlerësimit të jashtëm: Si të sigurojmë konsistencën dhe transparencën e tyre – Portugalia*

Autorë: Isabel Barata dhe Rosa Micaelo

Përfundimet e nxjerra nga vlerësimi i jashtëm i shkollave janë shumë të rëndësishme si për vlerësuesit ashtu edhe për palën e vlerësuar. Ato janë njëkohësisht pjesë përbërëse e procesit dhe rrjedhojë e tij, duke u materializuar në takimin përfundimtar ndërmjet ekipit të vlerësuesve dhe drejtuesve të secilës shkollë, si dhe në raportin përfundimtar.

Në Portugalinë kontinentale, vlerësimi i jashtëm i metodologjisë së shkollave bën të mundur hartimin me faza dhe të pjesshëm të konkluzioneve gjatë gjithë procesit. Ato hartohen nga grupi i vlerësimit që në momentin e përgatitjes për vlerësimin, bazuar në shqyrtimin dhe analizimin e (i) dokumenteve të shkollës (si për shembull, projekti arsimor, plani vjetor i aktiviteteve, raporti i vetëvlerësimit), (ii) informacionit statistikor mbi rezultatet akademike të ofruar nga Ministria e Arsimit (norma e suksesit, norma e braktisjes dhe qëndrimin në shkollë, rezultatet e testeve dhe provimeve kombëtare, ndër të tjera), (iii) anketave të kënaqësisë të zhvilluara online për komunitetin arsimor (nxënësit, prindërit, mësuesit dhe personelin e shkollës), (iv) si dhe takimet e ekipit të vlerësimit për të parashtruar hipoteza dhe pyetje që mund të eksplorohehen më tej gjatë vlerësimit.

Gjatë vizitës në shkollë, zhvillohen edhe procese të tjera për mbledhjen e informacionit, i cili triangulohet dhe validohet sistematikisht për aspekte të tilla si relevanca, konsistenca dhe gjithëpërfshirja. Ky triangulum integron të dhënat e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nëpërmjet burimeve të tjera të informacionit (vëzhgimi i orëve të mësimit, intervistat në grup, vëzhgimi i mjedisit shkollor). Ai gjithashtu integron këndvështrimet e secilit prej vlerësuesve (inspektorët dhe ekspertët), si dhe përgjigjet dhe ndërveprimet ndërmjet vlerësuesve dhe të vlerësuarve. Takimet e ndërmjetme të ekipit të vlerësuesve mundësojnë konfirmimin dhe validimin e gjykimeve vlerësuese.

Dy janë momentet thelbësore për komunikimin e konkluzioneve. Takimi përfundimtar me drejtorin dhe ekipin e tij është momenti i parë i reagimit dhe diskutimit, i cili bën të mundur sqarimin e aspekteve të paqarta, duke bërë bashkë këndvështrimet e ndryshme (të jashtme dhe të brendshme) dhe duke parashikuar shprehjen e mospajtit nga ana e shkollës. Përgatitja dhe publikimi i raportit, i cili përmbledh gjykimet vlerësuese për secilën prej sferave dhe fushave të analizës së kryer, mbyll procesin formal të punës. Vlen të nënvizohet fakti që këto dy momente plotësojnë njëri-tjetrin, pasi ky takim ndihmon për të kuptuar përmbajtjen e raportit, në të cilin, duke pasur parasysh udhëzimet teknike, nuk është e mundur të pasqyrohet plotësisht i gjithë procesi i vlerësimit. Pas marrjes së raportit, drejtori i shkollës mund të shprehë mendimin e tij në lidhje me çështjet e ngritura.

Sa më sipër nxjerr në pah synimin për të forcuar pjesëmarrjen dhe besimin e palës së vlerësuar, si dhe konsistencën dhe transparencën e vlerësimit, për të inkurajuar proceset e mëvonshme për përmirësimin e punës. Ajo që bie gjithashtu në sy është edhe qendërzimi i etikës, sa i takon kodit të sjelljes së vlerësuesve, ashtu edhe për sa i përket parimeve dhe vlerave, duke përfshirë parashikimin e impaktit të vlerësimit mbi shkollën dhe komunitetin e saj arsimor.

## C. Komunikimi i gjetjeve të vlerësimit të jashtëm

Ky kapitull përshkruan procesin e ndarjes së konkluzioneve të vlerësuesve të jashtëm dhe dhënies së komenteve/vërejtjeve për drejtuesit e shkollës.

### 1. Takimi përmbyllës/për ndarjen e komenteve/vërejtjeve me shkollën

#### 1.1. Si ta bëjmë më interaktiv takimin përmbyllës pas vlerësimit të jashtëm – Holandë

Autor: Herman Franssen

##### Qëllimi:

- Prezantimi i gjetjeve dhe konkluzioneve të vlerësimit të jashtëm.
- Rritja e përfshirjes së anëtarëve të personelit në procesin e vlerësimit.

##### Si funksionon?

Pas përfundimit të procesit, ekipi i vlerësimit të jashtëm zakonisht paraqet gjetjet dhe konkluzionet e punës. Shkollës i prezantohen gjykimet dhe vlerësimet në lidhje me treguesit e kornizës. Vlerësuesit e jashtëm shpjegojnë gjykimet e tyre. Cilat janë gjetjet mbi të cilat bazohen këto konkluzione? Çfarë informacioni është përdorur për ta?

Për të rritur mbështetjen për këto konkluzione dhe për të intensifikuar përfshirjen e shkollës në procesin e vlerësimit të jashtëm, Holanda ka fituar përvojë në zbatimin e një qasjeje më ndërvepruese.



## Oordelen op de standaarden

	De Klimop	Inspectie
<b>Kwaliteitsgebied 1 Onderwijsresultaten</b>		
1.1 Resultaten in kernvakken	zwak	voldoende
<b>Kwaliteitsgebied 2 Onderwijsproces</b>		
2.1 Aanbod	voldoende	voldoende
2.2 Zicht op ontwikkeling	Voldoende	Zwak
2.3 Didactisch handelen	voldoende	voldoende
2.4 Ondersteuning	voldoende	Zwak/voldoende
<b>Kwaliteitsgebied 3 Schoolklimaat en veiligheid</b>		
3.1 Schoolklimaat	voldoende	voldoende
3.2 Veiligheid	voldoende	Voldoende
<b>Kwaliteitsgebied 4 Kwaliteitszorg en ambitie</b>		
4.1 Evaluatie en verbetering	voldoende	zwak
4.2 Kwaliteitscultuur	voldoende	voldoende
4.3 Verantwoording en dialoog	voldoende	Voldoende

Përpara zhvillimit të vizitës në terren, shkolla merr një pasqyrë të të gjithë treguesve ose standardeve që do të shqyrtohen gjatë vlerësimit të jashtëm. Shkolla i diskuton këta tregues në strukturat e saj të brendshme me mësuesit dhe krijon gjykimet e veta për këta tregues (një lloj vetëvlerësimi). Më pas shkolla ia dërgon këtë vlerësim ekipit të vlerësuesve të jashtëm që do të vizitojnë shkollën.

Gjatë seancës së komenteve/vërejtjeve pas përfundimit të vlerësimit, ekipi i vlerësimit të jashtëm i prezanton të dyja gjykimet krahas për krahas me njëra-tjetrën: gjykimin e shkollës dhe të ekipit të vlerësimit të jashtëm (Shih Figurën 1). Kjo është një mundësi më e mirë për ta bërë këtë seancë edhe më interaktive. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për një prezantim të konkluzioneve të ekipit të vlerësimit të jashtëm, por edhe për zhvillimin e dialogut midis shkollës dhe vlerësuesve të jashtëm në lidhje me gjykimet e gjithsecilit. Shkollat kanë mundësinë të shpjegojnë edhe gjëra të tjera shtesë, ose të shprehin pikëpamjet e tyre në lidhje me gjykimin e vlerësuesve të jashtëm.

Figura 1: Pasqyrë e vlerësimit nga shkolla (majtas) dhe inspektimi (djathtas)

## 2. Raporti me shkrim për vlerësimin e jashtëm

### *2.1. Masat e ndërmarra për të garantuar cilësinë e raporteve të vlerësimit të jashtëm të shkollave - Portugali*

Autorë: Isabel Barata dhe Rosa Micaelo

Në Portugali, që nga fillimi i zbatimit të procesit të vlerësimit të jashtëm (2007), të gjitha raportet e shkollave janë publikuar në faqen e internetit të Inspektoratit në mënyrë që shkollat, prindërit, komunitetet arsimore, politikëbërësit, bota akademike dhe çdo person tjetër i interesuar të mund t'i aksesojnë dhe të informohen në lidhje me përmbajtjen e tyre. Interesi i vazhdueshëm publik përforcon nevojën që Inspektorati të vendosë për krijimin e procedurave të brendshme që synojnë garantimin e cilësisë së raporteve të publikuara. Për këtë arsye është përgatitur edhe një manual ku prezantohen rregullat në lidhje me stilin dhe mënyrën e shkrimit/përpilimit të raporteve, i cili kontribuon në punën për standardizimin e dokumentit institucional dhe të gjithë përpiluesit duhet t'i përmbahen pikërisht këtij manuali gjatë përgatitjes së raportit. Për këtë arsye, edhe pse secili prej anëtarëve të ekipit kontribuon me anën e pohimeve të ndryshme në këtë raport (gjykime vlerësuese dhe prova mbështetëse), shkrimi/përpilimi i raportit realizohet nga një inspektor i caktuar më parë në rolin e koordinatorit të ekipit.

Diskutimi i parë në lidhje me raportin kryhet gjatë një takimi të ekipit vlerësues, përmes leximit me sy kritik të tij, ku ata prezantojnë dhe diskutojnë korrigjimet dhe/ose përmirësimet e propozuara në tekstin e shkruar/përpiluar nga personi përgjegjës dhe arrijnë një konsensus në lidhje me tekstin e formuluar. Këto ndryshime të propozuara mund të fokusohen tek përmbajtja dhe formati i raportit, për të bërë atë sa më të qartë dhe të përshtatshëm.

Ky diskutim pasohet nga një rishikim i kryer nga një ose më shumë inspektorë të cilët, në çdo rajon të Inspektoratit, janë përgjegjës për leximin e raporteve për të garantuar respektimin e rregullave të përcaktuara në manual dhe për të pyetur ekipin për aspekte që kanë nevojë për sqarim dhe/ose arsyetim të mëtejshëm. Pas këtij shqyrtimi, dokumenti i dërgohet shkollës në formën e "projekt raportit".

Kjo procedurë bën të mundur shpalljen zyrtare, si dhe krijon mundësi për shkollën për të konfirmuar ose sugjeruar korrigjimin e informacionit që përmban raporti.

Në disa raste, lind nevoja që raporti t'i dërgohet për shqyrtim ekipit koordinues kombëtar për vlerësimin e jashtëm të shkollave, veçanërisht nëse ai përmban informacione të ndjeshme social-politike (p.sh., vlerësime në pikat ekstreme të shkallës së vlerësimit) ose nëse vlerësimi i mëparshëm ka identifikuar mospërputhje ose mungesë koherence që nuk ka qenë e mundur të adresohen nga ekipi i vlerësimit.

Dhe e fundit, drejtuesit e degëve rajonale të Inspektoratit lexojnë secilin prej raporteve përpara se t'i dërgohen shkollave përkatëse. Këto lexime të njëpasnjëshme e ndihmojnë atë për t'u njohur me punën inspektorëve, gjë e cila shërben si bazë për debate të ndryshme dhe shkëmbime në takime përgatitore/trajnuese, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre profesionale.

## *2.2. Manual për raportin e vlerësimit të jashtëm të shkollës: Standardizimi i mënyrës së shkrimit/përpilimit të tij – Portugali*

Autorë: Isabel Barata dhe Rosa Micaelo

Shkrimi/përpilimi i raporteve të vlerësimit të jashtëm të shkollave është një përpjekje shumë komplekse dhe e vështirë. Korrektësia dhe qartësia e stilit janë po aq thelbësore sa saktësia teknike dhe drejtësia e gjykimeve. Kështu, sinteza, kuptueshmëria dhe përshtatshmëria e shkrimit janë shqetësimet kryesore për vlerësuesit. Raporti shërben si një përmbledhje e punës së kryer, e cila i dërgohet shkollës, publikohet dhe mbetet si provë dokumentare e procesit të vlerësimit.

Në këtë aspekt, vlerësuesit investohen në punën për formulimin sa më të kujdesshëm të tekstit, duke marrë parasysh ndikimin e çdo deklaratë dhe çdo fjale. Ata gjithashtu duhet t'i japin përparësi informacionit që duhet përfshirë në raport dhe çfarë duhet hequr për të përmbushur kërkesat teknike të raporteve, si numri maksimal i faqeve dhe numri i rreshtave për secilën fushë të analizës.

Për të standardizuar dhe harmonizuar disa rregulla të caktuara të shkrimit dhe stilit, Inspektorati Portugez ka përgatitur një dokument udhëzues (bashkangjitur) që synon të jetë dinamik, që do të thotë se ai do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke u bazuar në burime dhe kontribute të ndryshme nga të gjithë personat që janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e jashtëm të shkollës. Ky dokument përmban udhëzime për strukturën dhe përmbajtjen e secilës pjesë të raportit, për planifikimin dhe procedurat, si dhe udhëzime në lidhje me terminologjinë dhe stilin e të shkruarit.

Dokumenti i lartpërmendur shërben si një mbështetje e rëndësishme për vlerësuesit, por nuk zëvendëson detyrën thelbësore të rishikimeve të njëpasnjëshme të nevojshme për të garantuar cilësinë e tekstit përfundimtar. Rishikimi organizohet në faza të ndryshme, ku përfshihet rishikimi nga koordinatori i grupit vlerësues, nga ekipi gjatë takimit të përbashkët përfundimtar dhe më pas nga lexues të tjerë nga shërbimet e inspektoratit.

### **Shtojcë:**

*Avaliação Externa das Escolas - Orientações para a elaboração do relatório de escola*

## *2.3. Pse është i rëndësishëm publikimi i përmbledhjeve të raporteve të vlerësimit të jashtëm – Maqedonia e Veriut*

Autorë: Antonela Stojanoska, Valentina Gocevska, Ardijana Isahi Palloshi

### 1. Në nivel shkollë

Raporti i vlerësimit të jashtëm (vlerësimi integral në Maqedoninë e Veriut) të shkollës i dorëzohet institucionit arsimor, këshillit të shkollës, këshillit të prindërve, kryetarit të komunës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit. Raporti vihet në dispozicion të publikut dhe një përmbledhje e raportit publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë. Bazuar në rekomandimet e raportit, Bordi i shkollës përgatit planin e veprimit për aktivitetet e propozuara si reagim ndaj vlerësimit të jashtëm. Plani përmban veprime që duhet të ndërmerren shkolla për përmirësimin e punës së saj, në përputhje me rekomandimet e paraqitura në raport. Aktivitetet e përmirësimit përfshihen në Programin Vjetor të Punës

së shkollës. Programi vjetor miratohet nga themeluesi dhe publikohet në faqen zyrtare të shkollës (shembuj në dokumentet shtesë).

Rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit të jashtëm kanë të bëjnë me:

- planifikimin më të mirë të vetëvlerësimit/punës zhvillimore për shkollat;
- mbajtjen e dokumentacionit më të mirë;
- sugjerimin e mënyrave të bashkëpunimit për prindërit, bordin e shkollës, komunitetin lokal dhe të biznesit dhe shoqërinë civile;
- forcimin e besimit ndërmjet shkollave dhe rritjen e bashkëpunimit dhe të mbështetjes reciproke.

## 2. Në nivel sistemi

Në fund të vitit kalendarik, Inspektorati Shtetëror Arsimit përgatit një raport vjetor me rekomandime për kryerjen e ndërhyrjeve sistematike dhe operacionale për përmirësim. Raporti i dorëzohet Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Raporti i punës vihet në dispozicion të publikut.

Rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit të jashtëm përdoren për nxitjen e diskutimeve ndërmjet profesionistëve dhe institucioneve që do të inkurajojnë realizimin e ndërhyrjeve sistematike. Kjo shoqërohet edhe me ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm për përmirësimin e sistemit dhe procesit arsimor (si për shembull, ndërtimi i sallave sportive, pajisjet laboratorike, rregulloret për mënyrën e ushqyerjes, etj.).

Dokumente shtesë:

1. Përmbledhje e vlerësimit integral të shkollave - [Интегрална евалуација \(mon.gov.mk\)](http://mon.gov.mk)
2. Raporti vjetor, përfshirë rekomandimet përkatëse - [Годишен извештај | Државен просветен инспекторат \(dip.gov.mk\)](http://dip.gov.mk)

## D. Specifikat e AFP-së

### 1. Vëzhgimi i mjedisit mësimor, mjeteve dhe pajisjeve – Kosovë\*

Autor: Donjeta Nimani Binçe

Procesi i validimit dhe akreditimit të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisit Profesional (IAAP)<sup>7</sup> në Kosovë kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).

Procesi i akreditimit (si proces i vlerësimit të jashtëm) siguron që institucionet të përmbushin kriteret dhe standardet e cilësisë për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimeve/moduleve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës.

Ekipi i ekspertëve është përgjegjës për vlerësimin e kualifikimeve dhe të dokumentacionit të institucioneve, si dhe të dokumenteve të tjera sipas udhëzimeve të AKK-së.

Ekipi i vlerësimit të jashtëm (në rastin e Kosovës quhet ekipi i ekspertëve) orientohen për ndjekjen e procedurave, kriterëve dhe të kërkesave nga udhëzimi administrativ për procedurat e validimit të kualifikimeve profesionale dhe të akreditimit, më konkretisht:

**Neni 10 - Kriteret e Akreditimit** - Kapaciteti për të përmbushur kërkesat për një kualifikim specifik: Hapësira e nevojshme për ofrimin ose vlerësimin e kualifikimeve dhe moduleve; Burimet materiale të nevojshme për ofrimin ose vlerësimin e kualifikimeve/moduleve; ose ndonjë kërkesë tjetër specifike për kualifikime specifike. Procesi i vlerësimit të jashtëm duhet të shqyrtojë edhe kapacitetin për të përmbushur kërkesat që vlerësimi i kualifikimit të bëhet në mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.

Kërkesat në lidhje me mjedisin mësimor, mjetet dhe pajisjet për një kualifikim të caktuar përcaktohen në dokumentin e standardeve të profesionit. Standardi i profesionit është një dokument që pasqyron njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që nevojiten për kryerjen e detyrave dhe veprimtarive të punës në profesione të caktuara, në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Sipas kuadrit legjislativ, çdo kurrikul duhet të bazohet në funksionet dhe kërkesat e standardeve të profesioneve.

Përveç kësaj, kërkesat për instrumentet dhe pajisjet e nevojshme janë të specifikuara në detaje në çdo modul të programit/kurrikulës së kualifikimit.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtyre kërkesave, institucionet e AAP-së duhet të paraqesin dokumente të tilla si:

- Lista e kontrollit për dokumentet e kërkuara për procesin e akreditimit dhe validimit (shembulli nr.1);
- Plani i infrastrukturës së institucioneve të AAP-së;
- Lista e mjeteve dhe pajisjeve;
- Pronësia e objektit/marrëveshja për përdorimin e objektit;
- Marrëveshja me biznesin dhe ndërmarrjet;
- Rregulloret e brendshme për shëndetin dhe sigurinë;

---

<sup>7</sup> Institucionet e Arsimit dhe Formimit/Aftësisit Profesional u referohen institucioneve që ofrojnë kualifikime të AFP-së (shkollat, qendrat e formimit, akademitë, etj.).

- Lista e mjeteve të sigurisë etj.

Gjetjet e procesit të vlerësimit të bazuara tek evidencat, vizitat në terren, diskutimet, intervistat e zhvilluara në kuadrin e vlerësimit të jashtëm janë pjesë e raportit të vlerësimit, shoqëruar edhe me deklaratat dhe gjykimet për kritere specifike të cilat janë ilustruar në shembullin nr. 2.

**Shtojca:**

- Udhëzues për ofruesit e AFP-së (Shqipëri)
- Raporti i vlerësimit të jashtëm për validimin (Shqipëri)
- Raporti i vlerësimit të jashtëm për akreditimin (Shqipëri)



## *2. Treguesit e bashkëpunimit mes shkollave dhe bizneseve - Bavari – Gjermani*

Autorë: Steffi Hempel, Margit Schmidbauer

Vlerësimi i jashtëm në shkollat profesionale në thelb ndjek konceptin bazë dhe kryhet mbi bazën e një kuadri të standardizuar vlerësimi për të gjitha llojet e shkollave bavareze (Tabela Bavareze e Cilësisë). Prandaj, nëse vlerësohet një shkollë normale biznesi, një shkollë e lartë profesionale, një shkollë profesionale e arsimit dual ose një shkollë e mesme profesionale, ai kryhet si një "vlerësim standard", që do të thotë se rregullimet e zakonshme specifike të shkollës (në fakt rregullimi i formulimit) në dokumentet e punës dhe anketat online hyjnë menjëherë në fuqi, ndërsa kuadri i cilësisë dhe metodat/instrumentet nuk modifikohen. Treguesit specifikë për bashkëpunimin ndërmjet shkollave profesionale dhe kompanive dhe për organizimin e të nxënimit nëpërmjet punës nuk janë renditur në mënyrë eksplicite.

Për plotësimin e kërkesave të shkollave profesionale dhe të procesit të të nxënimit nëpërmjet punës, vlerësimi i jashtëm kryhet nga ekipe vlerësimi specifike për shkollën. Prandaj, ekipi i interpreton edhe treguesit në mënyrë specifike për llojin e shkollës.

Shembuj:

B2 Promovimi i interesave/B2.2 Shkolla promovon angazhimin në fusha të ndryshme të jetës.

B2.2.2 Shkolla punon në mënyrë sistematike me partnerë jashtëshkollorë.

B2.2.3 Shkolla ofron mbështetje të veçantë për orientimin profesional dhe zhvillimin e mëtejshëm.

D3 Bashkëpunimi me prindërit dhe partnerët e bashkëpunimit/D3.2 Puna edukative koordinohet me pjesën tjetër të personelit të shkollës dhe partnerët e bashkëpunimit.

D3.2.2 Janë krijuar struktura të përshtatshme për bashkërendimin e punës mësimore me partnerët e bashkëpunimit.

Termet "partnerë jashtëshkollorë" dhe "partnerë koordinues" përdoren kryesisht për bashkëpunimin me kompanitë e trajnimit ose partnerët e praktikës profesionale.

Si pjesë e anketave online, ofruesit partnerë të trajnimeve pyeten në mënyrë specifike nëse:

Mësimi

- Kursantët janë në gjendje të zbatojnë në praktikë atë që kanë mësuar në shkollën profesionale.
- Shkolla profesionale i pajis kursantët me aftësi teknike në lidhje me punën.
- Shkolla profesionale u mëson kursantëve aftësi metodologjike të lidhura me profesionin (si për shembull, strategjitë për zgjidhjen e problemeve).
- Shkolla profesionale u mëson kursantëve aftësi të rëndësishme sociale (si për shembull, aftësinë për të punuar në grup).
- Shkolla profesionale u mëson kursantëve qëndrimet bazë të punës (si për shembull, përpikmëria, besueshmëria).
- Shkolla profesionale u mëson kursantëve aftësitë bazë për përdorimin e mediave digjitale (si për shembull, programet kompjuterike përkatëse në lidhje me punën).

- Mësuesit marrin parasysh zhvillimin profesional dhe rrishtë në mësimdhënien e tyre.

#### Bashkëpunimi

- Nëse kam ndonjë shqetësim apo pyetje, di kë të kontaktoj në shkollën profesionale.
- E kam të qartë dhe është e rregulluar mirë mënyra e marrjes së informacionit të nevojshëm nga shkolla (si për shembull, niveli i performancës së kursantëve).
- Shkolla profesionale koordinon çështjet edukative me ne (si për shembull, në rast sjelljeje të pahijshme dhe shkelje të rregullave).
- Nëse një kursant ka nevojë për mbështetje të veçantë, shkolla profesionale do të punojë me ne për të gjetur zgjidhje.
- Trajnerët nga kompania jonë janë të ftuar posaçërisht si ekspertë.
- Shkolla profesionale komunikon me ne për mënyrën e përcjelljes së përmbajtjes së trajnimit.
- Kompania jonë e trajnimit mund të bëjë sugjerime për optimizimin e trajnimit në shkollën profesionale.
- Ne jemi të mirëinformuar për mundësinë për të shprehur mendimin tonë si partnerë trajnimi (si për shembull, në bordin këshillimor të shkollës profesionale).
- Shkolla profesionale është e hapur ndaj ideve tona për organizimin e jetës shkollore.

Rezultatet, veçanërisht rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët online të përshtatur posaçërisht për partnerët e trajnimit, nuk raportohen në kontekstin e "të nxënimit nëpërmjet punës", por në kontekstin e treguesve të përgjithshëm të kornizës sonë të cilësisë.

Prandaj, mungojnë rezultatet specifike në lidhje me cilësinë e të nxënimit profesional, dhe kemi vetëm mendime/përshtypje për cilësinë e përgjithshme të mësimdhënies (treguesit standardë të mësimdhënies së mirë). Cilësia e të nxënimit nëpërmjet punës nuk vlerësohet në mënyrë eksplicite dhe nuk mund të bëhet asnjë deklaratë në lidhje me të, pasi mungojnë të dhënat.

Tabloja Bavareze e Cilësisë



### 3. Gjurmimi i të diplomuarve - Uells

Autor: Mamta Arnott

Arsimi në Uells është i detyrueshëm për fëmijët deri në moshën 16 vjeç.

#### **Gjurmimi i nxënësve në përfundim të arsimit të detyrueshëm**

Çdo nxënës ka një numër unik, i cili përdoret për të regjistruar rezultatet e arritura në faza të ndryshme të shkollimit të tyre. *Careers Wales*, një organizatë kombëtare që mbështet nxënësit me shërbime konsulence dhe orientimi pas arsimit të detyrueshëm, e përdor numrin unik të nxënësit për të verifikuar nëse një nxënës ka vazhduar të angazhohet në arsim apo formim të mëtejshëm. Së bashku me informacionin e marrë nga shkolla, ata përcaktojnë edhe nëse nxënës të tjerë janë sistemuar në një vend pune. Ky aspekt nuk është ende i pasqyruar në bazën e të dhënave të punësimit dhe ish-shkollës së nxënësve i duhet që ta verifikojë këtë informacion. Mënyrat që përdoren për gjetjen e informacionit në fjalë ndryshojnë nga ofruesi në ofrues, dhe kjo e bën edhe më problematik marrjen e informacionit të besueshëm dhe të qendrueshëm. Në rastet kur një nxënës nuk ka vazhduar më tej angazhimin e tij në arsim, trajnim apo punësim pas moshës 16 vjeç, informacioni për ta kategorizohet si 'Nuk dihet' ose si 'NEET'(persona as në arsim, as në punësim apo trajnim).

Organizata *Careers Wales* i përcakton destinacionet e nxënësve përmes një ankete vjetore. Ajo e ndihmon stafin e karrierës në punën e tyre si dhe partnerët për të planifikuar mundësitë për mësim, trajnim dhe punësim.

#### **Gjurmimi i nxënësve pas moshës 16 vjeçare (pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm)**

Për nxënësit që vazhdojnë arsimimin ose trajnimin përtej moshës 16 vjeçare, përparimi i tyre monitorohet në 3 mënyra:

- Arritjet – matja e rezultateve të arritura nga nxënësit që angazhohen në programe mësimore të nivelit të avancuar, në programe profesionale dhe për marrjen e diplomës në Uells. Këto raporte përmbajnë krahasimet në nivel kombëtar si dhe standardin demografik që merr në konsideratë karakteristikat e nxënësve dhe performancën e mëparshme, duke përfshirë numrin e mungesave të tyre dhe mungesat pa arsye në vitin e fundit të arsimit të detyrueshëm.
- Vlera e Shtuar – matja e progresit të nxënësve, duke e krahasuar me pritshmëritë dhe parashikimet normale në bazë të moshës dhe gjinisë. Aktualisht, kjo është pezulluar për shkak të ndërprerjes së vlerësimeve në vitet 2020 dhe 2021, si rezultat i pandemisë COVID-19.
- Destinacionet – matja e përqindjes së nxënësve që përparojnë drejt arsimit të mëtejshëm (përfshirë arsimin e lartë) ose punësimit. Ky informacion lidhet me të dhënat e punësimit.

Shihni linkun më poshtë për grupet e të dhënave që përdoren për nxjerrjen e këtij informacioni.

Këto të dhëna përdoren në disa mënyra për të vlerësuar efektivitetin e procesit të të nxënës.

- Ato janë pjesë e bazës së të dhënave të përdorura nga inspektorati (Estyn) gjatë inspektimit ose vlerësimeve tematike;

- Ato i ndihmojnë ofruesit arsimorë për të vlerësuar performancën e tyre dhe për të identifikuar pikat që kanë nevojë për përmirësim.

Planet për publikimin e këtij informacioni u ndërpre në për shkak të pandemisë COVID-19. Nëse do të publikohet, ai mund të ndihmojë publikun e gjerë, veçanërisht nxënësit, prindërit dhe kujdestarët e tyre, për të marrë vendime, krahas edhe faktorëve të tjerë, në lidhje me zgjedhjen sa më të mirë të ofruesve dhe kurseve mësimore dhe angazhimit me ofruesit për performancën e tyre.

### **Gjurmimi i lëvizjes së nxënësve para përfundimit të arsimit të detyrueshëm**

Të dhënat e regjistrimit të nxënësve të përputhura me ofruesit përdoren për të gjurmuar vendndodhjen e nxënësve që lëvizin nga shkolla në shkollë ose në një njësi referuese të nxënësve. Nëse ata janë shkolluar në shtëpi, autoriteti përgjegjës për monitorimin e këtyre nxënësve është autoriteti lokal që punon me *Careers Wales* për të gjurmuar lëvizjet e mëtejshme të këtyre nxënësve.

Dokumente shtesë:

[Careers Wales – Destination Data](#)

[Post 16 Consistent Performance Measures](#)

#### *4. Treguesit përkatës për vlerësimin e jashtëm të programeve të arsimit dhe formimit profesional dual - Moldavi*

Autorë: Liudmila Arhiliuc, Elena Petrov

#### **Objektivi:**

- Identifikimi i përputhshmërisë së procesit të studimit në kuadër të programeve të studimit të arsimit dhe formimit profesional (AFP) dual;
- Përcaktimi i efektivitetit të metodave mësimore në programet e studimit të AFP-së duale.

#### **Përmbajtja:**

Në përputhje me [Methodology of external quality evaluation for the authorization of provisional operation and accreditation of vocational education and training, higher education and professional continuous training study programmes and institutions from the Republic of Moldova](#) (në tekstin e mëtejshëm referuar si *Metodologjia*), treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e programeve të studimit të AFP-së duale janë:

- 3.1.1. Format e organizimit të procesit mësimor;
- 3.1.2. Metodatat e mësimimit me në qendër nxënësin;
- 3.2.1. Organizimi i praktikave profesionale;
- 3.3.1. Organizimi i procesit të vlerësimit të rezultateve akademike;
- 3.3.2 Organizimi i procesit të vlerësimit të praktikave profesionale;
- 4.2.1. Promovimi i nxënësve;
- 6.2.1. Financimi i procesit arsimor në kuadër të programeve të studimit të AFP-së.

Për të rritur efikasitetin e procesit të vlerësimit dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në komisionet e vlerësimit të jashtëm të programeve të studimit të AFP-së duale përfshihen ekspertë të deleguar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë dhe agjentë ekonomikë nga degë të ndryshme.

Gjatë procesit të vlerësimit shqyrtohen evidencat e paraqitura nga institucioni dhe analizohen informacionet e marra nga intervistat me përfaqësuesit e institucionit, përfaqësuesit e njësisë mësimore dhe nxënësit e programit. Kjo bën të mundur identifikimin e sa më poshtë:

- kontributi i pjesëmarrësve në përcaktimin e grafikut të aktiviteteve sipas programit (sipas ligjit nr. 110/2022 për arsimin dual, përqindja e kohës së trajnimit brenda institucionit arsimor dhe në njësinë e trajnimit është 20-30% kundrejt 70-80% për ISCED 3 dhe 50%-50% për ISCED 4);
- pesha e metodave të trajnimit teorik dhe praktik që lejojnë arritjen e objektivave të parashikuara sipas programit të vlerësuar;
- metoda e vlerësimit të proceseve mësimore dhe vlerësimi i aftësive të zhvilluara gjatë trajnimit, veçanërisht fazat e vlerësimit, stafi mësimor i përfshirë, personeli përgjegjës për trajnimin brenda njësisë mësimore dhe kriteret e vlerësimit të aplikuara për të konfirmuar përvetësimin e aftësive të pritshme nga nxënësit sipas programit të trajnimit;
- burimet e financimit të procesit të trajnimit në kuadër të programeve të AFP-së duale, proporcionaliteti i kontributit të pjesëmarrësve në krahasim me përfitimet e marra, sigurimi i materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për të kryer aktivitetet mësimore dhe prodhuese.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së programeve të studimit të AFP-së duale, komisioni i vlerësimit të jashtëm mund të vlerësojë nivelin e përfshirjes së njësisë në procesin e vlerësimit dhe certifikimit të aftësive profesionale të nxënësve, shkallën e kalueshmërisë së nxënësve në provimet e kualifikimit, dhe lidhjen e programit me tregun e punës, njësinë e përfshirë mësimore dhe tendencat për modernizimin dhe përditësimin e programeve në përputhje me punën praktike që kryhet në sektorin e prodhimit.



## *5. Treguesit specifike për AFP-në në kuadrin e AFP-së së përbashkët dhe metodologjisë së përgjithshme – Mali i Zi*

Autor: Vladislav Koprivica

Në Republikën e Malit të Zi, të gjitha institucionet vlerësohen nga jashtë nga një ekip i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të Byrosë për Shërbimet Arsimore dhe të Qendrës për Arsim Profesional. Për sigurimin dhe rritjen e cilësisë së punës në institucionet arsimore është krijuar një metodologji e përbashkët. Vlerësimi kryhet në pesë fusha kryesore. Për secilën prej këtyre fushave është përcaktuar një numër i caktuar i standardeve të cilësisë si dhe një numër i caktuar treguesish për secilin prej këtyre standardeve. Duke qenë se kjo është një metodologji që përdoret si për arsimin e përgjithshëm ashtu edhe atë profesional, për arsimin profesional janë shtuar një sërë treguesish të tjerë që i referohen vetëm atij.

### **Fusha: Mësimdhënia dhe të nxënit**

*Standardi: Planifikimi duke u bazuar në kërkesat e kurrikulës*

Treguesit e AFP-së:

- Në shkollë planifikohet zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme për ofrimin e mësimit praktik dhe monitorimin e cilësisë së tij.
- Në shkollë planifikohen forma të ndryshme bashkëpunimi me punëdhënësit.

*Standardi: Mësimdhënia përshtatet me karakteristikat zhvillimore, nevojat dhe aftësitë e nxënësve dhe fokusohet në arritjen e rezultateve të të nxënit.*

Treguesit e AFP-së:

- Institucioni i fokuson aktivitetet e tij në punën për zhvillimin e kompetencave kyçe.

*Standardi: Monitorimi, vlerësimi dhe konstatimi i njohurive të nxënësve është i rregullt, publik dhe i larmishëm dhe ka funksion zhvillimor.*

Treguesit e AFP-së:

- Institucioni i arsimit profesional vendos dhe ruan bashkëpunim efektiv me punëdhënësit gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të nxënësve.

### **Fusha: Menaxhimi dhe lidërshipi**

*Standardi: Drejtori krijon një mjedis stimulues për mësimin, zhvillimin profesional dhe avancimin e punonjësve.*

Treguesit e AFP-së:

- Institucioni siguron fonde shtesë për përmirësimin e mënyrës së funksionimit të institucionit.

**Fusha: Etika shkollore**

Standardi: *Shkolla ka zhvilluar bashkëpunimin dhe promovimin e rezultateve në të gjitha nivelet.*

Treguesit e AFP-së:

- Institucioni i arsimit profesional krijon partneritete me partnerët socialë (punëdhënësit).
- Nxënësit janë të interesuar për t'u regjistruar në një program të caktuar mësimor.

**Fusha: Arritjet akademike**

Standardi: *Numri i nxënësve që braktisin shkollën është më i ulët se standardi evropian.*

Treguesit e AFP-së:

- Përqindja e nxënësve që kanë braktisur shkollën është më pak se 10%.
- Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përjashtuar, përqindja e nxënësve të përjashtuar për shkak të mungesave pa arsye është më pak se 80%.
- Përqindja e nxënësve që i nënshtrohen provimit përfundimtar pas braktisjes së shkollës është më e lartë se 80%.
- Shkolla përcakton dhe zbaton masa për uljen e numrit të mungesave.

**Fusha: Mbështetja e nxënësve**

Standardi: *Shkolla mbështet dhe inkurajon zhvillimin integral të nxënësve.*

Treguesit e AFP-së:

- Shkolla ofron mbështetje për nxënësit në fushën e karrierës përmes orientimit dhe këshillimit profesional.

Shkolla mban evidenca për zhvillimin e mëtejshëm profesional të nxënësve pas diplomimit.

## *6. Kontrollimi i kushteve të mjedisit mësimor në biznes dhe shkolla dhe i mënyrës se si punojnë bizneset me fëmijët gjatë praktikës profesionale - Kosovë\**

Autor: Valbona Fetiu Mjeku

### **Mësuesi/instruktori i praktikës profesionale në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) duhet të:**

1. Sigurojë që të gjitha dokumentet e nevojshme, përfshirë planin individual dhe kontratën për praktikën profesionale, të nënshkruhen përpara se nxënësi/kandidati të sistemohet në praktikë profesionale në biznes.
2. Mbështesë personin përgjegjës të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional për praktikat profesionale në biznes, për të kryer sigurimin nga aksidentet për nxënësit/kandidatët që kanë nënshkruar kontratën për këtë qëllim.
3. Mbështesë nxënësin/kandidatin në punën për arritjen e objektivave dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara në planin individual të praktikës profesionale në biznes.
4. Njoftojë/orientojë çdo nxënës/kandidat në lidhje me objektivat e planit individual të praktikës profesionale në biznes.
5. Monitorojë ecurinë e nxënësit/kandidatit në vendin e punës dhe të vlerësojë nxënësin me notën përfundimtare për modulin profesional.
6. Informojë nxënësin/kandidatin në lidhje me procedurat dhe kriteret për vlerësimin e arritjeve gjatë praktikës profesionale në biznes.
7. Mbajë kontakte të vazhdueshme me instruktorin në ndërmarrje për të monitoruar ecurinë e praktikës profesionale në biznes dhe përparimin e nxënësit/kandidatit.
8. Përgatisë raporte monitorimi pas çdo vizite monitoruese në vendin e punës.
9. Raportoje tek personi përgjegjës i IAAP-së për praktikat profesionale për mbarëvajtjen e procesit dhe nëse duhet ndërmarrë ndonjë masë korrigjuese.

### **Instruktori në ndërmarrje duhet të:**

1. Ndihmojë nxënësin/kandidatin në punën për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të përcaktuara në planin e praktikës profesionale në biznes.
2. Verifikojë dëshminë e sigurimit ndaj aksidenteve përpara se nxënësi/kandidati të sistemohet në vendin e punës.
3. Njoftojë/orientojë çdo nxënës/kandidat për rregullat e brendshme, operacionet dhe hierarkinë ekzistuese të ndërmarrjes dhe t'i udhëzojë ato në lidhje me masat e sigurisë dhe shëndetit në punë, në përputhje me rregulloret në fuqi.
4. Organizojë hapësirën e punës për çdo nxënës/kandidat duke siguruar dokumentacionin e duhur teknik dhe teknologjik, mjetet, makineritë, pajisjet dhe materialet për zbatimin sa më të sigurt të praktikës profesionale në biznes.

### **Monitorimi dhe vlerësimi:**

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është ndjekja e ecurisë së punës për zbatimin e planit të praktikës profesionale në biznes, vlerësimi i nivelit të kënaqësisë së ndërmarrjeve dhe nxënësve/kandidatëve dhe vlerësimi i nivelit të përmbushjes së aktiviteteve të modulit praktik të praktikës profesionale.

Monitorimi i nxënësve/kandidatëve kryhet nga mësuesi i praktikës profesionale/instruktori IAAP-së, i cili e monitoron procesin nëpërmjet vizitave në ndërmarrje të paktën një herë në dy javë dhe plotësimit të formularit të monitorimit.

Monitorimi mund të kryhet edhe sipas nevojës për të regjistruar praninë dhe përparimin e nxënësve/kandidatëve dhe për të marrë mendime apo sugjerime nga sipërmarrësit dhe nxënësit/kandidatët.

Informacioni i mbledhur nga vizitat monitoruese i dërgohet në formë raporti personit përgjegjës dhe drejtuesve të IAAP-së. Nëse gjatë kësaj periudhe konstatohet ndonjë vështirësi apo problematikë, ato duhet të raportohen te drejtori i IAAP-së për të marrë vendime për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Në përfundim, personi përgjegjës i IAAP-së për praktikën profesionale në biznes përgatit raportin vjetor për realizimin e saj, bazuar në informacionin e gjeneruar nga monitorimi i kryer nga nga mësuesi/instruktori i praktikës profesionale të IAAP-së dhe ia paraqet atë drejtuesve të IAAP-së.

Vlerësimi si proces përfshin vlerësimin e vazhdueshëm të punës për zbatimin e planit të praktikës profesionale në biznes dhe vlerësimin e rezultateve të arritura nga nxënësi/kandidati, i cili kryhet nga instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje. Ndërkohë, instruktori përgjegjës për praktikën profesionale në IAAP cakton notën përfundimtare, në bazë të vlerësimit të praktikës profesionale nga instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje.

Gjithashtu, me qëllim marrjen e mendimit të partnerëve në lidhje me procesin dhe ndikimin e praktikës profesionale në biznes, përmes personit përgjegjës për këtë aktivitet, IAAP mund të vlerësojë nivelin e kënaqësisë së biznesit dhe nxënësit/kandidatit gjatë realizimit të procesit të të nxënësve nëpërmjet punës.



## 7. Vlerësimi i jashtëm i programeve të studimit të AFP-së - Moldavi

Autorë: Elena Petrov, Liudmila Arhiliuc

### Objektivat:

- 1) garantimi i komunitetit arsimor/akademik, përfituesve, punëdhënësve dhe publikut të gjerë në përgjithësi që programi i studimit dhe institucioni arsimor përmbushin nivelin minimal të cilësisë, në lidhje me standardet kombëtare të referencës dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 2) ofrimi i ndihmesës për institucionet arsimore në punën për zhvillimin e administrimit efikas dhe të kulturës autentike të cilësisë, si dhe për demonstrimin e statusit të tyre me anën e evidencave dhe dokumenteve reale dhe përkatëse;
- 3) mbështetja e institucioneve arsimore në procesin e përafrimit me vlerat e Zonës Evropiane të Arsimit;
- 4) nxitja e përfshirjes së institucioneve arsimore në promovimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit arsimor, kërkimit, inovacionit, krijimit artistik, të demonstruara përmes rezultateve përkatëse të ndërlydhura me kërkesat e tregut të punës;
- 5) mbështetja e institucioneve arsimore në procesin e krijimit të kushteve për lëvizshmëri akademike dhe njohje reciproke të dokumenteve të studimit;
- 6) nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore në punën për drejtimin, monitorimin dhe krahasimin e cilësisë së procesit arsimor;
- 7) identifikimi, publikimi dhe mospranimi i asnjë përpjekjeje për vënien në funksionim të një programi studimi ose institucioni arsimor që nuk plotëson standardet minimale të cilësisë.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së programit të studimit bëhet për (1) autorizimin e funksionimit të përkohshëm (i jep të drejtën e realizimit të procesit arsimor) ose (2) akreditimin (i jep të drejtën për realizimin e procesit arsimor dhe lëshimin e diplomave, bazuar në provimet përfundimtare).

Programet e studimit i nënshtrohen vlerësimit të jashtëm të cilësisë çdo 5 vjet ose në përfundim të periudhës së autorizimit ose akreditimit të tyre të përkohshëm. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë mund të organizohet për çdo program studimi ose për çdo grup programesh studimi në të njëjtën fushë të formimit profesional, duke përfshirë programet ndërdisiplinore. Vlerësimit të jashtëm të cilësisë së programeve të studimit i paraprin vlerësimi i brendshëm i cilësisë (vetëvlerësimi) që realizohet nga institucioni arsimor.

Procedura e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për autorizimin e funksionimit të përkohshëm ose akreditimin e programit të studimit/grupit të programeve të studimit përbëhet nga fazat e mëposhtme:

- 1) Nisja e procedurës së vlerësimit nga institucioni arsimor/konsorciumi/partneriteti/dega/themeluesi/ Ministria e Arsimit dhe Kërkimit (Ministria);
- 2) Vlerësimi i brendshëm i cilësisë (vetëvlerësimi) dhe përgatitja e Raportit të Vetëvlerësimit për çdo program studimi/grup programesh studimi, bazuar në standardet, kriteret dhe treguesit e përcaktuar;<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Shih Shtojcën 3, [Government Decision No. 616/2016](#)

3) Vlerësimi i jashtëm i cilësisë:

- a) dorëzimi në Agjenci i aplikimit dhe dosjes në formë fizike dhe elektronike, të plotësuar sipas modelit të ofruar;
  - b) shqyrtimi i dosjes dhe formulimi i kërkesave për plotësimin e dosjes (sipas rastit);
  - c) miratimi i vendimit për nisjen/refuzimin e procedurës së vlerësimit të jashtëm nga Bordi Drejtues i Agjencisë;
  - ç) ngritja e Panelit për Vlerësimin e Jashtëm;
  - d) analizimi i Raportit të Vetëvlerësimit;
  - dh) zhvillimi i vizitës së vlerësimit në institucionin arsimor dhe plotësimi i “Skedës së regjistrimit të vizitës në terren”;
  - e) hartimi i Raportit të Vlerësimit të Jashtëm;
  - ë) shqyrtimi dhe validimi i rezultateve të vlerësimit të jashtëm nga Komisioni i Profileve<sup>9</sup> dhe dorëzimi i vendimeve të propozuara, të shoqëruar me procesverbalin përkatës, në Bordin Drejtues të Agjencisë;
  - f) Shqyrtimi i rezultateve të vlerësimit dhe vendimmarrja nga Bordi Drejtues i Agjencisë;
- 4) Dorëzimi në Ministri i vendimit të Bordit Drejtues të Agjencisë;
- 5) Dhënia e autorizimit për funksionim/akreditim të përkohshëm nga Ministria;
- 6) Zbatimi i rekomandimeve të dala nga vlerësimi i jashtëm.

Në varësi të nivelit të arritjes së standardeve të cilësisë, merren vendimet e mëposhtme:

- autorizimi i funksionimit të përkohshëm/mosautorizimi;
- akreditimi/mosakreditimi.

Bordi Drejtues i Agjencisë miraton vendimin për autorizimin e funksionimit të përkohshëm/mosautorizimin/akreditimin/mosakreditimin, në bazë të konkluzioneve të paraqitura në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe të debateve pasuese.

Institucionet kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Bordit Drejtues në lidhje me rezultatet e vlerësimit të jashtëm.

Raportet e Vlerësimit të Jashtëm dhe vendimet e Bordit Drejtues publikohen në faqen e internetit të Agjencisë përgjegjëse për Sigurimin e Cilësisë në Arsim dhe Kërkim: [www.anacec.md](http://www.anacec.md)

Ndjekja e punës pas përfundimit të procesit të vlerësimit është një pjesë e detyrueshme e procesit të vlerësimit të jashtëm.

**Dokumente shtesë:**

<https://www.anacec.md/files/Methodology%20of%20external%20evaluation.pdf>

[https://www.anacec.md/files/Regulation\\_Profile%20committees.pdf](https://www.anacec.md/files/Regulation_Profile%20committees.pdf)

---

<sup>9</sup> Shih [\*Regulation of the profile committees of the National Agency for Quality Assurance in Education and Research\*](#)

## 8. Standardet dhe treguesit rajonalë të cilësisë për AFP-në dhe Të Nxënit nëpërmjet Punës në shkolla dhe në biznese – projekti EQET SEE

Nisma e Evropës Juglindore për Reformën Arsimore (ERI SEE) ka zbatuar gjatë periudhës 2021 – 2024 një projekt rajonal në Evropën Juglindore dhe në Republikën e Moldavisë, në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë kombëtare përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm në arsimin para-terciar. Ky projekt, i titulluar 'Rritja e Cilësisë në Arsim dhe Formim në Evropën Juglindore' (EQET SEE, [www.eqet.erisee.org](http://www.eqet.erisee.org)) është fokusuar në vlerësimin e jashtëm të institucioneve, si pjesë e proceseve të sigurimit të cilësisë.

Bazuar në nevojat e identifikuara nga disa ekonomi pjesëmarrëse, një nga detyrat e projektit ka qenë mbështetja e proceseve të vlerësimit të jashtëm në fushën e arsimit dhe formimit profesional (AFP). Gjatë këtij procesi janë zhvilluar **Rekomandimet rajonale për standardet kyçe të cilësisë dhe treguesit e cilësisë për vlerësimin e jashtëm të AFP-së**, bazuar në kornizën evropiane për sigurimin e cilësisë në AFP (EQAVET), si dhe **Rekomandimet për standardet e cilësisë dhe treguesit e cilësisë për vlerësimin e jashtëm të procesit të të nxënit nëpërmjet punës në shkolla dhe në biznese**, bazuar në Kornizën Evropiane për Praktikën Profesionale Cilësore dhe Efektive.

Propozimet u diskutuan midis përfaqësuesve të agjencive përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm të AFP-së dhe arsimit të përgjithshëm, agjencive përgjegjëse për kualifikimet, dhomave të tregtisë dhe përfaqësuesve të biznesit nga 6 ekonomitë e Evropës Juglindore dhe Republika e Moldavisë, pas së cilës ato u modifikuan dhe u miratuan në nivel rajonal. Në këtë mënyrë, ato përfaqësojnë një burim të vlefshëm frymëzimi dhe njohurish për zhvillimet e mëtejshme të sistemeve kombëtare.

**Rekomandimet rajonale për standardet kryesore të cilësisë dhe treguesit e cilësisë për vlerësimin e jashtëm të AFP-së** mund të gjenden në:

[https://eqet.erisee.org/wp-content/uploads/2024/01/Annex\\_1a\\_Standards-VET\\_final\\_EN\\_clean.pdf](https://eqet.erisee.org/wp-content/uploads/2024/01/Annex_1a_Standards-VET_final_EN_clean.pdf)

dhe **Rekomandimet për standardet e cilësisë dhe treguesit e cilësisë për vlerësimin e jashtëm të procesit të të nxënit nëpërmjet punës në shkolla dhe në biznese** mund të gjenden në:

[https://eqet.erisee.org/wp-content/uploads/2024/01/Annex\\_2a\\_Ext\\_Eval\\_WBL\\_Final\\_EN\\_clean.pdf](https://eqet.erisee.org/wp-content/uploads/2024/01/Annex_2a_Ext_Eval_WBL_Final_EN_clean.pdf).

## Pjesa III: Puna pas vlerësimit të jashtëm

### A. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit të jashtëm në nivel shkolle

Ky kapitull përfshin informacion në lidhje me mënyrën e përdorimit të rezultateve të vlerësimit të jashtëm për përmirësimin e punës së shkollave.


#### 1. Hartimi dhe zbatimi i Planit për Zhvillimin e Shkollës

##### 1.1. Hartimi i planeve strategjike institucionale të institucioneve të AFP-së – Bosnjë dhe Hercegovinë

Autorë: Saša Grabovac, Biljana Popović

Shumica e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional (AFP) do të kenë hartuar në këtë pikë ose do të fillojnë të hartojnë atë që ne përgjithësisht e quajmë plan strategjik. Kjo nënkupton planifikimin e veprimtarive të mundshme për një periudhë tre- ose pesëvjeçare. Ai duhet të përmbajë një sërë të dhënash, kryesisht për numrin e nxënësve, vijimësinë dhe arritjet e tyre, por pastaj sigurisht që do të duhet të përfshijë edhe detaje në lidhje me personelin mësimdhënës dhe ndihmës, burimet kapitale dhe materialet e konsumit etj. Përveç kësaj, institucioni i AFP-së mund të jetë duke konsideruar zgjerimin për të ofruar kurse të reja të AFP-së ose për të rritur numrin e nxënësve. Kjo duhet të planifikohet dhe të vlerësohet, me qëllim përcaktimin dhe propozimin e buxhetit përkatës. Sigurisht, që këtu bëhet fjalë vetëm për një plan dhe realiteti mund të dalë ndryshe, por kjo nuk e justifikon mospërgatitjen e një plani të detajuar dhe hartimin e objektivave për institucionin në mënyrën më të mirë të mundshme.

Disa nga aktivitetet që mund të përfshihen në planin strategjik janë:



Plani strategjik duhet të lidhet me arritjen e Vizionit dhe Deklaratave të Misionit dhe të tregojë progresin e planifikuar për arritjen e këtij objekti.

Shpesh bizneset/kompanitë në këtë pikë do të listonin ato që njihen si vlerat e tyre organizative. E njëjta gjë vlen edhe për një institucion arsimor. Vlerat mund të jenë: 'puna në ekip', 'arritjet e larta', 'kujdesi për njëri-tjetrin', 'respekti' etj.


Shembull i planifikimit strategjik:

### Shembull i një objekti strategjik për kurrikulën

#### 1. PËRGATITJA E KURSEVE DHE KURRIKULAVE QË PLOTËSOJNË KËRKESAT E PUNËDHËNËSIT

- a. Vendosija e lidhjeve të forta dhe efektive me punëdhënësit;
- b. Garantimi që kurset të bazohen në standardet e profesionit;
- c. Kurset e përgatitura duke u bazuar në rezultatet e të nxënit.
- d. Kurset përmbajnë përvojën e punës tek punëdhënësi;
- e. Kurset plotësojnë kërkesat e punëdhënësit.

Diagrami i një plani pesëvjeçar, ku përcaktohet mënyra e arritjes së objektivave të parashikuara në planin strategjik.



## 1.2. Hartimi dhe zbatimi i Planit për Zhvillimin e Shkollës – Uells

Autor: Mamta Arnott

Bazuar në Rregulloret për Planet e Zhvillimit të Shkollës (shih linkun më poshtë), organet drejtuese duhet të:

1. përgatisin planin për zhvillimin e shkollës për një periudhë trevjeçare.
2. mbulojnë fushat e mëposhtme të përcaktuara në plan, duke përfshirë:
  - dispozitën për adresimin e nevojave për zhvillimin profesional të të gjithë punonjësve, duke përfshirë edhe zhvillimin e drejtuesve.
  - mënyrën e angazhimit të punonjësve dhe të shpërndarjes së burimeve të tjera nga shkolla.
3. rishikojnë planin çdo vit si dhe pas inspektimit nga Inspektorati i Madhërisë së Tij për Arsimin dhe Formimin në Uells (Estyn).
4. konsultohen me aktorët e mëposhtëm gjatë punës për përgatitjen ose rishikimin e planit:
  - Drejtori i shkollës (nëse nuk është anëtar i organit drejtues);
  - Nxënësit e regjistruar në shkollë;
  - Prindërit ose kujdestarët e nxënësve të regjistruar;
  - Punonjësit e shkollës;
  - Persona të tjerë që organi drejtues i konsideron të përshtatshëm.
5. publikojnë planin duke përgatitur një kopje për çdo organ drejtues dhe punonjës të shkollës. I gjithë plani mund të vihet në dispozicion edhe të prindërve/kujdestarëve sipas kërkesës.
6. Plani duhet të marrë parasysh prioritetet aktuale kombëtare. Nga muaji shtator 2022, ato janë:
  - përmirësimi i përparimit të nxënësve duke garantuar që procesi i tyre mësimor të mbështetet nga një sërë njohurish, aftësish dhe përvojash;
  - ulja e ndikimit të varfërisë në përparimin dhe arritjet e nxënësve.

Kritere të mëtejshme:

Të mbikëqyrura nga organet drejtuese, edhe shkollat duhet të:

- përdorin konkluzionet e dala nga vetëvlerësimi për të identifikuar një numër të menaxhueshëm të prioriteteve të veçanta në lidhje me përmirësimin e punës, të konceptuara për të ofruar përmirësim të qëndrueshëm;
- përfshijnë prioritetet, objektivat dhe strategjitë e detajuara për vitin e parë të planit për zhvillimin e shkollës;
- përfshijnë prioritetet dhe objektivat e nivelit më të lartë për vitet 2, 3 dhe çdo vit tjetër në të ardhmen;
- rifreskojnë prioritetet në lidhje me përmirësimin e punës të paktën një herë në vit, por duke patur parasysh ndikimin e vetëvlerësimit dhe informacionin e ri në lidhje me prioritetet gjatë gjithë vitit;
- planifikojnë veprime të fokusuara për realizimin e përmirësimit në këto fusha, të identifikojnë burimet ose financimet e nevojshme aty ku duhet, të dakordohen në lidhje me etapat e përshtatshme dhe kriteret e suksesit, dhe të përcaktojnë mënyrën dhe kohën e përshtatshme për kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të progresit të procesit të regjistrimit;

- mendojnë në lidhje me mënyrën e shfrytëzimit të pikave të tyre të forta ekzistuese dhe të mësojnë edhe nga shkollat e tjera në lidhje me këtë aspekt;
- specifikojnë në planin e zhvillimit të shkollës se nga çfarë do të përfitonin ose nga kush do të kërkonin mbështetje të jashtme për realizimin e përmirësimeve, së bashku edhe me kohën e planifikuar për këtë mbështetje;
- përdorin planin e zhvillimit të shkollës si bazë për procesin e menaxhimit të performancës për të gjithë punonjësit;
- nëpërmjet modaliteteve të llogaridhënies së organit qeverisës, të shqyrtojnë dhe dakordojnë në lidhje me aspektet prioritare për përmirësim, rezultatet e pritshme, përparimin e bërë krahasuar me parashikimet e planit të zhvillimit të shkollës dhe mbështetjen e nevojshme për të realizuar këto përmirësime;
- përdorin proceset e vetëvlerësimit për të vlerësuar rregullisht progresin e bërë kundrejt aspekteve prioritare për përmirësim;
- raportojnë qartë në lidhje me progresin e arritur kundrejt prioriteteve të vitit të kaluar të paktën një herë në vit.

Autoritetet lokale, konsorciumet rajonale dhe autoritetet dioqezane (aty ku ekzistojnë), duhet të punojnë në partneritet me njëri-tjetrin për të mbështetur shkollat për kryerjen e vetëvlerësimit të saktë dhe për realizimin e përmirësimeve prioritare.

#### **Shtojcë:**

[School improvement guidance: framework for evaluation, improvement and accountability](#)

### *1.3. Plani i zhvillimit të shkollës bazuar në raportet e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm – Shqipëri*

Autor: Teuta Çobaj

Një ndër detyrat funksionale të shkollës është hartimi i planeve të ndryshme, të cilat ndonjëherë përpilohen pa asnjë logjikë funksionale, pa u mbështetur në analizën e gjendjes së shkollës përkatëse apo në të dhëna konkrete. Kjo procedurë ndikon në nivelet e formalitetit të planeve shkollore.

Në praktikën e prezantuar më poshtë shtjellohet mënyra sesi përdoren analizat e bëra nga vlerësuesit e jashtëm dhe të brendshëm për hartimin e planeve të ndryshme të shkollës (plani vjetor i shkollës, plani për zhvillimin profesional të mësuesve, plani i psikologut, etj.) dhe planifikimin e aktiviteteve për përmirësimin e performancës së grupeve të punës, drejtuesve, punonjësve të tjerë të shkollës.

Kjo praktikë ka ndikim pozitiv në punën për zhvillimin e shkollës, pasi e ndihmon shkollën për të argumentuar përzgjedhjen e aspekteve për përmirësim në bazë të të dhënave dhe ndikon në përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve. Përcaktimi i saktë i procedurave krijon kulturën e nevojshme për zbatimin e procesit të vlerësimit të brendshëm në mënyrë cilësore dhe efikase.

### Raporti i Vlerësimit të Brendshëm

Raporti i vlerësimit të brendshëm të shkollës ofron një bazë të dhënash për diskutim dhe reflektim, ndërmjet mësuesve, drejtorëve/zëvendësdrejtorëve dhe palëve të tjera të interesuara, në lidhje me punën e shkollës. Ky informacion duhet të paraqitet në një material,<sup>10</sup> i cili mbahet nga shkolla si një produkt që orienton përmirësimin e vazhdueshëm të punës dhe të treguesve të saj për të ardhmen (bazuar në gjetjet për treguesit, shkollat përgatitin planet e përmirësimit për të ardhmen dhe në fokus të këtij procesi janë disa tregues që kanë nevojë për përmirësim). Në të njëjtën kohë raporti shërben edhe si bazë aktive të dhënash për vlerësimin e jashtëm të shkollës.

Fusha e Cilësisë	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Vlerësimi i Fushës
Udhëheqja dhe menaxhimi	Treguesit e cilësisë/përshkruesit praktikë (p.sh. 2.1.3)	Treguesit e cilësisë, përshkruesit praktikë (p.sh. 2.1.4)	
Cilësia e mësimdhënies dhe të nxënësve			
Arritjet dhe vlerësimet e nxënësve			
Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve			

### Raporti i vlerësimit të jashtëm

Raporti i vlerësimit të jashtëm bazohet në gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet përkatëse. Shkollat janë të detyruara që ta hartojnë planin e përmirësimit bazuar në këto rekomandime për fushat, treguesit apo përshkruesit praktikë.

#### Plani i përmirësimit të shkollës

Plani i përmirësimit është një udhëzues që përcakton ndryshimet që duhet të bëjë shkolla për të arritur pritshmëritë e saj në lidhje me kriteret e cilësisë për fushat “Udhëheqja dhe menaxhimi”, “Cilësia e mësimdhënies dhe të nxënësve”, “Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve”, “Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve”. Që plani i përmirësimit të jetë i suksesshëm, i gjithë komuniteti i shkollës duhet të përfshihet aktivisht në të gjitha hallkat e procesit, konkretisht: planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i progresit të shkollës.

Raporti i vlerësimit të jashtëm dhe raporti i vlerësimit të brendshëm përmbajnë të dhëna dhe kontribute

<sup>10</sup> Të gjitha materialet e raportit të vlerësimit të brendshëm duhet të organizohen, të strukturohen sipas modeleve të prezantuara në “Metodologjinë e vlerësimit të brendshëm të shkollave”. Shkollat e kanë detyrim përpilimin e këtij raporti.

për planin e përmirësimit të shkollës.

**Shtojca:**

- Struktura e raportit të vlerësimit të brendshëm.
- Formati i planit të përmirësimit të shkollës.

## 2. Monitorimi i punës për zbatimin e planit të zhvillimit të shkollës

### *2.1. Roli i vlerësimit të brendshëm në punën për monitorimin e realizimit të Planit të Zhvillimit të Shkollës dhe të rekomandimeve të dala nga vlerësimi i jashtëm - Uells*

Autor: Mamta Arnott

Gjatë inspektimit të kryer nga Inspektorati i Madhërisë së Tij për Arsimin dhe Trajnimin në Uells (Estyn) rishikohen qasjet e vetëvlerësimit dhe planifikimit të punës për përmirësimin e shkollës, për të konstatuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre (fusha e inspektimit 5.2). Vlerësimi i jashtëm fokusohet në përcaktimin se sa saktë i njohin drejtuesit dhe menaxherët pikat e forta dhe të dobëta të shkollës. Inspektorët duhet të përqendrohen më shumë në elemente të tilla si efektiviteti dhe ndikimi i proceseve të vetëvlerësimit dhe përmirësimin të shkollës sesa në cilësinë e dokumentacionit.

Inspektorët duhet të marrin në konsideratë shkallën e ruajtjes së cilësisë së lartë ose të përmirësimin të aspekteve të dobëta të ofertës nga drejtuesit e shkollës. Po ashtu, ata duhet të shqyrtojnë masat e marra nga drejtuesit për të parandaluar, pikë së pari, problemet e mundshme si dhe për korrigjimin e tyre. Inspektorët duhet të shqyrtojnë historikun e shkollës në lidhje me realizimin dhe vazhdimësinë e përmirësimeve të bëra dhe shkallën e ndikimit të tyre pozitiv mbi procesin e të nxënësve dhe mirëqenien e nxënësve. Aty ku është e mundur, inspektorët duhet të marrin në konsideratë dhe të shqyrtojnë edhe mënyrën e reagimit të shkollës ndaj rekomandimeve të dhëna nga inspektimet e mëparshme të Inspektoratit të Arsimit dhe Trajnimit në Uells (Estyn) ose nga partnerët strategjikë, dhe nëse veprimet e ndërmarra nga shkolla kanë çuar në përmirësimin e punës.

Detaje të mëtejshme mund të gjenden në dokumentin tonë udhëzues: [\*“What we inspect – schools and PRUs”\*](#)

Ekipi i inspektimit mund të bëjë rekomandime për përmirësim në shkolla bazuar në fushat kryesore të zhvillimit të identifikuar gjatë një inspektimi.

Pas inspektimit të shkollës, plani i zhvillimit të shkollës duhet të ndryshohet për të pasqyruar komentet pas inspektimit, gjetjet, rekomandimet dhe veprimet e propozuara. Kjo duhet të bëhet brenda 20 ditë pune.

Në rastet kur situata në një shkollë shfaqet problematike dhe kërkon ndjekjen e mëtejshme edhe pas përfundimit të inspektimit (nevoja për përmirësime të konsiderueshme ose masa të veçanta), organi drejtues duhet të hartojë një plan veprimi për masat që do të zbatohen në vijim të inspektimit dhe t’ia dorëzojë atë Inspektoratit Estyn brenda 20 ditëve. Sipas seksionit 40 të Ligjit për Arsimin 2005, autoritetit lokal i kërkohet që të përgatisë edhe një deklaratë me shkrim për çdo veprim që propozon të ndërmarrë duke u bazuar te raporti. Deklarata duhet t’i referohet çdo ndërhyrjeje formale që ka ndërmarrë ose synon të ndërmarrë. Ky plan veprimi shqyrtohet nga Inspektorati Estyn në takimet me personat përgjegjës për

hartimin dhe zbatimin e planit gjatë një vizite që do të zhvillojë në shkollë menjëherë pas përfundimit të inspektimit.

### [Post-inspection action plans](#)

Më pas, Inspektorati Estyn vazhdon punën për monitorimin e shkollave të vendosura në kategorinë statutore për ndjekjen e mëtejshme. Shkollat, ku është identifikuar nevoja për marrjen e masave të veçanta, i nënshtrohen një vizite monitoruese të paktën një herë në gjashtë muaj ose çdo semestër shkollor. Shkollat, ku është identifikuar nevoja për kryerjen e përmirësimeve të konsiderueshme, monitorohen rreth 12 – 18 muaj pas përfundimit të inspektimit bazë. Aktualisht, ne zbatojmë edhe një nivel të tretë më të lehtë për ndjekjen e mëtejshme të punës (Vlerësimi Estyn). Megjithatë, ky opsion nuk do të përdoret më duke filluar nga muaji shtator 2024.

Gjatë vizitave monitoruese, inspektorët vlerësojnë progresin e shkollës drejt përmbushjes së rekomandimeve të dhëna gjatë inspektimit bazë.

Për më shumë informacion në lidhje me Ndjekjen e Mëtejshme, shih: [How we inspect 2022](#).

## **B. Mbështetja e shkollave në punën për realizimin e përmirësimeve**

### *1. Realizimi i Raportit të Vetëvlerësimit dhe mbështetja për shkollat me performancë më të dobët – Skoci*

Autor: Tracie McEwan

Inspektimi dhe vlerësimi mbështet përmirësimin e punës dhe ofron garanci për cilësinë dhe përmirësimin e arsimit skocez, me qëllim promovimin e standardeve më të larta mësimore që çojnë në rezultate më të mira për të gjithë nxënësit.

Inspektimi dhe vlerësimi e përmbushin këtë qëllim nëpërmjet:

- ofrimit të sigurisë dhe llogaridhënies publike;
- promovimit të përmirësimit;
- informimit për zhvillimin e politikave dhe të praktikës arsimore.

Pas një inspektimi, inspektorati ndan gjetjet e inspektimit me autoritetin lokal arsimor përgjegjës për shkollën. Nëse shkolla është një shkollë e pavarur, d.m.th. e drejtuar nga një kompani private ose një organizatë bamirëse, gjetjet prezantohen nga bordi i tyre drejtues. Inspektorët e Madhërisë së Tij diskutojnë në lidhje me pikat e forta të identifikuara dhe fushat për zhvillim me shkollën, përfaqësuesin e autoritetit lokal ose bordin drejtues. Nëse inspektorët e Madhërisë së Tij janë të sigurt se shkolla ka kapacitetin e nevojshëm për të vazhduar punën për realizimin e përmirësimeve, ata nuk do të zhvillojnë më vizita në lidhje me këtë inspektim. Shkollës i kërkohet të informojë prindërit/kujdestarët për ecurinë e shkollës në këtë drejtim, si pjesë e modaliteteve të saj për raportimin mbi cilësinë e punës.

Nëse niveli i një shkolle në ndonjërin nga fushat e vlerësuara gjatë një inspektimi vlerësohet si i dobët ose i pakënaqshëm, Inspektorët e Madhërisë së Tij do të kërkojnë që atyre t'u ofrohet mbështetje shtesë nga autoriteti vendor ose bordi drejtues, si dhe më shumë kohë për të bërë përmirësimet e nevojshme. Në këtë rast, inspektorët e Madhërisë së Tij komunikojnë me autoritetin lokal arsimor në lidhje me kapacitetin e shkollës për t'u përmirësuar. Zakonisht, inspektorët kryejnë edhe një inspektim tjetër të mëtejshëm të shkollës brenda 12 muajve nga publikimi i raportit.

Nëse është e mundur, shkollat marrin mbështetje nga një prej ekipeve rajonale të përmirësimit në agjencinë *Education Scotland*. Këto janë funksionet e përmirësimit dhe të mbështetjes të ofruara nga kjo agjenci. Këto ekipe i ndihmojnë shkollat për të përshpejtuar përmirësimin brenda shkollave. Ata lidhen me shkollat dhe autoritetet lokale për të udhëhequr dhe ofruar mbështetje të caktuara në fusha të tilla si frekuentimi, përparimi ose gjithëpërfshirja, mirëqenia dhe barazitet. Ekipi fokusohet tek proceset e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe mbështetja e punonjësve të shkollës për aspekte të tilla si zhvillimi profesional dhe udhëheqësia. Funksioni i punës së tyre evoluon në bazë të nevojave shkollave dhe territoreve të autoriteteve lokale.

## *2. Mbështetja e shkollave me performancë më të dobët për përmirësimin e cilësisë së ofertës së tyre arsimore: Brigada Fluturuese – Holandë*

Autor: Herman Franssen

### **Si mund të ndihmohen shkollat e vlerësuara si institucione me performancë të pamjaftueshme nga inspektorati?**

Organizata kombëtare e bordeve të shkollave për arsimin bazë ka vënë në dispozicion të shkollave një projekt përmirësimi për këtë qëllim: *Becoming Good Staying Good (BGSG)*. Shkollat e vlerësuara si shkolla me performancë 'të pamjaftueshme' ose 'shumë të dobët' nga inspektorati mund të aplikojnë për këtë projekt. Me anën e një programi të posaçëm, shkolla ndihmohet nga një ekip ekspertësh për garantimin e cilësisë bazë në punën e saj. Kjo mbështetje sigurohet nëpërmjet fondeve të subvencioneve të vëna në dispozicion nga qeveria. Për këtë arsye, ajo nuk shoqërohet me asnjë lloj kostoje për shkollat e përfshira.

Çfarë përfshin mbështetja?

Procesi i mbështetjes me anën e projektit BGSG përfshin si më poshtë:

- Analiza e situatës në shkollë;
- Diskutimi në lidhje me hapat e mëtejshëm;
- Mundësia e përdorimit të një konsulenti të jashtëm nga e ashtuqujtura Brigada Fluturuese (*The Flying Brigade*).

Si funksionon?

Shkolla tashmë mund të aplikojë për projektin e mësipërm, menjëherë pas marrjes së vlerësimit si institucion me performancë 'të pamjaftueshme' ose 'shumë të dobët' nga inspektorati. Aplikimi pasohet

nga një takim fillestar me një punonjës të projektit BGSJ për të shqyrtuar situatën. Pas kësaj, një konsulent i jashtëm bën një analizë të situatës (brenda katër javëve shkollore). Kjo analizë zhvillohet në përputhje me vlerësimin e cilësisë së ofertës arsimore të shkollës të kryer nga inspektorati. Ajo gjithashtu përfshin edhe analizimin e mënyrës së funksionimit të ekipit, drejtuesve dhe strukturave të tjera të organizatës. Analisti shqyrton burime të ndryshme (raportin e fundit të inspektimit, rezultatet e testimit) dhe viziton shkollën për dy deri në tre ditë. Analisti i ndan rezultatet e punës së tij me drejtuesit dhe bordin e shkollës.

Bazuar në sa më sipër, bordi i shkollës mund të ngarkojë një palë të brendshme ose të jashtme për hartimin e planit të veprimit, sigurisht në bashkëpunim me përfaqësuesit e shkollës.

#### Brigada fluturuese (*Flying brigade*)

Pas fazës së analizës, shkolla mund të kërkojë ndihmën e Brigadës Fluturuese. Brigada Fluturuese përbëhet nga konsulentë me përvojë të lartë në punën për mbështetjen e shkollave për përmirësimin e cilësisë së tyre. Ato fokusohen në ata tregues të procesit mësimor (një ose më shumë) që janë vlerësuar si të pamjaftueshëm nga inspektorati. Lloji dhe forma e saktë e mbështetjes vendoset bashkërisht nga bordi i shkollës, shkolla, analisti, koordinatori i Brigadës Fluturuese dhe drejtuesi i projektit.

#### Roli i inspektoratit arsimor

Inspektorati nuk është i përfshirë në projektin në fjalë, që synon rikthimin e cilësisë së ofertës arsimore në një shkollë. Menjëherë pasi një shkollë vlerësohet si 'shumë e dobët' nga inspektorati, bordi i shkollës nënshkruan marrëveshjen e performancës me inspektoratin për përmirësimin e cilësisë. Pas një periudhe rreth 1 vjeçare, inspektorati zhvillon një vlerësim tjetër për të kuptuar nëse është përmirësuar cilësia e ofertës arsimore. Nëse një shkollë vlerësohet si 'shumë e dobët', shkolla ka maksimumi një vit kohë për të përmirësuar ofertën e saj arsimore. Bordi i shkollës është përgjegjës për cilësinë e ofertës arsimore në shkollë si dhe duhet të garantojë përmirësimin e shkollës. Bordi i shkollës është i detyruar të raportojë në inspektorat, nëse procesi i përmirësimit të shkollës ngec dhe nuk ecën përpara. Diskutimet në lidhje me progresin e mëtejshëm ndërmjet ekipit të inspektimit dhe shkollës zhvillohen në rastet kur, sipas bordit, procesi i përmirësimit paraqitet i amullt dhe nëse ekipi i inspektimit nuk është i sigurt nëse masat e marra nga bordi i shkollës për këtë qëllim janë të duhurat.

#### **Si mund të mbështeten shkollat që rrezikojnë të vlerësohen si institucione me performancë 'të pamjaftueshme' ose 'shumë të dobët'?**

Shkollat që rrezikojnë të vlerësohen si institucione me performancë 'të pamjaftueshme' ose 'shumë të dobët' mund të marrin mbështetje paraprakisht nga Këshilli i bordeve të shkollave të arsimit bazë. A është në rregull cilësia bazë e shkollës, por rezultatet e testimit flasin për një prirje në rënie? Këto shkolla mund të përdorin programin mbështetës '*Becoming Good, Staying Good Plus*' për të punuar në lidhje me këtë aspekt. Së bashku me një konsulent të jashtëm, ata punojnë për kryerjen e vetëvlerësimit dhe hartimin e planit të përmirësimit.

#### Çfarë përfshin programi i mbështetjes?

Programi mbështetës i këtij Këshilli '*Becoming Good, Staying Good Plus*' për drejtuesit dhe ekipet e shkollave përbëhet nga:

- Udhëzimet e dhëna nga një konsulent me përvojë në fushën e arsimit;

- Vetëvlerësimi, të cilin shkolla mund ta përdorë si bazë për planin vjetor ose shkollor;
- Plani i Veprimit për vitin e ardhshëm shkollor, që synon përmirësimin e rezultateve (dhe më gjerë).

Si funksionon?

- Prezantimi. Një përfaqësues i programit kontakton shkollën për organizimin e takimit prezantues. Gjatë këtij takimi, diskutohen pritshmëritë e ndërsjella dhe drejtori ndan me palën tjetër informacion bazë për shkollën dhe rezultatet e saj.
- Eksperti. Pas takimit prezantues, shkolla vihet në kontakt me një ekspert me përvojë për zgjidhjen e problematikave specifike të asaj shkolle. Ekspertët e programit janë të përgatitur dhe të kualifikuar për fushën e arsimit dhe për orientimin e punës së shkollave.
- Vetëvlerësimi. Shkolla harton raportin e vetëvlerësimit duke përdorur një format të caktuar. Eksperti e shqyrton atë dhe, në varësi të kërkesave, mund të ofrojë ndihmën e tij, si për shembull, nëpërmjet vizitave në klasa apo shqyrtimit të rezultateve të testeve. Kjo e ndihmon atë për të krijuar një tablo më të mirë të situatës fillestare (niveli bazë) dhe të kërkesës për ndihmë.
- Plani i përmirësimit. Së bashku me ekspertin, shkolla harton planin e veprimit ose planin e përmirësimit, duke përdorur formatin përkatës. Në këtë plan, shkolla përshkruan aktivitetet që do të zhvillojë në ditët e ardhshme, por edhe çfarë do të zgjedhë dhe marrë përsipër eksperti. Eksperti mund të udhëheqë një ditë studimi për një temë të caktuar, të mbikëqyrë intensivisht disa mësues, të bashkëpunojë me mbikëqyrësin e brendshëm ose të trajtojë drejtuesin e shkollës.
- Nisja e punës. Së bashku me ekspertin, shkolla fillon të punojë për të nxjerrë më të mirën nga nxënësit e saj dhe për të realizuar ambiciet e shkollës. Puna e bazuar në një plan veprimi shumë shpesh i pajis punonjësit e një shkolle me energji të reja.

### *3. Mbështetja mes kolegëve - Serbi*

Autorë: Vesna Šaponjić, Gordana Čaprić, Milja Krivokuća

Në sistemin arsimor në Republikën e Serbisë aplikohen dy forma të mbështetjes mes kolegëve:

(a) Në përputhje me Rregulloren për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional dhe Avancimin në Karrierë, punonjësit e institucioneve arsimore mund të bëjnë përpara në karrierë gjatë punës dhe zhvillimit të tyre profesional duke marrë tituj në katër nivele të ndryshme (konsulent pedagogjik, konsulent i pavarur pedagogjik, konsulent i lartë pedagogjik dhe konsulent pedagogjik i nivelit më të lartë). Pas marrjes së titullit, ata janë të kualifikuar për të ofruar ndihmë profesionale për kolegët e shkollës së tyre që kanë nevojë për ndihmë profesionale pas vetëvlerësimit ose vlerësimit të jashtëm; marrin pjesë në monitorimin e punës për zhvillimin e kompetencave për profesionin e mësuesit në shkollë; marrin pjesë në punën për analizimin e rezultateve të vetëvlerësimit dhe propozimin e masave për përmirësimin e punës së shkollës.

(b) Punonjësit në institucionet arsimore që kanë arritur rezultate të konsiderueshme në praktikën pedagogjike dhe kanë fituar reputacion profesional bëhen konsulentë-bashkëpunëtorë të jashtëm (shkurt KBJ) në zbatim të vendimit të posaçëm të ministrit dhe janë në shërbim të të gjitha shkollave që dëshirojnë të përmirësojnë cilësinë e punës së tyre duke demonstruar procedurat dhe metodat, duke organizuar orë apo aktivitete demonstruese, duke dhënë mendime në lidhje me aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra,

duke dhënë rekomandime profesionale për përmirësimin e punës, të gjitha këto në bashkëpunim me konsulentin arsimor gjatë vlerësimit të jashtëm dhe mbikëqyrjes profesionalo-pedagogjike. Ministria specifikon listën e KBJ-ve për lëndët, grupet dhe fushat lëndore, aktivitetet dhe detyrat profesionale (fusha lëndore, gjithëpërfshirja, parandalimi i dhunës, zhvillimi i kulturës demokratike, mbështetja e gjuhëve të pakicave kombëtare dhe fusha e arsimit dhe edukimit parashkollor). Në vijim gjeni një shembull në lidhje me mbështetjen e ofruar nga KBJ-të në fushën e parandalimit të dhunës.

Në rastet kur konstatohet se institucioni ka nevojë për asistencë në fushën e parandalimit të dhunës (qoftë e evidentuar në vlerësimin e jashtëm, mbikëqyrjen profesionalo-pedagogjike, ose nga raporti *ad-hoc* për një rast dhune), KBJ-të duhet të ofrojnë ndihmë profesionale për Ekipin përgjegjës për Mbrojtjen nga Dhuna, drejtorin, mësuesin, edukatorin, konsulentin; japin mendime në lidhje me aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra duke analizuar Programin për Mbrojtjen nga Dhuna, raportin për masat e zbatuara në terren për parandalimin e dhunës, Planet Individuale të Mbrojtjes dhe shkallën e përfshirjes së rrjetit të mbrojtjes së jashtme; të japin rekomandime në nivel eksperti për institucionin për të përmirësuar punën në fushën e mbrojtjes nga dhuna; të organizojnë dhe të marrin pjesë në veprimtari edukative në fushën e mbrojtjes nga dhuna. Gjithashtu, KBJ-të mund të zhvillojnë edhe aktivitete të tjera në fushën e mbrojtjes nga dhuna në përputhje me nevojat e Ministrisë, përkatësisht të administratave të shkollave.

KBJ-të mund të luajnë role të ndryshme: rol operacional, nëpërmjet mbështetjes së institucionit në punën për përgatitjen e planit të parandalimit dhe reagimit përmes mësimdhënies mbi metodologjinë e planifikimit, elementeve të planit operacional për mbrojtjen e fëmijëve apo nxënësve, procedurave dhe protokolleve për monitorimin e impaktit të aktiviteteve të zhvilluara, etj.; rol informues, nëpërmjet ofrimit të informacion përkatës për punonjësit në përputhje me nevojat specifike; rol analitik, nëpërmjet monitorimit të masave të rekomanduara; rol udhëzues, nëpërmjet dhënies së këshillave, udhëzimeve, propozimit të zgjidhjeve; si dhe rol këshillues, nëpërmjet angazhimit dhe punës me punonjësit për probleme specifike.

Gjatë punës me institucione të ndryshme, KBJ-të krijojnë dhe përgatisin protokolle dhe procedura të ndryshme që u nevojiten këtyre institucioneve për të garantuar parandalimin maksimal të dhunës.

Si mjet efektiv në punën e tyre, ata përdorin edhe listën e kontrollit për mbrojtjen nga dhuna të një konsulenti- bashkëpunëtori të jashtëm për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve të institucionit në lidhje me mbrojtjen nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca.

Pas veprimeve të ndërmarra nga KBJ-të, një shkolle ose një individ i jepën këshilla, rekomandime, si dhe prezantohen me procedurat, aktivitetet, masat e duhura etj. për të përmirësuar cilësinë e punës në fushën e parandalimit të dhunës. Roli i tyre këshillues nënkupton një marrëdhënie të bazuar në besimin reciprok, në radhë të parë nga pozicioni i "mikut kritik".

Lloji i mbështetjes së ofruar nga KBJ-të varet nga nevoja specifike për mbështetje e çdo institucioni individual. Për të ofruar mbështetje sa më efektive për institucionet, KBJ-të duhet të përpiqen për garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të punës.

Dokumente dhe linqe të dobishme:

- [Rulebook on Continuous Professional Development and Career Promotion School Teachers, Preschool Teachers and Expert Associates](#) (Serbi)

- [Rulebook on Professional Pedagogical Supervision](#) (përfshirë Listën e Kontrollit për Mbrojtjen nga Dhuna, që përdoret nga konsulenti – bashkëpunëtori i jashtëm për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve nga ana e institucionit në lidhje me mbrojtjen nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca) (Serbi).

## PJESA IV: Vlerësimi i jashtëm në nivel sistemi

Ky kapitull përmban informacion mbi rekomandimet dhe praktikatat e mira në lidhje me mënyrën e përdorimit të rezultateve të proceseve të vlerësimit të jashtëm nga agjencitë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe të tjerët për sa më poshtë:

### 1. Raportet vjetore për cilësinë e arsimit

#### *1.1. Ndikimi strategjik i raportimit vjetor dhe ciklik mbi cilësinë e shkollave dhe të sistemit arsimor – Serbi*

Autorë: Jelena Nedeljković, Gordana Čaprić, Jasmina Đelić

#### **Qëllimi**

Puna për përgatitjen e raporteve vjetore synon informimin e publikut të gjerë në lidhje me cilësinë e shkollave. Ato shërbejnë gjithashtu edhe për informimin e vendimmarrësve për përmbushjen e standardeve të cilësisë, për të bërë të mundur planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve sa më efektive në nivel të njësive administrative shkollore si dhe në nivel kombëtar.

Raportimi bëhet pas një cikli të përfunduar. Një raport i tillë mbulon të gjitha institucionet në sistem dhe shërben si një lloj udhërrëfyesi për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arsimor.

#### **Si funksionon?**

Raportet vjetore dhe ciklike përmbajnë këto njësi: prezantimi i kriterëve të vlerësimit si dhe përshkrimi i metodologjisë së vlerësimit të jashtëm, duke përfshirë kriteret e suksesit (nivelet e përmbushjes së standardeve dhe treguesve); paraqitja grafike e rezultateve të vlerësimit të institucioneve në lidhje me gjashtë fushat e cilësisë; dhe interpretimi, si dhe analizimi në mënyrë të veçantë i fushës ‘Mësimdhënia dhe Të nxënit në shkollë’, duke evidentuar zgjidhjet e mira dhe aspektet e punës së shkollës që kërkojnë mbështetje për të arritur cilësinë e dëshiruar. Analizat për shkollat e arsimit bazë dhe ato të mesme prezantohen veç e veç.

Përdorues të raporteve vjetore ose ciklike në nivel administrativ janë konsulentët arsimorë që monitorojnë zhvillimin e shkollave dhe zbatimin e planeve të veprimit për përmirësimin e shkollave. Gjithashtu, ky raport përdoret për kryerjen e analizës krahasuese të cilësisë së punës së ekipeve të vlerësuesve të jashtëm dhe vlerësimin e konsistencës së qasjes së vlerësimit. Vlerësuesit e jashtëm takohen në mënyrë periodike me njëri-tjetrin dhe diskutojnë në lidhje me të dhënat e prezantuara në raportin kombëtar nga dy këndvështrime: si profesionistë vetëreflektues dhe si miq kritikë.

Raportet vjetore dhe ciklike përdoren edhe për monitorimin dhe hartimin e politikave arsimore në nivel kombëtar. Për shembull, në kuadër të dokumentit politik *Strategjia për Zhvillimin e Arsimit në Republikën*

e Serbisë deri në vitin 2030,<sup>11</sup> raporti vjetor është burim i të dhënave për arritjen e objektivit specifik 1.1 Përmirësimi i mësimdhënies dhe të nxënit në arsimin parauniversitar.

Gjithashtu, këto raporte përdoren edhe për të planifikuar aktivitetet përkatëse në kuadër të Strategjisë. Për shembull, në bazë të raportit të ciklit të parë të vlerësimit dhe të dhënave ka rezultuar se më shumë se gjysma e shkollave nuk e përmbushin standardin 2.6 (Mësuesi përdor procedurat e vlerësimit që i shërbejnë qëllimit të të nxënit të mëtejshëm), dhe për këtë arsye në kuadër të Strategjisë janë ndërmarrë masa në nivel sistemi nëpërmjet Masës 1.2.2 Përmirësimi i sistemit dhe procesit të monitorimit të përparimit të nxënësve, aktiviteti 1.2.2.4. Trajnimi i mësuesve në fushën e hartimit të testeve, diferencimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të vazhduar.

Në këtë kontekst, Instituti për Cilësinë dhe Vlerësimin e Arsimit ka përgatitur për mësuesit dy trajnime të titulluara 'Vlerësimi i Vazhduar dhe Zbatimi i tij në Mjedisin Digjital' dhe 'Trajnimi i Mësuesve për Hartimin e Testeve dhe Diferencimin në Mësimdhënie'. Trajnimet kanë nisur të zhvillohen në vitin 2021. Në tre vjet në këto dy trajnime kanë marrë pjesë rreth 10,000 mësues. Pritet që, deri në vitin 2030 të jenë trajnuar të gjithë mësuesit.


Results of the external evaluation of schools in the first evaluation cycle (2012-2018)<sup>12</sup>.



*Fusha e Mësimdhënies dhe Të Nxënit, nivelet e përmbushjes së standardeve të cilësisë*

<sup>11</sup> Strategjia për Zhvillimin e Arsimit në Republikën e Serbisë deri në vitin 2030 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë", nr. 63/21), e gjeni në: <http://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SIGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/vlada/strategjia/2021/63/1/reg.>

<sup>12</sup> Burimi: Rezultatet e vlerësimit të jashtëm të shkollave në ciklin e parë të vlerësimit (2012-2018). E gjeni në: [http://vrednovanje.ceo.edu.rs/sites/default/files/izvestajiEE/2020\\_Rezultati%20spoliasnjeg%20vrednovanja%20skola\\_2012-2018.pdf](http://vrednovanje.ceo.edu.rs/sites/default/files/izvestajiEE/2020_Rezultati%20spoliasnjeg%20vrednovanja%20skola_2012-2018.pdf)



## 1.2. Gjendja e Arsimit: Raportet vjetore që vlerësojnë mënyrën e funksionimit të sistemit arsimor në tërësi – Holandë

Autor: Herman Franssen

Në Holandë, qeveria është përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve arsimore. Si shoqëri, ne duam që nxënësit të fitojnë njohuri dhe kompetenca që përputhen me aftësitë dhe talentet e tyre, për të kontribuar në shoqëri dhe në tregun e punës. Oferta e mirë arsimore është një element thelbësor për garantimin e përmbushjes së të gjitha funksioneve kryesore të arsimit. Në një shoqëri shumëformëshe, kjo përbën një domosdoshmëri. Një ndër aspektet e ofertës së mirë arsimore ka të bëjë me mundësinë që iu jepet nxënësve për t'u zhvilluar në potencialin e tyre të plotë dhe për të gëzuar mundësi të barabarta. Kjo do të thotë se sistemi ynë arsimor duhet të funksionojë siç duhet dhe se të gjithë nxënësit dhe studentët duhet të përfitojnë nga funksionet kryesore të sistemit tonë arsimor: kualifikimi, socializimi dhe shpërndarja, duke përfshirë përzgjedhjen dhe mundësitë e barabarta.

Cilësia në nivel sistemi përkufizohet si shkalla e zbatimit të suksesshëm dhe të ekuilibruar të funksioneve kryesore të arsimit – përkatësisht kualifikimi, socializimi dhe shpërndarja, duke përfshirë përzgjedhjen dhe mundësitë e barabarta – nga i gjithë sistemi i shkollave, i bordeve drejtuese të shkollave dhe aktorët e tjerë. Këto funksione thelbësore përfaqësojnë elementet kryesore për përcaktimin e cilësisë në sistemin arsimor.

Për të monitoruar cilësinë e sistemit, Inspektorati Hollandez përdor një kornizë të caktuar. Kjo kornizë përshkruan mënyrën e funksionimit dhe cilësinë e sistemit në lidhje me funksionet kryesore të sistemit arsimor. Ajo ndihmon për t'u përqendruar në punën për vlerësimin e mënyrës së funksionimit të sistemit në tërësi dhe të tendencave dhe pengesave në nivel sistemi.

Funksionet kryesore janë renditur në "Kornizën për cilësinë në nivel sistemi" (shih më poshtë). Përshkrimet identifikojnë tre funksionet kryesore: kualifikimin, socializimin dhe shpërndarjen, duke përfshirë përzgjedhjen dhe mundësitë e barabarta. Zhvillimi personal është pjesë e funksionit kryesor të socializimit. Përveç tre funksioneve kryesore, janë përshkruar edhe kërkesat që duhet të plotësohen për të adresuar këto funksione kryesore në mënyrën e duhur.

### KORNIZA PËR CILËSINË NË NIVEL SISTEMI

#### **Funksioni kryesor: Kualifikimi**

Arsimi i pajis nxënësit me njohuri, qëndrime dhe aftësi që plotësojnë nevojat e shoqërisë dhe janë të përshtatura me aftësitë dhe talentet e nxënësve.

#### **Përshkrim**

Arritjet mësimore dhe niveli i arritur nga të gjithë nxënësit kolektivisht janë të një niveli optimal, në grupe dhe fusha të ndryshme lëndore. Një aspekt i kësaj është se çdo nxënës është i pajisur me aftësitë e duhura për shkrim-leximin dhe matematikën. Arritjet mësimore janë në përputhje me nevojat e shoqërisë, që do të thotë se çdo nxënës në fund do të jetë në gjendje të funksionojë në mënyrën e duhur në shoqëri. Në krahasim me tendencat (e mëparshme), si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ka stabilitet apo lëvizje në drejtim të ambicieve të shoqërisë. Cilësia e vlerësimit dhe e provimeve çon në deklaratat përkatëse dhe të besueshme në nivel sistemi në lidhje me nivelin,

arritjet mësimore dhe nivelet referuese të nxënësve. Cilësia e kurrikulës përfshin njohuritë, qëndrimet dhe aftësitë (digjitale) dhe vlerësohet rregullisht në bazë të zhvillimeve aktuale dhe standardeve shkencore (ndërkombëtare).

### **Funksioni kryesor: Socializimi**

Arsimi kontribuon në përvetësimin e aftësive sociale dhe qytetare të nevojshme për pjesëmarrjen dhe kontributin e duhur në shoqëri.

#### **Përshkrim**

Njohuritë, qëndrimet dhe aftësitë e nxënësve janë në përputhje me nivelin e kërkuar për të funksionuar siç duhet në një shoqëri shumëformëshe të qeverisur nga një shtet demokratik. Kjo nënkupton aftësitë sociale dhe qytetare dhe vlerat themelore të një shteti demokratik, të cilat janë të nevojshme për të marrë pjesë me sukses në të. Në vlerësimin e kontributit të arsimit në shoqëri, prijnë rezultatet e mëparshme të arritura në sistemin arsimor, krahasimet ndërkombëtare dhe kërkesat thelbësore, si dhe nevojat dhe ambiciet e shoqërisë. Një shoqëri e lirë dhe shumëformëshe kërkon qytetarë që respektojnë rregullat dhe normat themelore demokratike, të cilët mund të formojnë opinione në mënyrë të pavarur, të jenë të gatshëm të marrin përgjegjësi dhe të jenë të mirëpajisur për t'u përballur me diversitetin.

### **Funksioni kryesor: Shpërndarja, duke përfshirë përzgjedhjen dhe mundësitë e barabarta**

Nxënësit ndjekin një karrierë arsimore që është në përputhje me aftësitë dhe talentet e tyre dhe me kërkesat e shoqërisë për fuqi punëtore.

#### **Përshkrim**

Arsimi garanton që nxënësit të ndjekin një karrierë arsimore që është e përshtatshme për ta dhe u jep atyre mundësi të barabarta për të marrë pjesë në llojin e arsimit që u përshtatet më së miri. Arsimi garanton që nxënësit të kenë sukses në arsimimin e tyre (të mëvonshëm) dhe të marrin një kualifikim që bën të mundur gjetjen e një vendi të përshtatshëm në tregun e punës nga ata ose vazhdimin e arsimimit të tyre në mënyrë sa më të përshtatshme. Referimi i shkollës, zgjedhja e shkollës, kalimi nga njëra shkollë në tjetrën dhe lidhjet brenda arsimit (gjithëpërfshirës) janë efektive dhe nuk pengojnë avancimin e nxënësve. Me fjalë të tjera, arsimi është një lloj i aksesueshëm dhe i disponueshëm për të gjithë nxënësit në bazë të aftësive të tyre. Ka stabilitet ose lëvizje në drejtim të ambicieve të shoqërisë në raport me tendencat (e mëparshme), si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare.


### **Kërkesat për përmbushjen e funksioneve kryesore**

Arsimi është i pajisur me burime dhe organizohet në atë mënyrë që garanton vazhdimësimë dhe kontribuon për realizimin e tre funksioneve kryesore të përshkruara më sipër.

#### **Përshkrim**

Arsimi është i organizuar në atë mënyrë që bën të mundur përmbushjen e tre funksioneve kryesore të sistemit me anë të bashkëpunimit dhe dinamikës së përbashkët. Qeverisja e mirë dhe vizioni i duhur i asaj që duhet të arrihet janë të rëndësishme në këtë aspekt. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, për shembull, për të arritur arsimin gjithëpërfshirës, kontribuon edhe në cilësinë e arsimit për nxënësit. Burimet dhe mundësitë shpërndahen dhe shfrytëzohen në mënyrë adekuate. Numri i punonjësve të kualifikuar për realizimin e mësimdhënies është i mjaftueshëm. Burimet, metodat organizative dhe personeli janë në një nivel të pranueshëm në raport me tendencat (e mëparshme), si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, ose janë duke lëvizur në drejtim të ambicieve të shoqërisë.

Inspektorati përdor kornizën e lartpërmendur për të shqyrtuar tre funksionet kryesore të arsimit: kualifikimi, socializimi dhe shpërndarja, duke përfshirë përzgjedhjen dhe mundësitë e barabarta, si dhe kërkesat thelbësore për secilën nga këto fusha. Në raportin vjetor në lidhje me **Gjendjen e Arsimit**, inspektorati përshkruan performancën në nivel sistemi në lidhje me funksionet dhe kërkesat thelbësore të sistemit arsimor në tërësi. Inspektorati paraqet një tablo të cilësisë së sistemit arsimor holandez në tërësi. Vëzhgimi i sistemit në tërësi na ndihmon të kuptojmë më mirë aspekte të ndryshme, si për shembull, avancimin e nxënësve përmes sistemit arsimor, pengesat sa i takon kalimit nga njëri sektor arsimor në tjetrin, dhe barazinë/pabarazinë e mundësive.



**Mbikëqyrja në nivel sistemi** përfshin një sërë hapash. Inspektorati ndërmerr veprimet e mëposhtme:

- monitoron tendencat dhe zhvillimet brenda sistemit arsimor holandez;
- analizon zhvillimet që po shkojnë mirë, por edhe reflekton në lidhje me problematikat që mund të përbëjnë rrezikshmëri për cilësinë e të gjithë sistemit në tërësi;
- garanton prioritizimin e risqeve dhe problematikave kryesore që identifikohen në sistemin arsimor dhe raporton në lidhje me to çdo vit nëpërmjet raportit 'Gjendja e Arsimit'.
- ndërhyr aty ku është e nevojshme, bazuar në detyrën e mbikëqyrësit për nxitjen e përmirësimeve.

Një departament i posaçëm pranë Inspektoratit Holandez monitoron në mënyrë sistematike zhvillimet në sistemin arsimor, duke përdorur kornizën e përshkruesve të cilësisë në nivel sistemi. Ata analizojnë mënyrën e përmbushjes së tre funksioneve kryesore - kualifikimi, socializimi dhe shpërndarja, duke përfshirë përzgjedhjen dhe mundësitë e barabarta – nga të gjitha bordet drejtuese të shkollave dhe shkollat vetë. Gjithashtu, ky departament vëzhgon edhe kushtet thelbësore për arritjen e këtij objekti: efikasiteti, siç dëshmohet nga gjendja dhe shpenzimi i burimeve financiare, politikat për personelin, sigurimi i cilësisë dhe sjellja administrative.

Të dhënat mbledhen nga burime të ndryshme për t'u përdorur më pas në procesin e monitorimit dhe analizimit të situatës. Të dhënat e mbledhura përfshijnë: të dhënat ekzistuese, të dhënat nga mbikëqyrja në nivel sistemi dhe institucioni (inspektimet e shkollave), sinjalet e marra si të dhënat e grumbulluara përmes vizitave tematike në shkolla.

Inspektorati përdor edhe të dhënat që janë në dispozicion të vetë bordit drejtues të shkollës. Përveç kësaj, përdoren edhe të dhëna nga organizata të tjera dhe nga kërkimet akademike. Inspektorati analizon shumicën e të dhënave të paktën një herë në vit, por ai mund të kryejë edhe disa analiza në vit.

Shtojca:

- Raportet vjetore:

<https://english.onderwijsinspectie.nl/documents/annual-reports/2023/5/31/state-of-education-2023>

- Shih kapitullin 3 (rreth mbikëqyrjes në nivel sistemi) të kornizave të inspektimit:

<https://english.onderwijsinspectie.nl/inspection/inspection-of-schools-by-the-dutch-inspectorate-of-education/the-2021-inspection-frameworks>

## 2. Vlerësimi tematik

### 2.1. Vlerësimi tematik/fokusimi në fusha ose tema specifike

– Suedi

Autorë: Anna Göthner, Susanne Vinell dhe Lars Thornberg

Inspektorati Suedez i Shkollave është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe sigurimin/vlerësimin e cilësisë. Në vijim gjeni të përshkruara vlerësimet tona tematike të cilësisë dhe raportin përfundimtar.

Gjatë vlerësimeve tematike të cilësisë, ne vizitojmë 30 shkolla dhe vlerësojmë cilësinë e punës së tyre brenda një fushe/teme specifike. Për shembull, kohët e fundit kemi vlerësuar përpjekjet e shkollave për të inkurajuar dhe rritur interesin e nxënësve për leximin dhe mënyrën se si ata punojnë për të promovuar praktikën e mira në lidhje me leximin. Zakonisht, vlerësimet tematike të cilësisë bazohen në dy pyetje kryesore (për shembull, një pyetje mund të jetë: “Në çfarë mase mund të konsiderohet puna e shkollave për promovimin e leximit si strategjike dhe e qëndrueshme?”). Për secilën pyetje përdoren rreth tre “kriterë cilësie”, të cilat specifikojnë aspektet që duhet të inspektohen për t’iu përgjigjur pyetjeve. Brenda secilit kriter, ne specifikojmë se çfarë është cilësia e lartë dhe e ulët. Kriteret e cilësisë, dhe çfarë përbën cilësi të lartë dhe të ulët, bazohen kryesisht në punën e mëparshme kërkimore dhe studimore.

Pas vlerësimit, të 30 shkollat marrin një raport/vendim në lidhje me procesin e vlerësimit. Ky raport/vendim individual përshkruan rezultatet e vlerësimit dhe cilat (nëse ka) aspekte të punës/praktikave të shkollës kanë cilësi të ulët dhe për këtë arsye duhen përmirësuar.

Përveç kësaj, Inspektorati përpilon edhe një raport të përgjithshëm që publikohet në faqen tonë të internetit. Në këtë raport, ne përshkruajmë temën dhe pse dhe si është vlerësuar, si dhe paraqesim gjetjet dhe rezultatet e përgjithshme nga shkollat e vizituara. Gjithashtu, evidentojmë edhe shembujt e mirë, si dhe risqet përkatëse, dhe nxjerrim përfundime.

Një nga qëllimet e raportit të përgjithshëm është propagandimi i shembujve të mirë dhe lehtësimi i procesit mësimor në të gjitha shkollat, jo vetëm në 30 shkollat që janë vlerësuar. Raporti i përgjithshëm mund të shërbejë edhe si një mënyrë për të hedhur dritë mbi një temë specifike dhe mbi rëndësinë e saj për edukimin e nxënësve. Ndonjëherë këto raporte tërheqin vëmendjen e medias dhe ndezin një debat publik për temën në fjalë. Krahas shkollave dhe organizatorëve, raportet mund të jenë me interes për studiuesit, politikanët dhe publikun e gjerë.

## *2.2. Parimet e inspektimit tematik dhe zbatimi i tij – Skoci*

Autor: Tracie McEwan

Raportet tematike kombëtare të përgatitura nga Inspektorët e Arsimit të Madhërisë së Tij në Skoci përshkruajnë praktikën aktuale në lidhje me aspektet kryesore të arsimit skocez. Ato mund të përfshijnë një ekip ndërsektorial inspektorësh që krijojnë një kampion me shkolla dhe kontekste të ndryshme në të gjithë Skocinë. Raportet tematike kombëtare:

- stimulojnë reflektimin profesional;
- promovojnë përmirësimin, duke ndarë më gjerësisht me të tjerët gjërat që funksionojnë dhe duke nënvizuar karakteristikat e ofertës cilësore që kanë një ndikim pozitiv te nxënësit;
- ofrojnë garanci në lidhje me aspektet e edukimit për palët e interesuara;
- informojnë dhe orientojnë punën e Ministrisë; dhe
- shërbejnë për rritjen e kapaciteteve në sistemin arsimor.

Inspektimet tematike kanë për qëllim të eksplorojnë një fushë prioritare më në thellësi se sa është e mundur në kuadrin e objektivave dhe kufizimeve të formave të tjera të inspektimit. Gjatë viteve të fundit, inspektorët e Madhërisë së Tij kanë kryer zakonisht tre ose katër inspektime tematike përgjatë një periudhe akademike.

Parimet kryesore për inspektimet tematike:

- **Përgjegjësia e palëve të interesuara** përshkon secilën prej fazave të kësaj detyre; Inspektimet tematike duhet të shihen si mundësi dinamike për angazhimin e palëve të interesuara.
- **Zhvillimet kryesore dhe tematikat e reja** duhet të komunikohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit.
- **Ndërtimi i punës në ekip gjatë gjithë detyrës:** përmbledh, zhvillon, instrukturon dhe mbështet anëtarët e ekipit.
- **Rishikimi, reflektimi dhe përfeksionimi** i aktivitetit. Synon ta bëjë tematikën më produktive dhe të arrijë më shumë ndikim sesa më parë.
- **Planifikimi i veprimeve të qarta pasuese**, të cilat do të maksimizojnë ndikimin e raportit të inspektimit.

Temat nga raportet kombëtare të inspektimit sugjerohen nga një sërë burimesh. Për shembull, qeveritarët mund të kërkojnë informacion në lidhje me sjelljen në shkolla, ose mund të identifikohet një fushë me interes publik kombëtar, siç është mirëqenia e të rinjve pas pandemisë COVID-19. Çdo sugjerim duhet të miratohet nga drejtuesit e lartë të Inspektoratit të Madhërisë së Tij, duke përfshirë drejtorin strategjik dhe Kryeinspektorin e shkollave. Propozimi hartohet nga Inspektorët e Madhërisë së Tij në një proces planifikimi të njohur si mandati. Mandati diskutohet nga grupi drejtues i kontrollit si pjesë e procesit të

qeverisjes dhe llogaridhënies. Parashikohet që të gjitha raportet kombëtare të ndjekin këtë proces, i cili garanton që projekti të ketë burime të mjaftueshme në dispozicion, përmes angazhimit të kolegëve më të përshtatshëm për këtë detyrë.

Inspektorët e Madhërisë së Tij mund të propozojnë edhe idetë e tyre dhe të sugjerojnë realizimin e një inspektimi kombëtar. Nëse një nga inspektorët e Madhërisë së Tij ka një sugjerim në lidhje me një inspektim tematik, ata i dërgojnë kërkesë drejtuesve të lartë për këtë qëllim. Ky dokument duhet të përshkruajë qartë arsyet për ndërmarrjen e një inspektimi të tillë dhe për fushën e interesit. Nëse kërkesa mandatohet, një anëtar i ekipit të drejtuesve të lartë e sponsorizon dhe mbikëqyr projektin. Drejtuesi i lartë bëhet 'sponsor i mandatit', megjithëse inspektimi do të drejtohet nga një ndër inspektorët kryesorë të Madhërisë Tij. Sponsori i mandatit do të ndihmojë inspektorin udhëheqës të inspektimit, përmes mbështetjes për kapërcimin e sfidave kritike, për të garantuar që mandati do të kontribuojë për arritjen e objektivave të përgjithshme të organizatës.

Nëse inspektorët e Madhërisë së Tij janë duan të sugjerojnë përgatitjen e një raporti kombëtar, ata duhet të sigurohen që:

- qëllimi i raportit kombëtar është i qartë;
- propozimi ka një bazë të qartë provash;
- ekziston një plan i qartë për kryerjen e punës në terren;
- të emërohet drejtuesi i mandatit;
- të emërohet sponsori i projektit;
- të jenë alokuar burimet;
- të dinë se si do të ndahet raporti me aktorët e tjerë në sistemin më të gjerë arsimor;<sup>13</sup>
- të jenë të qartë për mënyrën e komunikimit të gjetjeve të raportit; dhe
- të jenë përshkruar qartë parametrat e suksesit ose të vlerësimit për projektin.

---

<sup>13</sup> Personi kryesor udhëheqës dhe sponsori mund të bien dakord në lidhje me këtë. Lejohet dhe ekziston mundësia për të qenë krijues rreth mënyrës se si e ndajmë raportin me sistemin.

### 3. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor

#### 3.1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe i metodologjisë së vlerësimit të jashtëm – Serbi

Autorë: Gordana Čaprić, Jasmina Đelic, Jelena Nedeljković

Nga viti 2008 deri në vitin 2010, Instituti për Cilësinë dhe Vlerësimin e Arsimit (ICVA) dhe Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë punuan së bashku me Inspektoratin Holandez dhe Konferencën e Përhershme Ndërkombëtare të Inspektorateve (SICI) për të krijuar metodën e vlerësimit të jashtëm dhe kornizën e detajuar të cilësisë së shkollave. Kjo kornizë përfshin shtatë fusha të cilësisë, 30 standarde dhe 158 tregues dhe është përdorur gjatë ciklit të parë të vlerësimit në Serbi nga viti 2012 deri në vitin 2017.

Rishikimi i kornizës së vlerësimit dhe i metodologjisë është planifikuar si një aktivitet i rregullt dhe i vazhdueshëm pas çdo cikli për të garantuar cilësinë e sistemit të vlerësimit të shkollave. Si pjesë e këtij procesi, në vitin 2017 u krijuar një grup pune, i përbërë nga përfaqësues të shkollave, funksionarë të qeverisë dhe të ICVA-së, studiues, profesorë të fakultetit dhe nga sindikatat e mësuesve për rishikimin e kësaj kornize.

Ky grup pune zhvilloi dy grupe aktivitetesh.

Në vitin 2017, grupi i punës u fokusua në punën për përmirësimin e kornizës së cilësisë duke rishikuar standardet dhe treguesit. Ata mblodhën të dhënat përkatëse nga burime të ndryshme, duke përfshirë literaturën, si analizat krahasuese mbi praktikën e vlerësimit të jashtëm në Evropë (rrjeti *Eurydice*), studimet e tjera në lidhje me mësimdhënien efektive dhe mjediset mbështetëse për garantimin e arritjeve më të mira të nxënësve, raportet e reflektimit të vlerësuesve të jashtëm, etj. Ata analizuan rezultatet nga cikli i parë i vlerësimit të jashtëm, duke testuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e kornizës së cilësisë, duke përfshirë edhe analizën *Item Response Theory (IRT)*.<sup>14</sup> Gjithashtu, ato shfrytëzuan edhe të dhënat e gjeneruara nga tetë anketa të kufizuara, me pjesëmarrjen e 1,700 mësuesve.

Bazuar në burimet në dispozicion, grupi i punës rishikoi kornizën e standardeve të cilësisë, e cila u validua përmes një studimi pilot në 19 shkolla. Rezultatet e këtij studimi shërbyen si bazë për finalizimin e kornizës së cilësisë, me gjashtë fusha të cilësisë, 24 standarde dhe 124 tregues. Grupi i punës vendosi të bashkonte dy prej fushave dhe të hiqte disa standarde dhe tregues që nuk funksiononin në mënyrë të mjaftueshme. Nga ana tjetër, ata përfshinë disa tregues të rinj të cilësisë në këtë kornizë (siç është mësimdhënia nëpërmjet projekteve, pjekuria digjitale e shkollës, të nxënësve horizontal si formë bashkëpunimi mes shkollave, etj.).

Përveç kësaj, ata vendosën disa kritere më komplekse për shkollat në disa aspekte të punës (p.sh., monitorimi i përparimit të nxënësve, planifikimi dhe programimi operacional, pjesëmarrja e

---

<sup>14</sup> *Item Response Theory (IRT)* është një nga modelet matematikore që përpiktet të krijojë një lidhje midis vetive të elementeve në një instrument, individëve që u përgjigjen këtyre elementeve dhe tiparit themelor që matet. IRT është një model standard që përdoret në arsim. Është shumë i ndërlikuar të shpjegohet me disa fjali. Në këtë tekst ai përmendet thjesht për t'u dhënë një ide statisticienëve në agjenci për ta përdorur për këtë qëllim.

domosdoshme e prindërve në punën e shkollës, zhvillimi profesional i mësuesve, përgjegjësia e drejtorit për zhvillimin e shkollës, etj.). Dhe e fundit, ata shtuan edhe disa kërkesa të parashikuara në Ligjin për Arsimin (2017), për të evidentuar cilësinë dhe efikasitetin e veprimit në të gjitha aspektet e punës së shkollave. Korniza e përmirësuar e cilësisë u publikua në vitin 2018.

Në vitin 2018, pas rishikimit të standardeve, u përmirësua edhe metodologjia e vlerësimit. Grupi i punës hartoi pyetësorët për vlerësimin e qëndrimeve dhe opinioneve të punonjësve të arsimit mbi procedurat e vlerësimit, duke përfshirë ndikimin e vlerësimit të jashtëm në zhvillimin e shkollës. Pyetësorët u pilotuan me 300 të anketuar dhe iu nënshtruan kontrolleve psikometrike. Studimi sasior mbuloi një kampion përfaqësues të shkollave, ku u përfshinë 600 përfaqësues të strukturave drejtuese të shkollave dhe 5,300 mësues, të cilët shprehën mendimin e tyre në lidhje me procedurat e vlerësimit dhe ndikimin e vlerësimit të jashtëm. Kjo u shoqërua edhe me zhvillimin e studimit cilësor për të thelluar njohjen e të dhënave të gjeneruara. Në këtë fazë u organizuan edhe 20 seminare pune në shtatë shkolla të arsimit bazë dhe në nëntë shkolla të mesme në rajone të ndryshme të Serbisë. Rreth 200 mësues dhe bashkëpunëtorë shkollorë të ekipeve të vetëvlerësimit të shkollës morën pjesë në diskutimet lidhur me analizën e thelluar të standardeve dhe treguesve, si dhe të procesit të vlerësimit të jashtëm për të marrë reagime dhe mendime për përmirësimin e sistemit të vlerësimit të jashtëm. Gjithashtu, rreth 100 vlerësues të jashtëm të licencuar organizuan një sërë takimesh për të diskutuar në lidhje me pikat e forta dhe sfidat në punën për përdorimin e standardeve specifike dhe të procedurave të vlerësimit.

Duke marrë parasysh perspektivat e të gjithë pjesëmarrësve aktivë në vlerësimin e shkollës, bazuar në këto të dhëna, grupi i punës rishikoi metodologjinë e vlerësimit, e cila u publikua në vitin 2019. Metodologjia e rishikuar përfshin edhe risi të tilla si angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm (mësimdhënësve) në vlerësimin e jashtëm të shkollës, mendimet e mësuesve dhe punonjësve të tjerë të shkollës për vëzhgimin e orës së mësimi dhe mënyrën e kryerjes së vlerësimit, si dhe ndryshimet në përlllogaritjen e notës përfundimtare.

Puna për përgatitjen e kornizës së cilësisë dhe rishikimin e metodologjisë zgjati dy vjet, duke rezultuar në publikimin e dy akteve nënligjore ku parashikohen standardet, treguesit dhe procedurat e vlerësimit. Vlerësimi në bazë të këtyre rregulloreve filloi të realizohet në vitin 2020, vit që shënon fillimin e ciklit të ri të vlerësimit.

Shtojca:

- [Rulebook on quality standards for the work of institutions](#) (në serbisht)
- [Rulebook on evaluating the quality of the institution's work](#) (në serbisht)

### *3.1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor – Uells*

Autor: Mamta Arnott

Në praktikën e Inspektoratit të Madhërisë së Tij për Arsimin dhe Trajnimin në Uells, ndryshimet e vogla të asaj që inspektohet kryhen në mënyrë të vazhdueshme, si për shembull, për të pasqyruar ndryshimet aktuale në ligj ose në udhëzimet për shkollat. Në të njëjtën mënyrë, ne përditësojmë qasjet tona për mënyrën e inspektimit, si pjesë e punës tonë për përmirësimin e vazhdueshëm.

Gjatë çdo cikli bëhet një rishikim i plotë i kornizës. Ai bazohet në elemente të tilla si:

- shqyrtimi retrospektiv i inspektimeve në një cikël të mëparshëm, duke përfshirë gjetjet nga raportet tona vjetore më të fundit;
- udhëzimet e reja për shkollat;
- zhvillimet aktuale në arsim në nivel politikash;
- praktikat më të mira të identifikuara përmes inspektimit;
- gjetjet e vlerësimeve tona tematike ose studimeve të jashtme;
- konsultimi me aktorët kryesorë në sektorin e arsimit, si profesionistët e arsimit, sindikatat e mësimdhënësve dhe drejtuesve, inspektoratet partnere, prindërit dhe kujdestarët, nxënësit, organizatat e sektorit të tretë, Qeveria e Uellsit.

#### 4. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit arsimor për të marrë pjesë në vlerësimin e jashtëm

##### *4.1. Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve të aktorëve të shkollës për të marrë pjesë në procesin e inspektimit/vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit – Irlandë*

Autorë: Pádraig Mac Fhlannchadha, Suzanne Conneely, An Roinn Oideachais

Sipas Kodit tonë të Praktikës që e gjeni [këtu](#) në [www.gov.ie](http://www.gov.ie), Departamenti përgjegjës për Arsimin në Inspektoratin irlandez është i angazhuar për të qenë sa më i hapur dhe transparent në lidhje me proceset tona të inspektimit. Prandaj, ne garantojmë që shkollat dhe mjediset e tjera arsimore dhe palët e interesuara në këto struktura të kenë të gjithë informacionin përkatës në dispozicion në lidhje me mënyrën e realizimit të inspektimeve dhe se si ata mund të bëhen pjesë e inspektimeve tona.

Udhëzuesit e botuar për inspektimin, që i gjeni [këtu](#) në [www.gov.ie](http://www.gov.ie), paraqesin një tablo të qasjes sonë ndaj inspektimit dhe llojeve të aktiviteteve në të cilat angazhohemi në të gjithë gamën e modeleve të inspektimit që përdorim. Ndarja e informacionit më specifik për kryerjen e një inspektimi në një shkollë individuale bëhet nëpërmjet komunikimit me shkrim (e-mail ose letër) dhe bisedave telefonike me drejtorin e shkollës ose drejtuesin e strukturës arsimore përpara inspektimit. Në rastin e vlerësimit të të gjithë shkollës, inspektorët organizojnë një takim informues dhe paravlerësues me drejtuesit dhe punonjësit e shkollës.

Inspektorati ka publikuar edhe uebinare dhe fletëpalosje informuese, të cilat i gjeni [këtu](#) në [www.gov.ie](http://www.gov.ie), për prindërit dhe për fëmijët/të rinjtë në lidhje me mënyrën e realizimit të inspektimeve. Bazuar në nenin 12 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1989) dhe Modelit *Lundy* për Pjesëmarrjen (2007), ne kemi zhvilluar qasjen tonë për mënyrën e sjelljes dhe bashkëveprimit me fëmijët dhe të rinjtë gjatë punës në fokus grupe në kuadrin e inspektimit. Qasja aktuale e Inspektoratit bazohet në respektimin e të drejtave dhe të pikave të forta të pjesëmarrësve; kjo përfshin pjesëmarrjen vullnetare dhe të informuar, pëlqimin e fëmijëve/të rinjve dhe pëlqimin e prindërve të tyre për të marrë pjesë në fokus grupe. Ne i informojmë fëmijët dhe të rinjtë paraprakisht për inspektimin dhe për mundësinë e përfshirjes së tyre në të. Gjatë procesit të inspektimit, ne planifikojmë kohën tonë dhe i dedikohemi edhe ngritjes së kapaciteteve të fëmijëve/të rinjve për të marrë pjesë sa më plotësisht dhe me besim në fokus grup. [Këtu](#) gjeni një video të shkurtër për fëmijët dhe të rinjtë, ku shpjegohet mënyra e ndërveprimit të inspektorit me ta gjatë inspektimit, veçanërisht në fokus grupe. Aktualisht po punojmë për përfshirjen e një faqeje të raportit, të përshtatshme për të rinjtë, si pjesë e raportit të inspektimit të publikuar për modele të caktuara inspektimi. [Këtu](#) në [www.gov.ie](http://www.gov.ie) mund të gjeni të publikuar një uebinar për edukatorët, ku shpjegohet arsyeja dhe mënyra e zbatimit nga Inspektorati e qasjes për respektimin e të drejtave në ndërveprimet tona me fëmijët/të rinjtë gjatë inspektimit.

Gjatë inspektimeve, ne angazhohemi me palët e interesuara në një sërë mënyrash si pjesë e punës tonë për mbledhjen e të dhënave dhe evidencave në lidhje me cilësinë e ofertës dhe praktikës në shkolla individuale dhe mjedise të tjera arsimore. Në varësi të llojit të inspektimit, ky angazhim mund të realizohet përmes takimeve me drejtuesit e shkollave, mësuesit, prindërit dhe fëmijët/të rinjtë. Gjithashtu, për disa modele inspektimi ne përdorim edhe anketat. Në fund të vizitave në klasa dhe në mjediset e tjera të shkollës, ne bëjmë vërejtjet tona për mësuesit dhe specialistët e tjerë arsimorë. Në fund të çdo inspektimi, ne ndajmë gjetjet/vërejtjet tona me drejtuesit e shkollave në formën e bashkëbisedimit/prezantimit me

gojë; në fund të vlerësimit të të gjithë shkollës, ne ndajmë vërejtjet dhe komentet tona me bordin drejtues të shkollës dhe personelin mësimor.

Për zhvillimin e qasjeve dhe modeleve të reja të inspektimit, ne konsultohemi me aktorët e sektorit të arsimit që përfaqësojnë menaxherët dhe drejtuesit e shkollave, mësuesit, prindërit dhe fëmijët/të rinjtë. Një pjesë e rëndësishme e procesit për zhvillimin e modelit të inspektimit përfshin punën me një kampion përfaqësues të shkollave dhe marrjen e përshtypjeve/mendimeve të tyre në lidhje me procesin.

Duke qenë se ne i shohim inspektimin e jashtëm dhe të brendshëm si procese plotësuese, Inspektorati ynë mbështet shkollat për ngritjen e kapaciteteve të tyre për t'u përfshirë në procesin e vetëvlerësimit të shkollës. Kjo ndodh në një sërë mënyrash, ku përfshihen organizimi i vizitave këshilluese, vlerësimi gjatë inspektimeve i nivelit të angazhimit të shkollës në procesin e vetëvlerësimit, sigurimi i burimeve dhe publikimi i buletinit për vetëvlerësimin e shkollës. Gjithashtu, kemi filluar punën me një kampion të vogël përfaqësues të shkollave për t'i mbështetur ato për vlerësimin e fushës së Mësimdhënies dhe Të nxënit, si pjesë e vetëvlerësimit të shkollave të tyre.

Të gjithë punonjësit e rekrutuar në Inspektoratin tonë janë mësues të kualifikuar ose edukatorë të kopshteve të fëmijëve dhe kanë përvojë në mësimdhënie. Pas emërimit, inspektorët e rinj i nënshtrohen një programi trajnimi dhe orientimi intensiv që zgjat deri në katër muaj në lidhje me elementët kryesorë të procesit të inspektimit dhe raportimit. Programi përfshin aspekte të tilla si: prezantimi, vetë-studimi, reflektimi profesional, praktika nëpërmjet vëzhgimit të inspektimeve në terren dhe rolet mbështetëse të inspektimit.

#### 4.2. Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve të inspektorëve përfaqësues të shkollave – Uells

Autor: Mamta Arnott

Të rekrutuar dhe të trajnuar nga Inspektorati i Madhërisë së Tij për Arsimin dhe Trajnimin në Uells, inspektorët përfaqësues të shkollave, janë anëtarë me të drejta të plota të një ekipi inspektimi, të cilët kontribuojnë në të gjitha fushat e inspektimit. Të gjitha ekipet e inspektimit kanë në përbërjen e tyre një inspektor të tillë. Në shkollat më të mëdha/Njësitë e Referimit të Nxënësve mund të ketë më shumë se një inspektor përfaqësues të shkollës në ekip. Ata shkruajnë edhe disa pjesë të raportit të inspektimit. Këta inspektorë janë pjesë e paçmuar e procesit të inspektimit, pasi përfshirja e tyre ndihmon në krijimin e një perceptimi të përbashkët të pritshmërive në të gjithë sistemin arsimor. Duke u bërë pjesë e ekipeve të inspektimit, ata kanë mundësi të përballen me praktika të ndryshme dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre analitike për ngritjen e kapaciteteve në mbarë sektorin arsimor. Në të gjithë Uellsin janë rreth 1,000 inspektorë që vijnë nga sektori arsimor.

Ne rekrutojmë inspektorë nga ofruesit, inspektojmë autoritetet lokale dhe shërbimet rajonale të përmirësimit. Për të luajtur këtë rol, një punonjës i shkollës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Të jetë anëtar i ekipit të drejtuesve të lartë (minimumi dy vjet);
2. Të ketë marrë aprovimin e drejtorit të tij.

Kriteret e pranueshmërisë për sektorë të tjerë mund të ndryshojnë.

Këta inspektorë marrin trajnim rigoroz fillestar për fushën e inspektimit. Ata duhet të ndjekin edhe trajnimin vjetor për përditësimin e njohurive, si kusht për përfshirjen e tyre në inspektim.

Gjatë një inspektimi, inspektori që vjen nga institucioni/ofruesi arsimor zakonisht:

- merr përsipër i vetëm ose së bashku me një person tjetër kryerjen e inspektimit dhe raportimin mbi një aspekt të fushës së inspektimit;
- kontribuon për zgjerimin e bazës së të dhënave dhe të evidencave përmes vëzhgimit të procesit mësimor, takimit me nxënësit, personelin e shkollës dhe prindërit dhe shqyrtimit të evidencave, duke përfshirë punën e nxënësve.

Inspektori raportues drejton dhe menaxhon punën e inspektorit përfaqësues të shkollës.

Për më shumë informacion, shihni: [Inspector Roles](#)

Puna jonë me inspektorët që vijnë nga ofruesi arsimor është një komponent i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve në sektorin e arsimit, si një ndër objektivat tona strategjike kryesore.

### 4.3. Zhvillimi i njohurive dhe aftësive në fushën arsimore - Uells

Autor: Mamta Arnott

Inspektorati i Arsimit dhe Trajnimit në Uells (Estyn) kontribuon në disa mënyra të ndryshme për zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën arsimore:

- Udhëzimet plotësuese

Inspektorati Estyn publikon një sërë udhëzimesh shtesë për përdorim nga ofruesit në lidhje me aspekte të ndryshme të punës së tyre për t'i ndihmuar ata të kuptojnë qasjet e inspektimit në këto fusha. Udhëzimet plotësuese i pajisin ata me informacion të fokusuar në një fushë tematike specifike dhe janë krijuar për të promovuar përhapjen e praktikave më të mira. Disa shembuj të udhëzimeve plotësuese janë si më poshtë:

- Nevojat për mësimin e mëtejshëm;
- Inspektimi i qëndrimeve ndaj të nxëniet;
- Dëgjimi i nxënësve gjatë inspektimit;
- Ulja e ndikimit të varfërisë mbi arritjet mësimore dhe mbi mirëqenien e nxënësve;
- Inspektimi i aftësive matematikore në shkolla.

Për të parë gamën e plotë të udhëzimeve shtesë, shih: <https://www.estyn.gov.wales/improvement-resources>

- Ndarja me të tjerët e praktikave efektive.

Kur inspektorët e agjencisë Estyn konstatojnë një praktikë interesante gjatë një inspektimi ose pune tematike, ata janë gjithmonë të prirur ta ndajnë atë me të tjerët. Për këtë qëllim, agjencia i fton shkollat dhe ofruesit e tjerë të përgatisin raste studimore për disa aspekte të rëndësishme që vlen të evidentohen. Gjatë pandemisë, Estyn ka ndarë me palët e interesuara materiale të shkurtra informative lidhur me mënyrën se si ofrues të ndryshëm e kishin përshtatur punën e tyre për të mbështetur nxënësit dhe për të ofruar mësim në distancë.

Një gamë e plotë e rasteve studimore dhe e materialeve filmike shoqëruese mund të gjenden në:

[www.estyn.gov.wales/improvement-resources](https://www.estyn.gov.wales/improvement-resources)

**Shtojcë:**

- [Inspector Roles](#)

#### *4.4. Roli i inspektorëve vullnetarë dhe përfaqësuesve të shkollave në ekipet e vlerësimit të jashtëm dhe ngritja e kapaciteteve të tyre - Uells*

Autor: Herman Franssen<sup>15</sup>

Inspektorët përfaqësues të institucioneve arsimore, inspektorët vullnetarë dhe personat e emëruar nga institucioni arsimor

Në Uells, të gjitha ekipet e inspektimit kanë në përbërjen e tyre një inspektor që vjen nga ofruesi arsimor (siç përshkruhet edhe në kapitullin e mëparshëm). Pë shkollat apo ofruesit më të mëdhenj, mund të ketë më shumë se një prej tyre. Ndonjëherë ky rol luhet nga këshilltarët që punojnë në shërbimet rajonale të përmirësimit të shkollave, të cilët i bashkohen ekipeve të inspektimit. Ata janë pjesë integrale e ekipit të inspektimit. Inspektorët e ekipit dhe inspektorët përfaqësues të shkollave mund të marrin përsipër punën për mbledhjen e të dhënave dhe evidencave që do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e aspekteve të ndryshme në kuadrin e inspektimit.

Përveç kësaj, ekipit të inspektimit mund t'i bashkohet edhe një inspektor vullnetar, i cili nuk është mësues i kualifikuar dhe nuk ka përvojë pune në shkolla, edhe pse normalisht kjo kategori e inspektorëve kanë përvojë në punë komunitare të një forme të caktuar. Ata sjellin në punën e ekipit një dimension ndryshe në nivel jo-specialist. Të gjithë këta inspektorë trajnohen dhe vlerësohen nga Inspektorati Estyn dhe kontrahohen për t'u bërë pjesë e inspektimeve specifike. Në Uells, çdo ekip përgjegjës për inspektimin e shkollave ka në përbërjen e tij një inspektor të kësaj kategorie. Ky i fundit vëzhgon dhe analizon se si është të jesh nxënës në një shkollë të caktuar dhe raporton tek ekipi i inspektimit (përfshirë edhe personin e emëruar nga institucioni për përfshirje në inspektim) në lidhje me këtë. Pikëpamjet e tyre shërbejnë si bazë për punën e vazhdueshme të ekipit. Normalisht, inspektori vullnetar i bashkohet ekipit vetëm për një ditë pune gjatë javës së inspektimit.

Grupi i inspektimit mund të pasurohet edhe nga prania e punonjësit të emëruar nga shkolla për të qenë pjesë e inspektimit. I emëruari është një punonjës me eksperiencë pune tek ofruesi që inspektohet, i cili është ftuar nga ekipi dhe i emëruar nga shkolla për të punuar me ekipin e inspektimit. Në praktikë, pothuajse të gjitha shkollat e pranojnë ftesën, por ky nuk është kriter i domosdoshëm. Personi i emëruar për këtë qëllim duhet të ketë vjetërsi dhe përvojë të mjaftueshme pune për të luajtur rolin e ndërlidhësit midis shkollës dhe ekipit të inspektimit, si për shembull me drejtorin ose me një drejtues të lartë të shkollës. Në ato pak raste kur personi i emëruar nga shkolla nuk është drejtori vetë, është e rëndësishme që inspektori raportues të zhvillojë një takim të shkurtër ditor me drejtorin për të diskutuar dhe qartësuar çështjet e inspektimit dhe gjetjet e konstatuara nga ekipi i inspektimit.

---

<sup>15</sup> Praktika e mirë e bazuar në profilin e Inspektoratit të Arsimit dhe Trajnimit të Uellsit (Estyn) e publikuar në Konferencën Ndërkombëtare të Përhershme të Inspektorateve – faqja e internetit e *SICI*.

## PJESA V. Sigurimi i cilësisë së procesit të vlerësimit të jashtëm

Ky kapitull përmban informacion mbi rekomandimet dhe praktikat më të mira në lidhje me sigurimin e cilësisë së procesit të vlerësimit të jashtëm.

### 1. Rregullat dhe procedurat e brendshme në nivelin e agjencive përgjegjëse për sigurimin e cilësisë

#### *1.1. Procedurat e brendshme për ekipin e vlerësimit të jashtëm – Kosovë\**

Autor: Donjeta Nimani Binçe

Procesi i validimit dhe akreditimit të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisit Profesional (IAAP)<sup>16</sup> në Kosovë kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).

Procesi i akreditimit (si pjesë e vlerësimit të jashtëm) siguron që institucionet të përmbushin kriteret dhe standardet e cilësisë për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimeve/moduleve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës.

Procesi i vlerësimit është rregulluar me një udhëzim administrativ, ku parashikohen parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe procedurat për validimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve. Këto procedura përcaktojnë përgjegjësitë për ekipin e vlerësimit të jashtëm, të cilin në e quajmë ekipi i ekspertëve.

Ekipi i ekspertëve është përgjegjës për të vlerësuar kualifikimin dhe dokumentacionin e institucioneve, si dhe të dokumenteve të tjera sipas udhëzimeve të AKK-së.

Ekipi i ekspertëve ndjek procedurat, kriteret dhe kërkesat bazuar në orientimet e zhvilluara në vijim të udhëzimeve administrative për procedurat, si për shembull detyrat e ekspertëve.

Gjithashtu, ekspertët rekrutohen me shpallje publike përmes konkursit publik për validimin e kualifikimit dhe akreditimin e institucioneve. Lista e ekspertëve të jashtëm miratohet nga bordi drejtues dhe në bazë të saj krijohet një grup ekspertësh që përdoren për institucione specifike dhe kualifikime specifike.

Ekipi i ekspertëve udhëhiqet nga stafi i AKK-së për ndjekjen e procedurave të mëposhtme:

1. Shqyrton aplikimet e dorëzuara dhe evidencat e tjera për validimin e kualifikimit dhe akreditimin e institucioneve.
2. Kryen vizitën në terren.
3. Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të panelit, diskuton dhe harmonizon mendimet e tyre.
4. Kontribuon në punën për përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm bazuar në gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me procesin.

---

<sup>16</sup> Institucionet e Arsimit dhe Aftësisit/Formimit Profesional u referohen institucioneve që ofrojnë kualifikime të AFP-së (shkolla, qendra trajnimi, akademi, etj.).

Përveç këtyre, ekipi i ekspertëve vlerëson edhe programet bazuar në standardin e profesionit, i cili është një dokument që pasqyron njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për kryerjen e detyrave dhe veprimtarive të punës të profesioneve të caktuara dhe sipas nevojave të tregut të punës.

Sipas kuadrit legjislativ, çdo kurrikul duhet të bazohet në funksionet dhe kërkesat e standardeve të profesioneve.

Për të dëshmuar se vlerësimi i jashtëm është realizuar në përputhje me kuadrin legjislativ dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, ekipi i ekspertëve pajiset me dokumentet e nevojshme, si për shembull:

- Lista e kontrollit për dokumentin e kërkuar për procesin e akreditimit dhe validimit (Shembulli nr.1);
- Aplikimet e Institucionit të AFP-së dhe evidenca të tjera;
- Korniza Kombëtare e Kualifikimeve;
- Udhëzimi Administrativ;
- Standardi i profesionit;
- Modeli i raportit të vlerësimit;
- Deklaratë për parandalimin e konfliktit të interesit.

Gjatë vlerësimit të materialit, çdo anëtar i ekipit të ekspertëve do të ketë të njëjtat përgjegjësi, dhe vetëm njëri prej tyre do të udhëheqë procesin.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve monitoron<sup>17</sup> dhe koordinon në mënyrë të vazhdueshme procesin e validimit dhe akreditimit. Çdo kërkesë dhe kontakt me institucionin e vlerësuar bëhet përmes AKK-së.

#### **Shtojca:**

- Lista e kontrollit për dokumentin e kërkuar për procesin e akreditimit dhe validimit (Dokumenti 1);
- Aplikimet e institucionit të AFP-së dhe evidenca të tjera;
- Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (Dokumenti 2);
- Udhëzimi Administrativ (Dokumenti 3);
- Standardi i profesionit (Dokumenti 4);
- Modeli i raportit të vlerësimit (Dokumenti 5);
- Deklarata për parandalimin e konfliktit të interesit (Dokumenti 6);

---

<sup>17</sup> Monitorimi është procesi i kontrollit të cilësisë dhe zbatohet në mënyrë periodike nëpërmjet mbledhjes sistematike të informacionit sasior dhe cilësor. Procesi i monitorimit përfshin shqyrtimin dhe raportimin e gjetjeve për zbatimin e procesit të sigurimit të cilësisë. Përveç monitorimit të vazhdueshëm, mund të zhvillohen edhe monitorime sipas nevojës (*ad hoc*), të cilat bëhen me ose pa njoftim paraprak. Monitorimi kryhet nga ekspertë të sigurimit të cilësisë dhe ekspertë të kualifikimit. Kjo bën të mundur që AKK të ketë një tablo të qartë të performancës së ofruesve të vlerësimit. AKK, mbi këtë bazë, bën aranzhimin e ofruesit, ndërsa në rast të mosplotësimit të kritereve të përcaktuara për akreditimin, akreditimi mund të anulohet. Procesi i monitorimit shërben si një qasje mbështetëse dhe këshilluese për masat efektive që duhet të ndërmerren për të garantuar cilësinë.

- Udhëzues për ekipin e ekspertëve të jashtëm (Dokumenti 7);
- Shpallja publike përmes konkursit publik (Dokumenti 8).

## *1.2. Procedurat e brendshme të agjencisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, që rregullon zbatimin e vlerësimit të jashtëm - Mali i Zi*

Autorë: Vesna Babović, Dragan Berilažić, Ivan Marković, Vladislav Koprivica

Dokumenti 'Rregullat dhe Procedurat e Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Arsimore dhe Qendrave të Arsimit Profesional gjatë përcaktimit të cilësisë së punës edukativo-pedagogjike brenda institucioneve' është përgatitur si rezultat i organizimit dhe zbatimit të përbashkët (arsim i përgjithshëm dhe AFP) të vlerësimit të jashtëm të institucioneve. Ai specifikon aktivitetet, nxitësit e veprimeve dhe kalendarin e zbatimit, si dhe formularët e përdorur gjatë organizimit dhe zbatimit të procesit (Plani i Mbikëqyrjes dhe Raporti për Zbatimin e Mbikëqyrjes<sup>18</sup>). Aktivitetet e specifikuar mbulojnë të gjitha fazat e procesit të vlerësimit të jashtëm, përkatësisht:

- Përgatitja për vizitat në terren;
- Zhvillimi i vizitës në terren;
- Hartimi i raportit.

Aktivitetet përgatitore për vizitën në terren kryhen gjatë fazës I. Ato përfshijnë sa vijon:

- Njoftimi për planin javor të mbikëqyrjes në përputhje me planin vjetor;
- Krijimi i ekipit mbikëqyrës;
- Njoftimi i institucionit për kohën e mbikëqyrjes dhe detyrimet e tyre;
- Shkëmbimi i dokumenteve brenda ekipit mbikëqyrës;
- Hartimi i planit për vizitën në terren dhe caktimi i detyrave të veçanta për anëtarët e ekipit;
- Organizimi i anketave të mësuesve, prindërve dhe nxënësve.

Gjatë fazës II - Kryerja e një vizite në terren, procedura specifikon aktivitetin që përfshin sigurimin e hapësirës dhe kushteve të përshtatshme për punën e mbikëqyrësve.

Gjatë fazës III - hartimi i raportit, procedura specifikon aktivitetet që kanë të bëjnë me dorëzimin e Raportit për Zbatimin e Mbikëqyrjes, përgatitjen e raporteve individuale dhe konsolidimin e raporteve, si dhe dorëzimin e raportit në institucion.

Të gjitha aktivitetet e tjera janë të përcaktuara në Metodologjinë për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së punës edukativo-pedagogjike brenda institucioneve.

Dokumente shtesë:

- Rregullat dhe procedurat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore dhe qendrave të arsimit profesional gjatë përcaktimit të cilësisë së punës edukativo-pedagogjike brenda institucioneve;
- Plani i Mbikëqyrjes;

---

<sup>18</sup> Dy dokumente të ndryshme, i pari i përpiluar para nisjes së procesit të mbikëqyrjes dhe i dyti pas përfundimit të procesit të mbikëqyrjes.

- Raporti për Zbatimin e Mbikëqyrjes.

## 2. Mbikëqyrja e Vlerësimit të Jashtëm

### 2.1. Mbikëqyrja e raporteve të vlerësimit të jashtëm – Maqedonia e Veriut

Autorë: Antonela Stojanoska, Valentina Gocevska, Ardijsana Isahi Palloshi

1. Pas vlerësimit të jashtëm të institucionit arsimor (shkollës), dhe para raportit përfundimtar që do t'i dorëzohet shkollës, drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit krijon grupin e ekspertëve për kontrollin e projekt Raportit të vlerësimit të cilësisë së shkollave. Grupi i ekspertëve përbëhet nga tre inspektorë me përvojë, të cilët kanë për detyrë të kontrollojnë projekt raportin: A i ka të gjitha elementet në përputhje me treguesit? A është përafëruar teksti paraprak me notën/nivelin e caktuar nga inspektorët gjatë vlerësimit?, etj.

Në rast konstatimi të gabimeve në projekt raport, raporti duhet të rishkruhet nga inspektorët. Pas reflektimit të vërejtjeve, raporti duhet të miratohet nga grupi i ekspertëve dhe më pas si raport përfundimtar t'i dorëzohet shkollës. Raporti përfundimtar i dorëzohet institucionit arsimor ku është kryer vlerësimi integral.

2. Puna e vlerësuesve të jashtëm (inspektorëve arsimorë) monitorohet dhe vlerësohet nga organi i posaçëm i formuar nga Qeveria i quajtur Këshilli i Autoriteteve Inspektuese. Në bazë të kriterëve të caktuara, ky Këshill vlerëson punën e inspektorëve (p.sh. matjet, notat, gjetjet, rekomandimet, etj). Grupi i ekspertëve formohet nga Drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit me inspektorë me përvojë dhe që kanë kryer një numër të madh vlerësimesh. Ata shqyrtojnë të gjitha raportet e përgatitura nga vlerësimet e kryera, bëjnë vërejtje nëse diçka nuk është në një linjë me treguesit e vlerësimit të cilësisë dhe pas korrigjimit dhe reflektimit të vërejtjeve në raport nga inspektori që ka përgatitur raportin, ata japin miratimin e tyre për dorëzimin e raportit në institucionin përkatës arsimor. Inspektorët përgatisin raporte mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për punën e tyre.

#### Dokumente shtesë:

- [Оценување-и-образецот-за-оценување-на-учинокот-на-инспекторите-СЛВ-238.19.pdf \(is.gov.mk\) \(në maqedonisht\)](#)

## *2.2. Hapat e ndërmarrë për të garantuar cilësinë e raporteve të vlerësimit të jashtëm – Skoci*

Autor: Tracie McEwan

Në Skoci, Inspektorët e Madhërisë së Tij duhet të garantojnë përmbushjen e standardeve të larta për inspektimet si dhe qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve. Kjo përfshin edhe garantimin që kornizat e përmirësimit të cilësisë dhe treguesit e cilësisë të përdoren në mënyrë koherente dhe që vlerësimi i treguesve të cilësisë dhe aplikimi i notave përmbledhëse të zbatohen në mënyrë sa më të drejtë në të gjithë Skocinë.

Inspektorët e Madhërisë së Tij angazhohen në një sërë aktiviteteve që i ndihmojnë për të garantuar cilësi sa më të lartë të punës së tyre inspektuese. Këtu përfshihen aktivitetet që zhvillohen para, gjatë dhe pas vizitës së inspektimit.

Anëtarët e ekipit të inspektimit rekrutohen përmes proceseve rigoroze të përzgjedhjes. Ato mund të përfshijnë Inspektorët e Madhërisë së Tij, Ndihmës Inspektorët, Inspektorët për fushën e Shëndetësisë dhe Ushqyerjes, Inspektorët Vullnetarë në nivel Jo-specialisti dhe Vlerësuesit e Asociuar. Këta punonjës trajnohen dhe mbështeten për të kryer punën e tyre sipas standardeve më të larta të mundshme.

Inspektorët e rinj, vlerësuesit e asociuar dhe inspektorët vullnetarë fillimisht ndjekin dhe vëzhgojnë anëtarët me përvojë të ekipeve duke punuar, përpara se të caktohen për angazhimin në inspektimin e tyre të parë. Gjithashtu, i gjithë personeli i inspektoratit merr pjesë në zhvillimin e vazhdueshëm profesional për të garantuar njohjen dhe perceptimin e përbashkët të mënyrës së përdorimit dhe aplikimit të kornizave të përmirësimit të cilësisë dhe politikave dhe udhëzimeve për inspektimin.

Anëtarët e ekipeve të inspektimit i nënshtrohen trajnimeve të shumta profesionale në lidhje me aftësitë e nevojshme për realizimin e rolit të tyre. Puna jonë inspektuese mbështetet nga një sërë dokumentesh përkatëse të jashtme dhe të brendshme, ku përfshihen dokumentet politike, kornizat e cilësisë dhe modalitetet, procedurat dhe udhëzimet për inspektimin dhe vlerësimin.

Më konkretisht, gjatë përgatitjes së raportit të vlerësimit të jashtëm, inspektorët e Madhërisë së Tij përdorin një sërë standardesh për të vlerësuar dhe raportuar në lidhje me cilësinë dhe përmirësimin e punës në arsimin skocez. Standardet përcaktohen në kornizat e publikuara të cilësisë. Për inspektimin e institucioneve të arsimit bazë, kolegjeve dhe institucioneve të arsimit të mëtejshëm përdoren kornizat e ndryshme. Puna e ekipeve të inspektimit bazohet pikërisht në këto korniza për kryerjen e vlerësimit të institucioneve në fjalë. Secila kornizë përfshin një sërë treguesish të cilësisë, të cilave iu referohen Inspektorët e Madhërisë së Tij për të bërë vlerësime sa më profesionale.

Në kuadrin e inspektimit, ekipet përkatëse takohen me njëri-tjetrin për të diskutuar në lidhje me të dhënat dhe informacionin e grumbulluar nga inspektimi, për të dakorduar në lidhje me gjetjet kryesore të përgjithshme dhe për të vendosur në lidhje me vlerësimet dhe notat përmbledhëse, aty ku është e nevojshme. Edhe drejtuesit e Shërbimit të Kontrollit dhe Inspektorët e Lartë mund të vëzhgojnë disa prej inspektimeve, si pjesë e procesit të sigurimit të cilësisë.

- Inspektori Administrativ është personi përgjegjës për të udhëhequr dhe drejtuar takimet e ekipit.
- Shkëmbimi i informacionit, puna në ekip dhe sfida me kolegët janë një aspekt i brendshëm i aktiviteteve të inspektimit dhe vlerësimit. Kombinimi i tyre garanton njohjen dhe perceptimin e

përbashkët të problematikave kyçe dhe dakordimin kolektiv në lidhje me rezultatet e inspektimit dhe vlerësimit.

Drafti i parë i punës:

- Drafti i parë shkruhet dhe i dërgohet administratorit, i cili e formaton dokumentin dhe ia dërgon grupit të inspektimit. Inspektori Administrativ merr parasysh të gjitha komentet e ekipit dhe ia kthen dokumentin përsëri administratorit. Administratori ia dërgon draftin e parë të përditësuar personit përgjegjës për sigurimin e cilësisë, i cili e shqyrton më tej dokumentin. Që dokumenti të jetë i publikueshëm, duhet të përmbushen disa kritere. Për shembull, shkrimi duhet të jetë në gjuhë të thjeshtë për prindërit, duke shmangur përdorimin e shkurtesave apo shkurtimeve. Dokumenti duhet të identifikojë pikat e forta dhe fushat për përmirësim që mbulojnë aspekte të ndryshme të punës së shkollës. Fushat për përmirësim nuk duhet të jenë shumë të përgjithshme.

Drafti i dytë i punës:

- Inspektori Administrativ reflekton të gjitha ndryshimet dhe më pas ia dërgon dokumentin përsëri administratorit, i cili ia dërgon Kreut të Shërbimit të Kontrollit.
- Kreu i Shërbimit të Kontrollit bën vërejtjet e mëtejshme dhe ia dërgon të gjitha komentet shtesë Inspektorit Administrativ.

Drafti i tretë i punës:


- Inspektori Administrativ reflekton të gjitha ndryshimet shtesë të dakorduara tashmë, të kryera nga Kreu i Shërbimit të Kontrollit;
- Inspektori Administrativ lexon dhe rishikon versionin përfundimtar të dokumentit dhe ia dërgon më pas shkollës për komente.
- Drejtuesit e shkollës dhe përfaqësuesit e autoriteteve lokale i shqyrtojnë dokumentet dhe ia dërgojnë komentet e tyre Inspektorit Administrativ.
- Inspektori Administrativ reflekton të gjitha ndryshimet e dakorduara, dhe më pas dokumenti dërgohet për publikim në faqen e internetit të shkollës, si autoriteti arsimor, dhe në faqen e internetit të agjencisë shtetërore përgjegjëse për çështjet e arsimit.

### 2.3. Çfarë bën Inspektorati për të kontrolluar, monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e punës së tyre? – Holanda

Autor: Herman Franssen

Çfarë bën Inspektorati Hollandez për të kontrolluar, monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e punës së tyre?

#### How to support and develop professional culture and conduct?



Udhëzuesi i punës: përshkrimet e procesit dhe instrumentet

Udhëzuesi i punës është një sistem digjital që përmban kryesisht modalitetet procedurale për kryerjen e të gjitha llojeve të detyrave të inspektoratit (p.sh. inspektimet në shkolla dhe borde, përgatitja dhe zbatimi i vlerësimeve tematike, etj.).

Për secilin hap të procesit, përcaktohet objektivi dhe mënyra e zhvillimit të aktivitetit (kush është i përfshirë, cilat janë detyrat e personave të përfshirë, etj.). Në udhëzues shpjegohet qartë çdo aktivitet inspektues: kush është personi përgjegjës, çfarë duhet bërë dhe kur. Shpesh i referohet edhe dokumenteve dhe/ose formateve bazë të nevojshme për zbatimin e procesit përkatës. Për shembull, në rastin e hapave të procesit të inspektiveve në shkolla, të gjitha dokumentet e nevojshme për këtë qëllim (p.sh. formulari i përgatitjes, formulari i vëzhgimit të orës së mësimit, pasqyra e përgjithshme e gjyqimeve, formati i raportit) janë të lidhura me këtë sistem.

Inspektorati vlerëson çdo vit, nëpërmjet auditimeve të brendshme, nëse zbatimi i mbikëqyrjes vazhdon të ndjekë hapat e procesit të përshkruara në këtë kornizë të brendshme të cilësisë (shih shembullin e praktikës së mirë V.6.1).

Korniza e cilësisë përmban edhe disa udhëzime që lidhen me vlerësimin, si për shembull, përcaktimi i mbikëqyrjes vijuese, rregullat e vendimmarrjes në rastet e konstatimit të cilësisë në nivel 'të pamjaftueshëm' ose 'shumë të dobët'.

Korniza e inspektimit

Korniza e inspektimit është pikënisja kryesore për vlerësimin e cilësisë së ofertës arsimore të shkollave. Për çdo standard cilësie, korniza përmban edhe përshkrimin standard (bazuar në legjislacionin sektorial) të asaj që nënkuptohet me termin 'cilësi bazë'.

Struktura është si më poshtë:

- Emri dhe përshkrimi i standardit;
- Cilësia bazë e standardit: shpjegimi i cilësisë bazë të këtij standardi;
- Ambiciet shtesë: aspektet vetjake të cilësisë (sugjerime për shtim nga bordi ose vetë shkolla);
- Kërkesat statutorë: referimi tek kërkesat statutorë.

### **TLP3. Teaching (Strategies)**

The teachers' pedagogical-didactic approach is designed to ensure that pupils develop and make progress, and are able to do this without interruptions.

#### **Basic standard of quality**

In their classes teachers create a pedagogically and didactically sound and stimulating learning environment which ensures that pupils feel safe and are actively involved. The teachers have high expectations of all pupils. They ensure orderly managed classes and an efficient use of teaching time. Teachers make sure the goal of the lesson is understood. During classes, they monitor if the pupils' progress towards the lesson goals is sufficient and adjust their teaching as needed. Teachers explain the subject matter in a clear manner and give pupils sufficient time to practice with the learning material. They adapt instructions, processing and planned teaching time to the learning needs of groups and individual pupils alike. Teachers provide their pupils with individual feedback on their completed work and on their learning process. They encourage pupils to reflect on their own development.

#### **Additional ambitions**

- Are there additional ambitions with respect to the teaching strategies, and if so how are these achieved?

#### **Statutory requirements**

- Article 2, WPO: The school prepares pupils for subsequent education.
- Article 8, section 1, WPO: Education is designed to ensure that pupils develop and make progress, and are able to do this without interruptions. To achieve this 'unimpeded development', it is essential that the school's teaching strategies correspond with the pupil's current level of development.
- Article 8, section 3, WPO: Education promotes active citizenship and social cohesion (knowledge and respect for fundamental values and the development of social and civic skills).
- Article 12, sections 2 and 3, WPO: The school has formulated its teaching principles in the school plan. The school's teaching policy and approach are evident in the teachers' day-to-day actions.

Për përdorim të brendshëm nga inspektorët, çdo standardi i është shtuar e ashtuquajtura Baza e Njohurive. Këtu, inspektorët mund të gjejnë informacion kontekstual në lidhje me standardin në fjalë. Ai përbëhet nga sa vijon:

- Konteksti i standardit;
- Shpjegimi i mëtejshëm i cilësisë bazë dhe aspekteve të tjera të cilësisë;
- Pyetjet kryesore: këto mund të përdoren nga inspektorët gjatë shqyrtimit të cilësisë së standardit në fjalë;
- Detajet që përshkruajnë, ndër të tjera, marrëdhënien me standardet e tjera.

Korniza e inspektimit përmban informacion (standarde dhe kritere) në lidhje me mënyrën e gjykimit nga ana e inspektorëve në nivel standardesh si dhe për gjykimin e përgjithshëm mbi cilësinë e arsimit në shkollë.

#### Fokusi te profesionalizmi

Korniza aktuale e inspektimit (ndryshe nga korniza e mëparshme) parashikon më shumë hapësirë për dhënien e mendimeve profesionale nga inspektori individual ose ekipi i inspektorëve. Struktura e kornizës aktuale është sigurisht më pak e shtjelluar (në aspektin e treguesve dhe kritereve) për vlerësimin e standardeve individuale dhe, për këtë arsye, më pak orientuese krahasuar me kornizën e mëparshme. Inspektorët duhet të përdorin ekspertizën e tyre më shumë për të arritur në gjykime të besueshme, të drejta dhe efektive, duke marrë parasysh si kornizën ashtu dhe kontekstin e shkollës.

Cili është niveli i cilësisë së garantuar nga inspektorati për ta arritur këtë?

1. Trajnimi i inspektorëve (të rinj) për aftësitë inspektuese dhe për vlerësimin e standardeve. Përpara zbatimit të kornizës së re, ky ka qenë një element të cilit i është kushtuar vëmendje e madhe. Inspektorët e rinj marrin trajnime të përgjithshme dhe specifike (trajnime për sektorin e arsimit ku do të punojnë), ndër të tjera, për vlerësimin e cilësisë së arsimit.
  2. Mbështetja e informacionit bazë kontekstual dhe instrumenteve për mbledhjen e informacionit (p.sh. formulari i vëzhgimit të orës së mësimi). Për këtë qëllim inspektorët mund t'i referohen të ashtuquajturës Baza e Njohurive për të gjetur të dhëna dhe informacion bazë (p.sh. publikime, studime) për të gjitha standardet.
- Veç kësaj, vetë korniza e inspektimit shërben natyrshëm si orientim për vlerësimin e standardeve.
3. Konsultimi me kolegët gjatë inspektimeve. Shumë aktivitete inspektimi përfshijnë më shumë se një inspektor. Kjo krijon mundësi për të dalë me gjykime dhe vlerësime të përbashkëta përmes konsultimit.
  4. Diskutimet e rasteve brenda ekipeve ku punojnë inspektorët. Të gjithë inspektorët caktohen dhe bëhen pjesë e një ekipi përgjegjës për mbikëqyrjen në një rajon të caktuar të Holandës. Këto ekipe kanë një shkallë të caktuar autonomie për sa i përket planifikimit dhe realizimit të punës. Gjatë konsultimeve në këto ekipe, ka vend dhe hapësirë për të sjellë dhe ndarë me të tjerët raste nga më të ndryshmet. Këto konsultime janë një mjet i rëndësishëm për të garantuar besueshmërinë e gjykimeve.
  5. Të gjitha raportet e inspektimit të shkollave shqyrtohen dhe vlerësohen së brendshmi nga inspektorë të tjerë. Duke iu referuar këtyre raporteve, inspektorati është në gjendje të shqyrtojë mënyrën e zbatimit të kornizës së vlerësimit dhe konkluzionet e arritura nga inspektorët në punën për vlerësimin e cilësisë së arsimit.

6. Pjesëmarrja e menaxherit në inspektive. Rreth një herë në vit në inspektim merr pjesë edhe një menaxher, i cili vëzhgon inspektorët. Më pas, ai ndan vërejtjet dhe komentet përkatëse me inspektorin e vëzhguar.

## *2.4. Shembuj të aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në nivel agjencie të sigurimit të cilësisë – Francë*

Autor: Dr Bertrand Richet

### Mbikëqyrja e vlerësimit të jashtëm

Në praktikën e Këshillit Francez për Vlerësimin e Shkollës, mbikëqyrja vjen para vetëvlerësimit, falë trajnimit të vlerësuesit. Askush nuk ka lindur vlerësues. Ju mund të bëheni vlerësues vetëm duke tejkaluar ekspertizën tuaj fillestare (si inspektor, drejtor ose mësues), kontrollin (individual), gjë që është bërë për dekada të tëra në Francë dhe është pjesë e kulturës së punonjësve. Nënshkrimi i kodit të etikës për vlerësimin është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim.

Mbikëqyrja vjen gjatë procesit të vlerësimit. Vlerësuesit mund të kontaktojnë ekspertët rajonalë (të cilët janë vetë në kontakt me ekspertët e Këshillit Francez për Arsimin Shkollor rregullisht), nëse kanë pyetje për ndonjë problematikë të caktuar dhe për të marrë përgjigje për zgjidhjen e tyre të mundshme.

Mbikëqyrja vjen pas vizitës në shkollë dhe shkrimit të raportit kur bëhet fjalë për rileximin e raportit për të garantuar përputhshmërinë e tij me kornizën e vlerësimit dhe me kodin e etikës. Kjo është një pjesë delikate e procesit pasi askush, veçanërisht personat në pozicione të larta, nuk është i gatshëm për t'u 'kontrolluar', megjithëse çështja nuk është të kontrollosh, por të mbrosh si vlerësuesit ashtu edhe procesin e vlerësimit. Në këtë fushë ka ende vend për përparim të mëtejshëm.

Shembull i procedurave të brendshme të agjencisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë.

Këshilli për Vlerësimin e Shkollave këmbëngul në rëndësinë e analizës së reagimeve dhe komenteve të marra në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, veçanërisht pasi vlerësimi i shkollës është një proces i ri si nga pikëpamja kohore ashtu edhe kulturore.

Raportet e vetëvlerësimit përmbajnë një pjesë kushtuar mënyrës së përjetimit të procesit nga palët e interesuara. Mbikëqyrja e vlerësimit të jashtëm mundëson përmirësimin e aspekteve të sigurimit të cilësisë. Autoritetet rajonale arsimore raportojnë çdo vit tek Këshilli për Vlerësimin e Shkollave, duke iu shpjeguar, ndër të tjera, se çfarë ka shkuar siç duhet dhe çfarë jo. Dhe e fundit, vetë Këshilli për Vlerësimin e Shkollave analizon shumë raporte të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm, takohet rregullisht me ekspertë rajonalë dhe shqyrton proceset e saj, në mënyrë që të përmirësojë punën për vlerësimin e shkollave në mënyrë të përhershme.

### **Shembuj në lidhje me mënyrën e përgatitjes së raporteve me shkrim me të njëjtën sasi të dhënash cilësore dhe sasiore nga vlerësues të ndryshëm të jashtëm**

Të dhënat në dispozicion janë të njëjta për të gjitha shkollat dhe vlerësuesit dhe korniza e vlerësimit është kornizë kombëtare e fokusuar në përdorimin e trekëndëshit të provave/evidencave, kështu që teorikisht nuk duhet të ketë dallime midis këtyre institucioneve në mbarë Francën.

Megjithatë, vazhdon të ketë pabarazi nga një shkollë në tjetrën dhe nga një ekip vlerësues në tjetrin. Mungesa ose prania minimale e treguesve në një raport vetëvlerësimi nuk kompensohet gjithmonë gjatë vlerësimit të jashtëm, veçanërisht nëse politika e një autoriteti rajonal arsimor është që të mos 'shqetësojë' shkollat (pasi vlerësimi është i ri si proces, disa mendojnë se është më mirë të mos tregohen shumë kërkues për momentin) ose nëse vetë vlerësuesit nuk ndjehen rehat me ta.

Këshilli për Vlerësimin e Shkollave është i bindur se gjërat do të ndryshojnë për mirë me kalimin e kohës, pasi vlerësimi do të kthehet në pjesë të operacioneve dhe të menduarit të përditshëm në shkolla. Përveç familjarizimit relativ të shkollave me shifrat (të dhënat cilësore janë më pak problem, sepse njerëzit janë më të mësuar me to), çështja është që ata të jenë në gjendje të lidhin të dhënat me kontekstin, vendimin dhe perspektivat, d.m.th. të jenë në gjendje të 'problematizojnë' një situatë të caktuar, duke shkuar përtej mikroelementeve dhe për të ofruar një tablo më të përgjithshme dhe më të integruar të gjërave.

### **Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit arsimor për vlerësimin e jashtëm**

Sipas personave të përfshirë në procesin e vlerësimit të jashtëm, përjetimi i vlerësimit qoftë si punonjës në një shkollë të vlerësuar ose si anëtar i ekipit të vlerësimit të jashtëm është një përvojë që të ndryshon jetën, veçanërisht në një vend ku procesi i vlerësimit të shkollës është duke u zhvilluar për herë të parë. Ai krijon mundësi që personat e përfshirë të përdorin ekspertizën e tyre fillestare në një mënyrë tjetër, të zbulojnë kompleksitetin e një shkolle jashtë ambienteve të klasave dhe të njihen me ekosistemin specifik të një shkolle në kuadrin e sistemit më të gjerë arsimor. Me fjalë të tjera, vlerësimi hap perspektiva të reja si për shkollat ashtu edhe për kontributin e veçantë të dikujt në lidhje me mënyrën e funksionimit të tyre. Ai i jep punës së personave të përfshirë një kuptim të ri, ndihmon për të identifikuar më mirë nevojat e nxënësve dhe për të kuptuar që veprimi kolektiv është më efikas se veprimi individual.

### 3. Besueshmëria e gjykimit dhe përdorimi i kritereve të përbashkëta

#### 3.1. Shembuj të peshimit të standardeve sipas rëndësisë së tyre – Mali i Zi

Autor: Vladislav Koprivica

Në Republikën e Malit të Zi, vlerësimi i jashtëm për të gjitha institucionet kryhet nga një ekip i përbashkët i Institutit të Arsimit dhe Qendrës për Arsim dhe Aftësim Profesional. Për këtë arsye, është hartuar një metodologji e përbashkët për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e punës në institucionet arsimore dhe pedagogjike. Vlerësimi kryhet në pesë fusha kryesore. Secila fushë shoqërohet me një numër të caktuar standardesh të cilësisë dhe secili standard me një numër të caktuar treguesish. Çdo shkollë vlerësohet me pikë në shkallën 1.00 deri në 10.00. Bazuar në përvojën tonë të deritanishme, kemi arritur në përfundimin se secila prej fushave dhe secili standard nuk ndikojnë në vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së institucionit në mënyrë të barabartë. Prandaj, kemi caktuar koeficientët e peshimit për secilin standard të cilësisë dhe secilën fushë kyçe të cilësisë. Në metodologjinë e mëparshme për përcaktimin e cilësisë së punës së shkollës, të gjitha fushat dhe të gjitha standardet brenda atyre fushave kishin ndikim të barabartë mbi vlerësimin përfundimtar të shkollës. Në metodologjinë e re, janë krijuar koeficientët e peshimit për çdo fushë, domethënë, pesha e një fushe të caktuar mbi përqindjet në notën e përgjithshme të shkollës. Duke shumëzuar koeficientët dhe notat e të gjitha fushave, shkolla vlerësohet me një notë përfundimtare. E njëjta gjë vlen edhe për standardet brenda fushës. Çdo standardi i është bashkangjitur një koeficient peshe, domethënë, pesha e një standardi të caktuar në përqindjet në vlerësimin total të fushës.

Për shembull, fusha: Mësimdhënia dhe Të Nxënit përbën 45% të vlerësimin të përgjithshëm të institucionit. Tre janë standardet e cilësisë që maten në këtë fushë, përkatësisht:

Standardi I: Planifikimi kryhet në përputhje me kërkesat e kurrikulës. Pesha e këtij standardi në vlerësimin e fushës përkatëse është 20%.

Standardi II: Mësimdhënia përshtatet me karakteristikat zhvillimore, nevojat dhe aftësitë e nxënësve dhe fokusohet në arritjen e rezultateve të të nxënit. Pesha e këtij standardi në vlerësimin e fushës përkatëse arrin në 50%.

Standardi III: Monitorimi, vlerësimi dhe konstatimi i njohurive të nxënësve është i rregullt, publik dhe i larmishëm dhe ka funksion zhvillimor. Pesha e këtij standardi në vlerësimin e fushës përkatëse është 30%.

Nga ana tjetër, fusha e Menaxhimit dhe Administrimit përbën 20% të vlerësimin të përgjithshëm të institucionit. Katër janë standardet e cilësisë që maten brenda kësaj fushe me pesha të ndryshme, përkatësisht:

Standardi I: Qëllimi i planifikimit dhe programimit të punës është përmirësimi i punës së shkollës. Pesha e këtij standardi në vlerësimin e fushës përkatëse është 20%.

Standardi II: Drejtori organizon punën në mënyrë efikase dhe menaxhon proceset e punës edukativo-pedagogjike brenda shkollës. Pesha e këtij standardi në vlerësimin e fushës përkatëse është 25%.

Standardi III: Drejtori garanton sigurimin efektiv të cilësisë në drejtim të mësimdhënies dhe të nxënit. Pesha e këtij standardi në vlerësimin e fushës përkatëse është 30%.

Standardi IV: Drejtori krijon një mjedis stimulues për mësimin, zhvillimin profesional dhe avancimin e punonjësve. Pesha e këtij standardi në vlerësimin e fushës përkatëse është 25%.

### *3.2. Arritja e konsensusit dhe konceptet e përbashkëta në Vlerësimin e Jashtëm të Shkollave në Portugali*

Autorë: Isabel Barata dhe Rosa Micaelo

Inspektorati Portugez për Arsim dhe Shkencë (*IGEC*) promovon rregullisht organizimin e takimeve dhe diskutimeve ndërmjet vlerësuesve (inspektorë dhe ekspertë të jashtëm - përfaqësues të arsimit të lartë), të cilët janë pjesë e ekipeve vlerësuese, me qëllim shqyrtimin e koncepteve të kornizës për vlerësimin e jashtëm të shkollave. Kjo procedurë kontribuon në punën për përvetësimin e njohurive, në pasurimin shkencor të vlerësuesve dhe në arritjen e konsensusit mbi interpretimet e ndryshme të koncepteve.

Në të vërtetë, vlerësimi është një strukturë sociale dhe transaksionale që pajton këndvështrimet individuale (subjektive) dhe kolektive (ndërsujektive). Prandaj, strategjitë për ndërsujektivitetin janë një praktikë thelbësore për zbatimin e vlerësimit të jashtëm të shkollës. Ndërtimi i gjykimeve vlerësuese apo vlerësimi i cilësisë së shërbimeve arsimore të ofruara nga shkollat nuk është një detyrë e thjeshtë, si matja apo verifikimi i bazuar në një listë kontrolli.

Logjika mbi të cilën bazohet puna për ndërtimin e gjykimeve për vlerat është e rrënjësuar në rrjetin ndërsujektiv ku përfshihen të gjithë vlerësuesit që marrin pjesë në vlerësim. Procesi i vlerësimit dhe produkti përfundimtar (raporti) përfitojnë nga kontributet e ndryshme të secilit anëtar të ekipit, duke u pasuruar me ekspertizë nga fusha të ndryshme.

Prandaj, nevojitet përfshirja dhe pjesëmarrja e të gjithëve në punën për arritjen e konsensusit në lidhje me interpretimet e koncepteve të përdorura dhe gjykimet e vlerave që duhet të orientojnë proceset e vlerësimit. Diskutimet mund të zhvillohen në mjedise formale, si takimet dhe sesionet e trajnimit të organizuara nga shërbimet e Inspektoratit, por edhe në kontekste joformale përmes përsiatjeve midis ekipeve të vlerësimit gjatë të gjitha fazave (përgatitja, vizita kryesore dhe raporti). Nëse është e nevojshme, edhe gjatë vizitës kryesore, ndërveprimi me personat që janë duke u vlerësuar mund të përfshijë diskutimin dhe sqarimin e kuptimit të disa koncepteve të përdorura në kuadrin e vlerësimit, duke synuar njohjen dhe krijimin e perceptimit të përbashkët në lidhje me këto koncepte midis vlerësuesve dhe të vlerësuarve.

Këto procese mbështesin vlerësuesit në punën për përzgjedhjen e provave përkatëse, peshimin e vlerës së tyre dhe validimin e gjykimeve vlerësuese, duke marrë parasysh kontekstin dhe projektet arsimore të shkollave, pa lënë pas dore, natyrisht, kuadrin e përgjithshëm të politikave të arsimit publik.

## 4. Trajnimet dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) i vlerësuesve të jashtëm

### 4.1. Trajnimet dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) i vlerësuesve të jashtëm me ushtrime simulimi – Shqipëri

Autorë: Etleva Kaçuli, Sara Hoxhallari

Procesi i sigurimit të cilësisë në sistemin shqiptar të AFP-së zhvillohet nëpërmjet vlerësimit të jashtëm në kuadrin e procesit të akreditimit. Të gjitha procedurat e paraqitura më poshtë përbëjnë një paketë trajnimi, e cila përfundon me certifikimin e vlerësuesve të jashtëm në kuadër të procesit të akreditimit.

Qëllimi: Ofrimi i trajnimeve për vlerësuesit e jashtëm ndodh kryesisht për qëllime certifikimi dhe përditësimi të njohurive. Përgatitja dhe trajnimi i denjë i vlerësuesve të jashtëm siguron cilësinë e procesit, standardizimin e vlerësimit institucional dhe komunikimin e unifikuar.

Trajnimi ndahet në 2 procese kryesore:

#### 1. Trajnimi fillestar (fazat):

##### 1a. Blloku I - Teori

Organizimi i një trajnimi 5-ditor në lidhje me aspektet teorike, me përfaqësues nga fusha të ndryshme, kandidatë për vlerësues të jashtëm për procesin e akreditimit.

Ky bllok trajnimi përfshin aspekte të tilla si:

- njohja me sistemin e akreditimit;
- shpjegimi i koncepteve të sigurimit të cilësisë, standardeve të akreditimit në përputhje me kërkesat themelore, plotësuese dhe kërkesat për ofruesit e rinj;
- njohja me aktet ligjore dhe nënligjore (kombëtare dhe evropiane) për sigurimin e cilësisë në AFP;
- prezantimi i vlerësuesve me manualin për procesin e akreditimit, 5 fushat e cilësisë, nënfushat, treguesit, kriteret dhe përshkruesit e niveleve, si dhe përdorimin e provave mbështetëse për vlerësimin;
- kryerja e ushtrimeve (me një grup treguesish të përzgjedhur nga të gjitha fushat e cilësisë) me pjesëmarrësit duke ndjekur modelin përkatës të raportit të përdorur për procesin e akreditimit.

Në thelb, ne zgjedhim një nënfushë nga raporti i vlerësimit dhe kërkojmë nga pjesëmarrësit tanë (hipotetiki) ta plotësojnë atë. Ne i udhëzojmë nëpërmjet kërkesave dhe pyetjeve duke i orientuar drejt llojit të të dhënave/informacionit që duhet t'i kërkojnë ofruesit të AFP-së. A duhet të përdorin vetëm të dhëna/evidenca apo në bazë të kriterëve mund të përdorin edhe intervistat dhe vëzhgimet? Kur duhet t'i përdorin ato dhe në çfarë mase?

Ne simulojmë rolin e drejtorit, të personelit dhe çdo reagim që mund të ndodhë në një situatë reale. Punonjësit e shkollës mund të mos gjejnë disa dokumente ose mund të mos jenë të gatshëm për t'i dorëzuar ato te personat e tjerë. Si duhet të reagojnë vlerësuesit tanë?... etj.

Shih dokumentin shtesë: Ushtrim - Trajnimi i vlerësuesve të jashtëm.

- Përhapja e disa praktikave të mira të konstatuara gjatë procesit të akreditimit të zbatuar më parë në Shqipëri.

#### 1b. Procesi i akreditimit (simulim praktik)

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) kryen një proces simulimi pranë institucioneve ofruese të AFP-së, në mënyrë që procesi të jetë sa më real. Meqenëse procedura e vërtetë do të ketë përfunduar para marrjes së vendimit për trajnimin e vlerësuesve tanë të ardhshëm, ky nuk konsiderohet si një proces i mirëfilltë i vlerësimit të jashtëm dhe fillojmë përsëri gjithçka nga e para. Për shembull, ne zgjedhim 4 ofrues të AFP-së, marrim miratimin e tyre dhe më pas dërgojmë vlerësuesit tanë të jashtëm për të zbatuar të gjitha hapat e përfshirë në një proces të vërtetë vlerësimi të jashtëm (kryerja e intervistave, vëzhgimeve, marrja e dokumentacionit dhe të dhënave, analizimi i tyre etj.). Prandaj, e quajmë simulim. Vlerësuesit tanë të ardhshëm do të kenë dorëzuar një raport të plotë për vlerësimin e jashtëm deri në përfundimin e simulimit.

Faza e dytë e trajnimit përfshin sa vijon:

- njohja e pjesëmarrësve me Kodin e Etikës dhe parimet bazë të sjelljes profesionale për vlerësuesit e jashtëm, si dhe me mënyrat e komunikimit;

Në ditën e parë të këtij trajnimi, pas njohjes me kodin e etikës, parimet e sjelljes profesionale dhe mënyrat e komunikimit me ofruesit e AFP-së, ata angazhohen në lojëra me role nëpërmjet simulimit të situatave të tilla si: prezantimi me ofruesit në ditën e parë, njoftimi i parë në formë elektronike i ofruesit të AFP-së në lidhje me vlerësimin dhe për shpjegimin e procesit, si dhe mënyra e hartimit të programit përkatës për të qenë sa më i kuptueshëm nga ofruesi.

Shih dokumentin shtesë: Trajnimi i vlerësuesve për etikën dhe komunikimin

- Diskutime lidhur me përmbajtjen e raportit të akreditimit, metodologjinë dhe procesin e hartimit të tij;
- Ndarja e vlerësuesve në grupe pune për përgatitjen e programit për vizitën dhe komunikimin me shkollën;
- Vizita në terren: gjatë vizitës vlerësuesit zhvillojnë takime me drejtuesit e institucionit, shqyrtojnë dosjet e vetëvlerësimit, mbledhin evidenca, kryejnë vëzhgime (me formularë të gatshëm vëzhgimi), intervistojnë grupet e interesit, etj.

Këto janë hapat që ata do të ndjekin normalisht edhe në një proces të mirëfilltë vlerësimi, dhe për këtë arsye duhet t'i ndjekin edhe gjatë simulimit dhe të përdorin më pas të dhënat për të shkruar raportin. Pra, në thelb, gjatë vizitës treditore të ofruesit të AFP-së, vlerësuesit e ardhshëm ndiqen nga një koordinator përfaqësues i agjencisë, i cili mban shënime në lidhje me çdo detaj të komunikimit dhe metodologjisë që ata përdorin, të veprimeve që kryejnë gjatë gjithë këtyre aktiviteteve, dhe se si e vlerësojnë çdo evidencë. Pas kësaj, koordinatori bën vërejtjet përkatëse. Mënyra e komunikimit, veprimet që ndërmarrin janë elemente që vlerësohen edhe në momentin kur vendoset nëse e kalojnë provimin e certifikimit apo jo.

- Pas përfundimit të vizitës në terren dhe marrjes së të dhënave/evidencave të nevojshme, vlerësuesit hartojnë raportin e akreditimit;
- Raporti i akreditimit dorëzohet dhe miratohet nga AKAFPK;
- Zhvillimi i testimit me shkrim dhe i intervistës;
- Pas përmbylljes me sukses të këtyre fazave, vlerësuesit e trajnuar certifikohen si vlerësues të jashtëm për procesin e akreditimit.

## 2. Trajnimi i vazhdueshëm

Për vlerësuesit e certifikuar planifikohet edhe zhvillimi i trajnimit të vazhdueshëm profesional. Trajnimi përfshin sa vijon:

- Përditësimi i vlerësuesve në lidhje me paketën e plotë ligjore mbi AFP-në;
- Komente/vërejtje për procesin e fundit të përfunduar;
- Evidentimi i pikave të forta, të dobëta, sfidave të procesit të akreditimit dhe vlerësuesve.

Koordinatorët e procesit të akreditimit nga AKAFPK prezantojnë shqetësimet dhe problematikat me të cilat ballafaqohen gjatë procesit dhe u shpjegojnë kriteret e tyre vlerësuesve të jashtëm. Gjithashtu, edhe vlerësuesit e jashtëm japin mendimin e tyre në lidhje me procesin dhe AKAFPK mban shënimet e nevojshme në mënyrë që të rishikojë procesin ose të identifikojë instrumente apo metodologji të reja që mund të jenë më efektive për shqetësimet e ngritura nga ata. Përveç kësaj, AKAFPK i dërgon ofruesit të AFP-së disa pyetësorë për vlerësimin e vlerësuesve të jashtëm, në mënyrë që komentet dhe mendimet e tyre të mund t'i ndihmojnë këto të fundit për të përmirësuar punën e tyre në të ardhmen.

- Propozimet e vlerësuesve për përmirësimin e metodologjisë apo ndryshimin e kuadrit ligjor në fuqi.

Dokumente shtesë:

- Listat e kontrollit që përdoren për vëzhgimet: për ambientet dhe infrastrukturën e mësimdhënies, procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve.
- Formularët e intervistave/pyetësorëve për grupet kryesore të interesit (nxënës, mësues, përfaqësues të biznesit).

#### *4.2. Modulet e trajnimeve dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZHVP) të vlerësuesve të jashtëm – Serbi*

Autorë: Jasmina Đelić, Gordana Čaprić

Në Serbi, programi i trajnimit për vlerësuesit e jashtëm synon trajnimin e konsulentëve arsimorë të punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe të punonjësve të Institutit për Cilësinë dhe Vlerësimin e Arsimit (ICVA) për kryerjen e vlerësimit të cilësisë së punës së institucioneve arsimore.

Programi duhet të krijojë mundësi për zbatimin e procedurave sistematike dhe uniforme për vlerësimin e institucioneve arsimore. Duke trajtuar tematikën përkatëse, simulimin dhe performancën praktike në shkollë nën mbikëqyrjen e trajnerëve, programi kontribuon në punën për përmirësimin e njohurive në fushën e vlerësimit të ofertës arsimore dhe zhvillon aftësi që kontribuojnë në vlerësimin sa më objektiv të institucioneve arsimore.

Programi i trajnimit të zhvillimit profesional përbëhet nga katër module, me një kohëzgjatje totale prej dhjetë ditësh.

**Moduli i parë**, i zhvilluar për një periudhë dyditore, trajton metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së punës së institucioneve përmes temave të mëposhtme: Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së punës së institucioneve; Lidhja ndërmjet vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm; Korniza kombëtare për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së punës së institucioneve; Burimet e të dhënave për vlerësimin e shkallës së arritjes së standardeve të cilësisë së punës së institucioneve; Standardet, treguesit, nivelet e arritjeve dhe burimet e të dhënave për vlerësimin e cilësisë së fushave të mësimdhënies dhe të nxënit; Përgatitjet për vëzhgimin e orës së mësimin dhe vëzhgimet e orës së mësimin të regjistruara në DVD.

**Moduli i dytë**, i zhvilluar për një periudhë treditore, fokusohet në vlerësimin e mësimdhënies dhe të nxënit. Ai trajton temat e mëposhtme: Vërejtjet për orët e ndjekura – analiza e detyrave të shtëpisë; Përdorimi i të dhënave të grumbulluara gjatë vëzhgimeve të orëve të mësimin në kuadrin e vlerësimit të jashtëm të punës së shkollave; Ndarja e komenteve/vërejtjeve përkatëse me mësuesit pas vëzhgimeve të orës së mësimin; Ndarja e komenteve/vërejtjeve për orët e vëzhguara të mësimin me organet drejtuese të institucionit; Përgatitjet për vëzhgimin e orëve të mësimin; Vëzhgimet e orëve të mësimin në shkollë (gjendja aktuale); Diskutim për orët e vëzhguara të mësimin dhe dhënia e komenteve/vërejtjeve përkatëse për organet drejtuese të shkollës; Reflektim dhe përmbledhje e rezultateve të cilësisë së orëve të vëzhguara të mësimin; Analizimi dhe përdorimi i të dhënave sasiore për orët e vëzhguara të mësimin; Shkrimi/përpilimi i raporteve për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit në shkollë.

**Moduli i tretë**, i zhvilluar për një periudhë dyditore, synon zhvillimin e kompetencave të pjesëmarrësve në lidhje me triangulimin e provave/të dhënave. Temat e trajtuara në kuadër të këtij moduli janë: Aspekte të vizitës në institucion; Organizimi i vlerësimit të jashtëm dhe puna në grup; Intervistimi dhe vëzhgimi; Përdorimi i rezultateve bazuar në të dhënat e mbledhura dhe përgatitja e raportit për shkollën.

Në kuadër të modulit të fundit, moduli i katërt, i zhvilluar për një periudhë treditore, ofrohet trajnim për përgatitjen dhe zbatimin e procesit të vlerësimit, ku trajtohen temat e mëposhtme: Të dhënat për cilësinë të pasqyruara në dokumentet shkollore - përgatitja për vizitën në shkollë; Përgatitja e menjëhershme për

vëzhgimin e orës së mësimi dhe planifikimi i tij; Përgatitja e pyetjeve për zhvillimin e intervistave me aktorë të ndryshëm në shkollë; Përgatitja e komenteve/vërejtjeve për mësuesin dhe organet drejtuese të shkollës; Zbatimi i vlerësimit të jashtëm në shkollë - zbatimi praktik në shkolla; Përmbledhja dhe shkëmbimi i përvojave për vlerësimin e jashtëm; Zhvillimi i aftësive për shkrimin e raporteve në lidhje me rezultatet e vlerësimit të jashtëm; Shkrimi/përpilimi i një raporti përmbledhës për cilësinë e punës së institucionit arsimor.

Programi i trajnimit përfshin punën aktive dhe verifikimin e nivelit të përvetësimit të materialit përmes zhvillimit të detyrave të shtëpisë, analizimit të situatave, diskutimeve dhe testeve praktike në institucionet arsimore.

Programi është përshtatur në përputhje me nevojat e pjesëmarrësve dhe ndihma e "miqve kritikë" (mësuesit e shkollës) përdoret si një mbështetje e rëndësishme, pasi ato japin sugjerime për përmirësimin e përmbajtjes së temave, aktiviteteve dhe materialeve që përdoren në procesin mësimor edhe pas trajnimit.

Trajnimi pasohet nga procesi i verifikimit të nivelit të përvetësimit të programit, pas të cilit pjesëmarrësi merr një certifikatë si dëshmi e kompetencës për të kryer punën e vlerësuesit të jashtëm të një institucioni arsimor.

Pas trajnimit, vlerësuesit e jashtëm janë të detyruar të vazhdojnë të angazhohen për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre përmes pjesëmarrjes në konsultime të veçanta të organizuara dy herë në vit, kushtuar temave nga fusha e vlerësimit të institucioneve arsimore. Vlerësuesit e jashtëm ndjekin edhe seminare/uebinare të organizuara nga Konferenca e Përhershme Ndërkombëtare e Inspektorateve (SICI) dhe janë të detyruar që ta përcjellin informacionin dhe njohuritë e tjera të dobishme për përvojat e vlerësimit në vendet evropiane tek kolegët e tyre.

Burime dhe linqe të dobishme:

- [RULEBOOK on examination and professional development of educational advisors "Official Gazette of the RS", No. 14/20, 141/22](#) (Serbi)
- [SICI – The Standing International Conference of Inspectorates](#)

### 4.3. Trajnimet dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i vlerësuesve të jashtëm dhe përmbajtja e tyre – Moldavi

Autorë: Tamara Tonu, Sergiu Orehovschi, Elena Petrov

#### Konteksti

Agjencia Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsim dhe Kërkim (AKSCAK) i kryen detyrat e saj për sigurimin e cilësisë në arsimin e përgjithshëm nëpërmjet vlerësimit të jashtëm të institucioneve dhe të stafit drejtues.

Faktori kryesor në procesin e vlerësimit të jashtëm janë vlerësuesit e jashtëm - punonjës të Departamentit të Vlerësimit të Arsimit të Përgjithshëm në AKSCAK, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Kërkimit, përfaqësues të organeve të specializuara vendore në fushën e arsimit, stafi drejtues/mësimdhënës i arsimit të përgjithshëm, specialistë me reputacion të arsimit të përgjithshëm, të cilët marrin pjesë në misionet për vlerësimin e jashtëm të cilësisë të organizuara nga AKSCAK.

Për të garantuar efikasitetin e procesit të vlerësimit dhe për të promovuar kulturën e cilësisë, AKSCAK ka përgatitur Metodologjinë e trajnimit të ekspertëve vlerësues të Agjencisë Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë në Arsim dhe Kërkim ([Methodology for training the expert evaluators of the National Agency for Quality Assurance in Education and Research](#)) (në tekstin e mëtejshëm referuar si Metodologjia), e cila identifikon të gjitha aspektet normative, organizative dhe metodologjike të procesit të trajnimit të ekspertëve vlerësues; përcakton format/nivelet/llojet/fazat e trajnimit të ekspertëve vlerësues dhe objektivat e tyre; përcakton njësitë minimale të përmbajtjes dhe objektivat e sesioneve të trajnimit të ekspertëve vlerësues.

Sipas kësaj Metodologjie, trajnimi i ekspertëve vlerësues synon zhvillimin dhe garantimin e kompetencave të nevojshme për ekspertët e jashtëm për të promovuar objektivitetin dhe konsistencën e vendimeve të Agjencisë në fushën e sigurimit të jashtëm të cilësisë në institucionet e të gjitha niveleve arsimore. Trajnimi i ekspertëve vlerësues kryhet përmes sesioneve të trajnimit, të cilat organizohen nga Agjencia në mënyrë priodike. Kalendarit i sesioneve të trajnimit për ekspertët vlerësues përcaktohet sipas nevojave të Agjencisë.

#### Nisja e kursit të trajnimit

AKSCAK ka zhvilluar dy kurrikula për një kurs trajnimi të quajtur "Vlerësimi i cilësisë në arsimin e përgjithshëm", i cili përfshin dy komponentë: vlerësimin e institucioneve dhe vlerësimin e stafit drejtues. Këtu vlen të theksohet se, megjithëse janë miratuar dy metodologji vlerësimi bazuar në dy lloje të ndryshme standardesh, të dy proceset kryhen njëkohësisht. Për të siguruar cilësinë e procesit të përgatitjes dhe realizimit të trajnimit, trajneri bën një vlerësim paraprak të fazave të procesit bazuar në listën përkatëse të kontrollit.

**Objektivi i kursit:** Zhvillimi i aftësive të nevojshme për vetëvlerësimin/vlerësimin e jashtëm të procesit arsimor, bazuar në standardet e miratuara në nivel kombëtar, në kuadër të punës për garantimin e arsimit cilësor për çdo nxënës.

#### Karakteristikat e kursit:

Lloji	Program modular
Kategoritë e përfituesve	Ekspertët vlerësues, stafi drejtues/mësimdhënës, specialistët nga organet e specializuara vendore në fushën e arsimit
Kohëzgjatja e programit/ numri i krediteve	90 orë/ 3 kredite
Format e trajnimit	Frontal, në ekip, individual, i pavarur
Format e vlerësimit	Vetëvlerësimi, vlerësimi i vazhduar, vlerësimi përfundimtar

### **Përmbajtja e kurrikulës**

Koncepti didaktik i sesioneve të trajnimit lidhet me objektivat e parashikuara mësimore dhe përmbajtjet e përcaktuara në Shtojcën nr. 4 të Metodologjisë së lartpërmendur. Në veçanti:

- Standardet normative në lidhje me vlerësimin e cilësisë në arsimin e përgjithshëm;
- Përcaktimi dhe qasja komplekse ndaj konceptit të cilësisë në arsim (4 komponentë të cilësisë: planifikimi, monitorimi, vlerësimi, përmirësimi);
- Mënyra e organizimit dhe menaxhimit të procesit të vetëvlerësimit/vlerësimit;
- Standardet: struktura dhe përmbajtja (dimensioni/fusha, standardi, treguesi);
- Kriteret e vlerësimit: shkalla e vlerësimit me 5 nivele;
- Aplikimi i instrumenteve të vlerësimit;
- Struktura e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm;
- Ushtrim praktik për treguesit: identifikimi i të dhënave, formulimi i gjetjeve, konkluzioneve: pikat e forta, pikat e dobëta;
- Formulimi i fushave të përmirësimit dhe i rekomandimeve;
- Promovimi i kulturës së cilësisë në arsimin e përgjithshëm.

### **Veçoritë e organizimit/zhvillimit**

Kursi i trajnimit është i akredituar dhe zakonisht moderohet nga dy trajnerë. Ai përfshin përmbajtje kurrikulare që synojnë si njohjen e akteve normative për vlerësimin e jashtëm në arsimin e përgjithshëm, ashtu edhe veçoritë e përdorimit të instrumenteve të vlerësimit me aplikim ndërveprues. Njësitë e përmbajtjes përzgjidhen nga organizatorët e trajnimit sipas objektivave të sesionit dhe kategorisë së pjesëmarrësve. Për shkak të konceptimit të tij gjatë periudhës së pandemisë, kursi zhvillohet në format online (*Google Meet, Google Classroom, Google Drive, etj.*).

Veprimtaritë mësimore dhe vlerësuese në këtë kurs zhvillohen në mënyrë sinkrone dhe asinkrone. Katër seancat sinkrone të mbajtura në *Google Meet* (ose në çdo platformë tjetër) sigurojnë lidhjen ndërmjet trajnerëve dhe të trajnuarve, ofrojnë mundësinë e dialogut, drejtimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve. Aktivitetet asinkrone kërkojnë që kursantët të studiojnë individualisht, të kryejnë detyrat e shtëpisë të propozuara nga moderatorët. Arkivimi i detyrave të zgjidhura bëhet në platformën *Google Classroom*, ku trajneri hedh materialet mbështetëse për lëndën, detyrat, cakton pikët, bën komente/vërejtje për pjesëmarrësit e kursit. Kursantët që kanë ndjekur të gjitha seancat sinkrone, kanë

përfunduar detyrat individuale dhe kanë grumbulluar të paktën 50% të pikëve totale, konsiderohen se e kanë kaluar kursin. Ato pajisen me një certifikatë ku tregohet edhe numri i orëve/krediteve të fituara. Më vonë ata, duke përfshirë edhe drejtuesit që kanë përfunduar kursin dhe janë vlerësuar, mund të bëhen anëtarë të komisioneve të vlerësimit të jashtëm.

Dokument shtesë:

[The Methodology for training the expert evaluators of the National Agency for Quality Assurance in Education and Research](#)



Agencia Națională de Asigurare a Calității  
în Educație și Cercetare




# EVALUAREA CALITĂȚII ÎN ÎNVĂȚĂMÂNTUL GENERAL

**Procesul de evaluare a instituțiilor de învățământ general**

Curs de formare continuă

**11 februarie 2022**



## 5. Pavarësia e vlerësimit të jashtëm

### 5.1. Pavarësia e vlerësimit të jashtëm dhe besueshmëria e gjykimeve – Shqipëri

Autorë: Etleva Kaçuli, Sara Hoxhallari

**Qëllimi:** Procedurat dhe rregullat e Agjencisë Kombëtare Shqiptare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) të listuara më poshtë hartohen në funksion të procesit të akreditimit për të garantuar besueshmërinë e rezultateve përfundimtare, duke njohur në të njëjtën kohë pavarësinë e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Në sistemin e AFP-së, procesi i vlerësimit të jashtëm është i pavarur dhe ka një besueshmëri të lartë gjykimi, për shkak të hapave dhe mekanizmave të krijuar për të garantuar dhe mbrojtur këtë proces.

Procesi i akreditimit për ofruesit e AFP-së kryhet nga një grup vlerësuesish të jashtëm, të cilët janë të pavarur dhe të përzgjedhur përmes një procesi transparent dhe të besueshëm.

- Institucioni ofrues i AFP-së njihet me grupin e vlerësuesve të jashtëm, pasi ka marrë informacion paraprakisht për përbërjen e grupit të vlerësuesve, të cilin duhet ta miratojnë ose refuzojnë mbi baza ligjore brenda një afati të caktuar.
- Raporti i akreditimit kalon në 3 faza: Grupi i vlerësuesve të jashtëm harton raportin bazuar në provat dhe gjykimin e tyre - AKAFPK koordinon dhe ndihmon procesin<sup>19</sup> - AKAFPK ia përcjell raportin për

<sup>19</sup> AKAFPK është filtri i dytë që shqyrton raportin e vlerësimit për të parë nëse ka deklarata të pavërteta ose nëse gjykimi i vlerësuesve të jashtëm duket i plotë për syrin e një pale të tretë. Nëse nuk jemi në gjendje të kuptojmë siç duhet vlerësimin e

vendimmarrje MFE-së (Ministria e Financave dhe Ekonomisë). Tre hallkat në këtë proces garantojnë besueshmërinë e procesit të akreditimit.<sup>20</sup>

- Është krijuar hapësira që institucioni të ketë mundësi të shprehë mendimin dhe qëndrimin e tij:
  - Procedurat ligjore parashikojnë që institucioni të ketë hapësirën për t'u njohur me raportin e vlerësimit të jashtëm dhe për të bërë komentet që konsiderohen të nevojshme (bazuar në të dhëna dhe arsyetime ligjore).
  - Në rast mosdakordimi me vendimin për statusin e akreditimit, institucioni ka të drejtë të nisë një proces ankimi në gjykatë.

Besueshmëria e gjyqimit është e lartë sepse:

- Vlerësuesit e jashtëm janë të certifikuar posaçërisht për këto procese. Si rezultat, ata kanë kompetencën dhe të gjitha njohuritë e nevojshme për të hartuar një raport të paanshëm për procesin e akreditimit.<sup>21</sup>
- Vlerësuesit e jashtëm nënshkruajnë kontratat e konformitetit në fillim të një procesi dhe mbajnë përgjegjësi për detyrimet e tyre ndaj procesit, si dhe të drejtat e tyre.
- Vlerësuesit e jashtëm nënshkruajnë deklaratën për parandalimin e konfliktit të interesit. Kjo deklaratë bën të mundur shmangien e interesave të vlerësuesve në këtë proces dhe garanton një arsyetim të drejtë dhe të besueshëm.
- Vlerësuesit e jashtëm nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit.
- Vlerësuesit e jashtëm njihen me “Rregullat e sjelljes dhe etikës profesionale të vlerësuesve të jashtëm në procesin e akreditimit të institucioneve ofruese të AFP-së”, ku një pjesë e rëndësishme përbërëse përfshin parimet bazë si:
  - Sundimi i ligjit, qytetaria dhe respekti

---

kritereve, kemi nevojë për informacion, shpjegime dhe prova të mëtijshme nëse gjykimi është i diskutueshëm. Si rezultat, ne sigurohemi që raporti të ketë kuptim për një palë të tretë kur ta lexojë dhe që nuk do të sinjalizojë ekzistencën e ndonjë problematike të mundshme.

<sup>20</sup> Ministria e Financave dhe Ekonomisë është filtri i tretë që shqyrton raportin e vlerësimit. Pas kësaj, ata vendosin nëse do të pranojnë propozimin nga vlerësuesit e jashtëm dhe AKAFPK për akreditim të plotë, akreditim me kusht ose mosakreditim.

<sup>21</sup> Për të garantuar që vlerësuesit tanë të jashtëm nuk kanë ndonjë interes personal me ofruesin e AFP-së dhe se vendimi i tyre për statusin e akreditimit nuk do të ndikohet nga interesat personale, ata nënshkruajnë një deklaratë ku shprehen për mungesën e konfliktit të interesit me AKAFPK-në dhe ofruesin e AFP-së. Pasi emrat e vlerësuesve të jashtëm janë bërë publikë dhe janë përzgjedhur nga një komision, ne kërkojmë edhe pëlqimin e ofruesit të AFP-së.

Grupi i vlerësuesve të jashtëm shoqërohet nga një përfaqësues nga ofruesi i AFP-së gjatë vizitës në terren, në mënyrë që ata të jenë të informuar për veprimet e tyre (provat që kanë mbledhur, klasat që kanë vizituar, etj.).

Pas përfundimit të versionit përfundimtar të raportit të tyre, ne u kërkojmë të mbledhin dokumentacionin mbështetës dhe të bëjnë bashkë grupin dhe koordinatorin e AKAFPK-së, në mënyrë që të miratojnë konkluzionet e raportit dhe pretendimet e tij, si edhe dokumentacionin mbështetës që ai përmban. Kur ata nënshkruajnë raportin dhe dokumentet mbështetëse, përfshirja e tyre është e plotë.

Ata mbajnë përgjegjësi të plotë për besueshmërinë e procesit që në momentin e nënshkrimit të tij dhe janë përgjegjës përpara gjykatës administrative në rast mospërputhjeje.

- Profesionalizmi
- Objektiviteti dhe paanshmëria/pavarësia
- Integriteti

**Dokumente shtesë:**

Shtojca 1. Përzgjedhja, organizimi dhe procedurat e etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm në procesin e akreditimit të ofruesve të AFP-së.

Shtojca 2. Rregullat e sjelljes dhe etikës profesionale.

## *5.2. Pavarësia e vlerësimit të jashtëm – Maqedonia e Veriut*

Autorë: Antonela Stojanoska, Valentina Gocevska, Ardijana Isahi Palloshi

Vlerësimi i jashtëm (integral) bëhet nga një institucion i pavarur (Inspektorati Shtetëror i Arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut). Gjatë procesit të vlerësimit, vlerësuesit janë të pavarur dhe autonom në punën e tyre për marrjen e vendimeve dhe miratimin e akteve.

Vlerësimi kryhet nga persona të licencuar (inspektorë), të cilët në procesin e vlerësimit përdorin instrumente të standardizuara që ndihmojnë në procesin e vlerësimit të jashtëm, me qëllim që inspektorët të jenë të unifikuar në punën e tyre. Instrumentet (pyetësorët, udhëzimet, pyetjet e intervistave me fokus grupet, etj.) përdoren në të gjitha fazat (faza përgatitore, faza e zbatimit, faza e raportimit dhe faza e kontrollit) gjatë kryerjes së vlerësimit të jashtëm.

Përmbledhja dhe vlerësimi për secilën shkollë është mesatarja e vlerësimeve të bëra nga vlerësuesit gjatë procesit.

## 6. Reagimet/mendimet nga shkollat për përmirësimin e vlerësimit të jashtëm

### 6.1 Reagimet/mendimet nga shkollat për përmirësimin e vlerësimit të jashtëm - Serbi

Autorë: Vesna Šaponjić, Jasmina Đelić, Gordana Čaprić

Rregullorja për Vlerësimin e Cilësisë së Institucioneve garanton detyrimin e vlerësuesve të jashtëm që të kujdesen dhe të fokusohen në cilësinë e vlerësimit të jashtëm. Të gjithë pjesëmarrësit në procesin e vlerësimit të jashtëm të shkollës janë të detyruar të plotësojnë formularin e vlerësimit për të garantuar cilësinë e këtij vlerësimi. Pjesëmarrësit nga shkolla duhet të japin mendime/vërejtje objektive për ekspertizën dhe paanshmërinë e vlerësuesve gjatë procesit.

Pas monitorimit të orës së mësimin, çdo mësues, ora e të cilit i nënshtrohet monitorimit, duhet të plotësojë pyetësin për pjesëmarrësit në vlerësimin e jashtëm pas vëzhgimit të orës së mësimin (Shtojca 1). Vlerësimi i jashtëm duhet të shpjegojë qëllimin e pyetësit dhe të theksojë parimin e anonimitetit.

Përgjigjet nga pyetësi ofrojnë informacion për vlerësuesit në lidhje me aspekte të ndryshme të punës së tyre gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm. Konkretisht, ndër temat e tjera, ky informacion ka të bëjë me paanshmërinë, rëndësinë e reagimeve/vërejtjeve dhe komunikimin. Edhe mësuesit vlerësojnë se deri në çfarë mase janë gjetjet nga vlerësimi i jashtëm në përputhje me vetëvlerësimin e tyre për mësimdhënien e tyre. Mësuesit kanë mundësinë të shpjegojnë përgjigjet e tyre në detaje. Pas përfundimit, pyetësit duhet t'i dorëzohen koordinatorit të vlerësimit, përfaqësues i shkollës.

Punonjësit e shkollës mund të shprehin mendimin e tyre edhe nëpërmjet një mundësie tjetër. Këtu bëhet fjalë për takimin gjatë të cilit ekipi i vlerësimit të jashtëm prezanton gjetjet paraprake në lidhje me cilësinë e punës në shkollë para të gjithë punonjësve të shkollës. Të gjithë ata që marrin pjesë në këtë takim plotësojnë në mënyrë anonime pyetësin përkatës për përfaqësuesit e shkollës (Shtojca 2).

Kjo analizë i ndihmon vlerësuesit e jashtëm për të kuptuar për sa vijon:

- Nëse kanë demonstruar njohjen e mirë të dokumentacionit shkollor dhe të karakteristikave specifike të shkollës.
- Nëse kanë garantuar komunikimin e mirë dhe besimin tek pjesëmarrësit.
- Nëse kanë marrë në konsideratë opinionet e ndryshme dhe u kanë dhënë mundësi pjesëmarrësve të shprehin mendimet e tyre.
- Nëse kanë garantuar njohjen më të mirë të standardeve të cilësisë dhe treguesve të cilësisë së punës në shkollë nga pjesëmarrësit.

Të dy pyetësit i nënshtrohen analizimit nga ekipi i vlerësimit të jashtëm. Nëse disa nga aspektet e punës së tyre janë vlerësuar negativisht nga pjesëmarrësit në proces, vlerësuesit e jashtëm duhet të rekomandojnë zbatimin e strategjive për përmirësim, gjë që arrihet kryesisht gjatë trajnimit të vlerësuesve, në përputhje me dispozitat e Rregullores për provimet dhe formimin profesional të konsulentëve arsimorë.

Dokumente shtesë:

- [Rulebook of quality evaluation of institutions](#) (në serbisht)
- [Rulebook on exams and professional training of educational advisors](#) (në serbisht)

- Shtojca 1: Pyetësor për pjesëmarrësit në vlerësimin e jashtëm pas monitorimit të orës së mësimi.
- Shtojca 2: Pyetësor për marrjen e mendimeve nga përfaqësuesit e shkollave.

## *6.2. Reagimet/mendimet e shkollave pas inspektimit dhe si përdoren ato më tej – Holandë*

Autor: Herman Franssen

Inspektorati Hollandez i Arsimit vlerëson periodikisht punën mbikëqyrëse/inspektuese të punonjësve të saj. Me anketat e brendshme dhe të jashtme, ata përcaktojnë se çfarë po shkon mirë dhe çfarë mund të përmirësohet në punën për zbatimin e tij.

Për të zhvilluar më tej mbikëqyrjen dhe për ta bërë atë sa më efektiv që të jetë e mundur, është gjithmonë e rëndësishme të dihet se çfarë mendojnë bordet e shkollave dhe shkollat vetë për inspektimet. Inspektorati e monitoron këtë - ndër të tjera - duke kërkuar nga shkollat dhe bordet të plotësojnë një pyetësor online pas vizitave inspektuese. Kjo bën të mundur marrjen e vlerësimit në lidhje me mbikëqyrjen e kryer si dhe rregullimin e disa aspekteve të saj, nëse është e nevojshme.

Pas çdo lloj inspektimi të shkollës (inspektimi katërvjeçar, inspektimi me bazë riskun dhe inspektimi tematik), mbikëqyrësit dhe drejtuesit e shkollave marrin një pyetësor online nëpërmjet të cilit inspektorati kërkon marrjen e mendimeve/vërejtjeve për inspektimin e kryer. Nëpërmjet kësaj mase, ne arrijmë të identifikojmë se çfarë po shkon mirë dhe ku ka vend për përmirësim.

Pyetësorët individualë janë të lidhur me inspektorin përgjegjës për inspektimin në fjalë. Kjo shërben për informimin e inspektorëve dhe ekipeve të inspektimit në lidhje me mendimin e bordeve dhe të shkollave për inspektimet e kryera nga ata. Përveç kësaj, ekipet e inspektimit diskutojnë periodikisht në lidhje me rezultatet e anketës për matjen e nivelit të kënaqësisë dhe rezultatet e përgjithshme eksplorojnë më tej në diskutimet me aktorët në terren, nëse është e nevojshme. Këto reagime/mendime përdoren edhe për zhvillimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes sonë.

Bazuar në pyetësorët në fjalë, përgatitet një raport i përgjithshëm ku prezantohen edhe konkluzionet e punës (Shtojca në holandisht).

Pyetjet për marrjen e mendimit të palës së mbikëqyrur mbulojnë temat e mëposhtme. Çdo pyetje kërkon që shkolla të japë një mendim:

Nuk pajtohem plotësisht - Nuk pajtohem - Pajtohem - Pajtohem plotësisht - Nuk e di.

### **Komunikimi dhe planifikimi**

Shembull:

- Pas marrjes së njoftimit, koha në dispozicion për të gjithë pjesëmarrësit për t'u përgatitur për inspektimin ishte e mjaftueshme.

### **Procesi i inspektimit në shkollë**

Shembuj:

- Inspektorët na dhanë hapësirë për të demonstruar mënyrën se si ne e sigurojmë dhe promovojmë cilësinë në shkollën tonë.
- Inspektorët ishin mendjehapur.
- Inspektorët arritën të krijojnë një tablo të plotë dhe të qartë në lidhje me shkollën për sa i përket standardeve mbi bazën e të cilave u inspektuan.

### **Reagimet/mendimet pas inspektimit**

Shembull:

- Reagimi na u duk stimulues.

### **Raporti**

Shembull:

- Konkluzionet dhe gjykimet janë të mirëdokumentuara në raport.

### **Rezultati i inspektimit për shkollën**

Shembull:

- Inspektimi shërben si pikënisje për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shkollës sonë.

### **Vlerësimi i përgjithshëm**

Shembull:

- Çfarë sugjerimesh keni në lidhje me përmirësimin e punës së inspektoratit? A keni ndonjë koment dhe/ose mendim tjetër për ne?

### **Shtojca:**

- Pyetësor për Bordin e Shkollës (në holandisht).
- Pyetësor për drejtorin (në holandisht).

### *6.3. Reagimet/mendimet nga shkollat dhe nga vlerësuesit përmes pyetësorëve online – Portugali*

Autorë: Isabel Barata dhe Rosa Micaelo

Në Portugali, në fund të procesit të vlerësimit të jashtëm, Inspektorati kërkon nga vlerësuesit dhe drejtorët e shkollave të vlerësuara që të bëjnë vlerësimin e procesit duke iu përgjigjur pyetësorëve online.

Përgjigjet trajtohen në strukturat e brendshme dhe rezultatet shpalosen në raportet e përgjithshme vjetore të vlerësimit të jashtëm të shkollave, të miratuara nga Ministri i Arsimit dhe të publikuara në faqen e Inspektoratit. Ato përdoren për të identifikuar ato elemente të punës që kanë funksionuar siç duhet dhe ato që mund të përmirësohen, trajtohen apo të sqarohen gjatë seancave të trajnimit.

Pyetjet që i drejtohen drejtorëve të shkollave fokusohen në faza të ndryshme të procesit të vlerësimit të jashtëm, duke trajtuar tema të tilla si:

- 1) Informacioni në dispozicion në faqen e internetit të Inspektoratit;
- 2) Kontaktet ndërmjet Inspektoratit dhe shkollave;
- 3) Zhvillimi i pyetësorëve për nivelin e kënaqësisë së komunitetit arsimor;
- 4) Vëzhgimi në klasë (për shembull, zgjedhja e klasës mbulonte nivele arsimimi dhe lëndë të ndryshme; fokusi i vëzhgimit; mësuesit e pranuan me lehtësi vëzhgimin e orës së mësimit; vëzhgimet e orëve të mësimit u zhvilluan në një atmosferë të qetë);
- 5) Intervistat (intervistat u zhvilluan në një atmosferë miqësore; menaxhimi i kohës ishte i përshtatshëm; të gjithë anëtarëve të secilit grup të të intervistuarve iu dha mundësia të merrnin pjesë; konsideratat fillestare rreth vlerësimit të jashtëm u prezantuan gjatë intervistës me drejtorin dhe ekipin e tij);
- 6) Ekipi i vlerësimit (planifikimi dhe organizimi, marrëdhënia e ekipit vlerësues me bashkëbiseduesit e tyre);
- 7) Raporti i vlerësimit të jashtëm (struktura, përshtatshmëria e tekstit për lexues të ndryshëm, arsyetimi i vlerësimeve dhe relevanca e vlerësimeve);
- 8) Kontributet e procesit të vlerësimit të jashtëm në përmirësimin e shkollës (nxitja e reflektimit të brendshëm; rritja e angazhimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit; rritja e ndërgjegjësimit të shkollës; stimulimi i procesit për përmirësimin e shkollës).

Pyetësi përfshin pyetje të posaçme edhe për shkollat që kanë ushtruar të drejtën e tyre për të shprehur mosdakordësinë e tyre. Këto pyetje kanë të bëjnë me kohën e caktuar për përpilimin e raportit dhe përgjigjen e dhënë nga grupi vlerësues.

Lidhur me pyetësorët e përdorur për vlerësuesit, ku përfshihen inspektorë dhe ekspertë të jashtëm (mësues dhe studiues nga institucionet e arsimit të lartë), pyetjet trajtojnë temat e mëposhtme:

- 1) Përgatitja për vlerësimin e jashtëm (trajnimi i vlerësuesve, informacioni dokumentar dhe statistikor për shkollën që vihet në dispozicion të ekipit të vlerësimit, takimi përgatitor, vëzhgimi në klasë);
- 2) Vizita kryesore (intervistat, takimet e ekipit vlerësues të përfshira në agjenda);
- 3) Raporti (karakteristikat dhe procesi i rishikimit);
- 4) Ekipi i vlerësimit (numri i anëtarëve, roli i koordinatorit, koordinimi dhe ndërveprimi ndërmjet anëtarëve të ekipit).

## 7. Mbikëqyrja e vlerësimit të jashtëm

### 7.1. "Praktikoni atë që predikoni" - Vlerësimi i inspektoratit përmes auditimeve të jashtme dhe të brendshme - Holandë

Autor: Herman Franssen

Për inspektoratin holandez është e rëndësishme që një organizatë e pavarur të vlerësojë procedurat dhe cilësinë e punës së saj: "Praktikoni atë që predikoni". Kjo është arsyeja përse inspektimi vlerësohet në bazë të një standardi ndërkombëtar për sistemet e cilësisë: standardi ISO 9001. Organizmi certifikues që vlerëson punën e inspektoratit holandez quhet *Certifikimi EIK*.

Një cikël certifikimi fillon gjithmonë me auditimin e certifikimit, gjatë të cilit organizata vlerësohet mbi bazën e të gjitha standardeve ISO. Organizata certifikohet nëse rezultati i vlerësimit është pozitiv; certifikata është e vlefshme për një periudhë trevjeçare. Në vitet e ndërmjetme, organizmi certifikues kryen të ashtuquajturat vlerësime kontrolli. Këto janë auditime gjatë të cilave vlerësohet një pjesë e organizatës mbi bazën e vetëm një pjese të standardit ISO. Gjatë periudhës trevjeçare të certifikimit, auditohen të gjitha njësitë organizative dhe të gjithë kapitujt e standardit ISO 9001. Ndër shembujt e fushave që vlerësohen mund të përmendim: konteksti organizativ, udhëheqja, planifikimi, mbështetja, vlerësimi i performancës dhe përmirësimi.

Pas tre vjetësh, rinis puna për të ashtuquajturin auditim i ricertifikimit, gjatë të cilit rifillon puna për zbatimin e ciklit të plotë. Edhe auditimi i certifikimit ose vlerësimi i kontrolli mund të jenë negativ ose më pak pozitiv. Ky është rasti i konstatimit të devijimeve krahasuar me standardin ISO. Për devijimet kritike, organizatat duhet të bëjnë përmirësime konkrete dhe të prekshme brenda tre muajve. Në rast të devijimeve jo kritike, organizatave u jepet mundësia të përmirësohen brenda një viti.

Përveç auditimeve të jashtme, inspektorati holandez kryen edhe auditime të brendshme. Këto të fundit kanë funksione të ndryshme. Funksioni i parë: auditimi i brendshëm fokusohet kryesisht te sistemi, standardizimi, kontrolli dhe konformiteti: nëse inspektimi i plotëson kërkesat e standardit ISO 9001. Funksioni i dytë i auditimit të brendshëm lidhet me kontributin e tij për nxitjen e diskutimit profesional brenda organizatës dhe në të ashtuquajturën cilësi dinamike. Tipari kryesor i cilësisë dinamike është përmirësimi/zhvillimi i vazhdueshëm përmes bashkëpunimit dhe diskutimit profesional me kolegët.

Ky lloj auditimi filloi të përdorej për herë të parë në inspektoratin holandez në vitin 2020, gjatë të cilit të audituarit përfshihen aktivisht në procesin e reflektimit për të kuptuar çfarë shkon mirë dhe çfarë mund të përmirësohet në proceset e punës. Ky quhet *Brown Paper Audit* (BPA). Në këtë formë auditimi, të audituarit dhe audituesit punojnë së bashku për përmirësimin e proceseve. Më shumë se kurrë, ky lloj auditimi është një instrument që shërben për përmirësimin e vazhdueshëm nëpërmjet aktiviteteve të tilla si: reflektimi së bashku në lidhje me mundësitë për përmirësimin e procesit të punës, formulimi i masave për përmirësimin që të jenë mundësisht brenda sferës së influencës dhe monitorimi dhe ndjekja e mëtejshme e punës.

*Brown Paper Audit* (BPA) është një metodë e lehtë për t'u zbatuar brenda ciklit ekzistues të auditimit. Në qasjen tradicionale ndaj auditimeve të brendshme, intervistat (shpesh kokë më kokë) kryhen për të vlerësuar metodat e punës të dakorduara brenda organizatës. Gjatë BPA-së, ne punojmë në grupe për arritjen e rezultateve. Pika fillestare për BPA-në është një proces i punës i zgjedhur për auditim. Grupi

vlërëson procesin e përzgjedhur sipas një qasjeje të strukturuar: si funksionon procesi në praktikë, çfarë po shkon mirë, çfarë mund të përmirësohet, çfarë masash duhen marrë. BPA ndihmon në përmirësimin e bashkëpunimit, parandalimin e humbjeve dhe rritjen e vlerës, veçanërisht kur bëhet fjalë për procedurat ose proceset ku janë përfshirë aktorë të shumtë.

## 8. Vlerësimi nga kolegët

### 8.1. Vizitat e kolegëve në kontekstin e forumit të ETF-së për Sigurimin e Cilësisë

Autor: Mounir Baati

#### Konteksti

Në vitin 2017, Fondacioni Evropian i Trajnimit krijoi Forumin për Sigurimin e Cilësisë në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional. Ky Forum është një iniciativë bashkëpunimi transkombëtare ndërmjet institucioneve kombëtare përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së AFP-së në vendet partnere të përzgjedhura të ETF-së, që synon të mbështesë përpjekjet kombëtare për sigurimin e cilësisë në punën për promovimin e AFP-së, nëpërmjet identifikimit dhe shkëmbimit të ekspertizës, metodave dhe instrumenteve të sigurimit të cilësisë.

Vizitat e kolegëve janë një nga mjetet kryesore të punës së këtij forumi.

#### Koncepti i vizitës së kolegëve

Vizita e kolegëve është një formë e vlerësimit të jashtëm nga kolegët. Një grup i jashtëm ekspertësh kolegë, i zgjedhur nga institucioni anëtar i Forumit pritës, ftohet për të vlerësuar dhe shprehur mendimin e tij në lidhje me masat e marra për sigurimin e cilësisë.

Vizitat e kolegëve zhvillohen në një vend anëtar të Forumit të ETF-së për Sigurimin e Cilësisë në AFP, i përfaqësuar nga një institucion anëtar i Forumit. Institucioni anëtar, që merr rolin e pritësit, ka rastin të:

- ☐ vetëvlerësojë në mënyrë analitike masën e përzgjedhur për sigurimin e cilësisë;
- ☐ reflektojë në lidhje me pikat e forta dhe të dobëta të masës së përzgjedhur për sigurimin e cilësisë;
- ☐ njihet me një këndvështrim të jashtëm;
- ☐ marrë këshilla dhe zbulojë praktikatat e mira për zhvillimin e mëtejshëm të masës së përzgjedhur për sigurimin e cilësisë.

Personat e kontaktit në nivel kombëtar që marrin pjesë në këto vizita kanë rastin të:

- ☐ mësojnë rreth qasjes kombëtare për sigurimin e cilësisë dhe masës së përzgjedhur për këtë qëllim, të prezantuar nga institucioni pritës, anëtar i Forumit.
- ☐ praktikojnë dhënien e opinioneve kritike, por mbështetëse dhe konstruktive;
- ☐ angazhohen në mësimin e ndërsjellë me kolegët dhe përfaqësuesit nga institucioni pritës, anëtar i Forumit.

Qëllimet dhe parimet e vizitave të kolegëve në kuadrin e Forumit të ETF-së.

Kur bëhet fjalë për zhvillimin e vizitave të kolegëve, duhen marrë parasysh disa objektiva dhe parime të rëndësishme, si më poshtë:

- ☐ Organizimi dhe pjesëmarrja në vizitën e kolegëve është vullnetare.
- ☐ Vizitat e kolegëve fokusohen në punën e institucioneve anëtare të Forumit të ETF-së të përfshira, si dhe në interesat dhe nevojat e tyre bazuar në qasjet e sigurimit të cilësisë të përdorura nga ata në nivel sistemi të AFP-së.

- ❑ Institucionet pritëse, anëtare të Forunit, duhet të synojnë të evidentojnë si pikat e forta ashtu edhe pikat e dobëta të masës së përzgjedhur për sigurimin e cilësisë.
- ❑ Institucioni pritës, anëtar i Forunit, merr vendimin për përdorimin e komenteve dhe vërejtjeve të marra nga kolegët.
- ❑ Kolegët bëjnë komentet/vërejtjet e tyre në mënyrë sa më objektive dhe të paanshme, duke marrë parasysh pikat e forta dhe të dobëta të masave të vëzhguara për sigurimin e cilësisë.

## Organizimi

Vizita e kolegëve përbëhet nga katër faza.

### Faza 1 – Përgatitja e vizitës së kolegëve

Gjatë fazës përgatitore, vizita e kolegëve planifikohet dhe organizohet nga institucioni pritës, anëtar i Forunit, me palët e interesuara përkatëse. Ky institucion përgatit raportin në lidhje me kontekstin kombëtar, i cili është dokumenti themelor që ofron informacion bazë për të gjitha çështjet që lidhen me vizitën e kolegëve. Kolegët duhet të jenë të informuar dhe të përgatitur për rolin dhe detyrat e tyre.

### Faza 2 – Vizita e kolegëve

Kjo është faza e zhvillimit të vizitës së kolegëve. Institucioni pritës, anëtar i Forunit, prezanton qasjen e tij për sigurimin e cilësisë në nivel sistemi të AFP-së, duke e vënë theksin tek masa e përzgjedhur për sigurimin e cilësisë e cila do të vëzhgohet në kuadrin e vizitës së kolegëve. Kolegët vizitojnë institucionin pritës dhe institucionet e tjera përkatëse, dëgjojnë prezantime dhe forma të tjera të kontributesh, vëzhgojnë dhe krijojnë një perceptim më të thellë të masës së sigurimit të cilësisë së përzgjedhur nga institucioni pritës, anëtar i Forunit, për t'u vlerësuar nga kolegët.

### Faza 3 – Procesi i reagimit/vërejtjeve gjatë vizitës së kolegëve

Gjatë fazës 3, kolegët japin mendimin e tyre dhe vlerësojnë institucionin pritës, anëtar të Forunit, gjatë një seance përmbyllëse me diskutime të vizitës së zhvilluar. Në këtë seancë të fundit, kolegët bëjnë vërejtjet e tyre, shoqëruar edhe me sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të punës në lidhje me zbatimin e masës së sigurimit të cilësisë tek institucioni pritës si anëtar i Forunit.

### Faza 4 – Ndjekja e mëtejshme

Në fazën e fundit të procedurës së vizitës së kolegëve, puna fokusohet në analizimin dhe përdorimin e vërejtjeve/sugjerimeve si bazë për përmirësimin e punës në nivel sistemi të AFP-së.

## *8.2. Vëzhgimi i punës së kolegëve në praktikë nga inspektorët për të përmirësuar cilësinë e punës – Holandë*

Autor: Herman Franssen

Pjesëmarrja e plotë në shoqërinë holandeze dhe flamande nuk është e mundur pa zotëruar aftësitë bazë si shkrim-leximi dhe numërimi. Studimet mbi kompetencat bazë kanë treguar se rritja e nivelit të përvetësimit të tyre kontribuon si në rritjen ekonomike ashtu edhe në zhvillimin social (lufta kundër varfërisë).

Si në Holandë ashtu edhe në Flanders, aftësitë bazë janë nën tryzni. Inspektorati Flamand i Arsimit, në raportin e tij vjetor, është shprehur se performanca e nxënësve sa i takon aftësive bazë për gjuhën holandeze dhe matematikën është në rënie dhe se është vënë re një pabarazi në rritje sa i takon mundësive. Inspektorati Flamand ka evidentuar edhe ekzistencën e dallimeve të konsiderueshme cilësore midis shkollave në arritjen e rezultateve të mira në fushën e aftësive bazë. Edhe në raportin 'Gjendja e Arsimit', të përgatitur nga Inspektorati Hollandez, përshkruhen pengesat me të cilat përballet sistemi arsimor, pengesa të ngjashme edhe me situatën në Flanders, përkatësisht rënia e performancës së nxënësve për aftësitë bazë dhe rritja e pabarazisë së mundësive për shumë nxënës. Në Holandë, gjithashtu, ka dallime (shumë) të mëdha në aspektin e cilësisë ndërmjet shkollave në sektorë të ndryshëm: arsimit fillor, arsimit mesëm dhe arsimit mesëm i lartë profesional.

Për të garantuar rritjen e numrit të nxënësve të aftë dhe të kualifikuar në momentin e përfundimit të shkollës, si Inspektorati Flamand i Arsimit ashtu edhe Inspektorati Hollandez i Arsimit janë duke punuar për monitorimin e cilësisë së arsimit. Të dy inspektoratet dëshirojnë të përqendrohen (më shumë) gjatë viteve të ardhshme në aktivitetet që synojnë përmirësimin e cilësisë së arsimit në lidhje me aftësitë bazë. Kur dy sisteme arsimore përballen me sfida të ngjashme është e rëndësishme që ato të adresohen duke përdorur perspektivën ndërkombëtare në lidhje me to. Çfarë mund të mësojnë organizatat inspektuese nga njëra-tjetra? Si mund të bëhet e mundur mbikëqyrja strategjike nga të dy inspektoratet bashkë për të kontribuar në zgjidhjen e problematikave me të cilat përballen shkollat dhe institucionet? Si mund të përmirësohet promovimi i aftësive bazë dhe si mund të forcohen inspektoratet nëpërmjet bashkëpunimit me njëri-tjetrin në këtë drejtim?

Si Inspektorati Hollandez i Arsimit ashtu edhe Inspektorati Flamand i Arsimit kanë në strukturën e tyre një departament ndërkombëtar. Nga bashkëpunimet e mëparshme ndërkombëtare lindi dëshira për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit. Si fillim u organizua një konferencë e përbashkët pune për Aftësitë Bazë. Për ta thelluar dhe zgjeruar më tej këtë nismë, puna do të vijojë nëpërmjet zbatimit të një projekti tjetër i fokusuar në shkëmbimin intensiv përmes vëzhgimit në praktikë të punës së inspektorëve kolegë.

Aftësitë bazë janë një nga fushat që shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme nga inspektorët gjatë inspektimeve/vlerësimeve të shkollës. Projektet e shkëmbimit i njohin inspektorët me mënyrën se si inspektorati holandez (IvhO) dhe ai flamand (VOI) i shqyrtojnë në praktikë aftësitë bazë gjatë mbikëqyrjes në nivel shkolle, bordi dhe sistemi. Duke u angazhuar në sesionet e vëzhgimit në praktikë të punës së inspektorëve kolegë, të paktën 40 inspektorë të arsimit flamand/holandez nga arsimit fillor dhe i mesëm do të kenë mundësinë të marrin pjesë në një inspektim të zhvilluar së bashku me kolegët e tyre të huaj.

Në këtë mënyrë, inspektorët njihen me tregues të tjerë, aftësi dhe kritere vlerësimi që përdoren në vendin partner. Ata përgatisin një raport individual ku reflektojnë njohuritë dhe përvojat e fituara në vendin tjetër.

Inspektorët do të fitojnë njohuri në nivel individual, por kjo përvojë do t'iu shërbejë edhe për zhvillimin e mbikëqyrjes në vendin e tyre.

Së pari, vëzhgimi i punës së kolegëve në praktikë brenda sektorit të tyre arsimor krijon mundësinë që çdo inspektor i përfshirë të përballë konkretisht me mënyrën se si ofrohen dhe monitorohen aftësitë bazë gjatë mbikëqyrjes në vendin partner. Inspektorët mësojnë nga njëri-tjetri nëpërmjet pranisë së tyre, vëzhgimit të kolegut të huaj dhe pjesëmarrjes në inspektimin e shkollës. Përveç kësaj, përvoja e fituar transmetohet edhe në organizatën e inspektimit me qëllim optimizimin e kornizës së tyre të vlerësimit të aftësive bazë, aty ku është e nevojshme. Në të vërtetë, përmes këtij aktiviteti, inspektorët pjesëmarrës mund të reflektojnë dhe të bëjnë vërejtje në lidhje me kornizat ekzistuese. Ata rrisin njohuritë e tyre dhe kuptojnë më mirë atë që po ndodh në terren. Bazuar në raportet (duke përdorur një format fiks) e inspektorëve pjesëmarrës në këtë shkëmbim dhe në përvojat e tyre, inspektoratet pjesëmarrëse mund të ndër marrin hapa të mëtejshëm në punën për zhvillimin e mbikëqyrjes.

Raportet duhet të paktën t'u përgjigjen tre pyetjeve të mëposhtme:

1. Përshtypja e përgjithshme: çfarë ra më shumë në sy gjatë veprimtarisë së mbikëqyrjes?
2. Si u përfshinë aftësitë bazë në veprimtarinë e mbikëqyrjes?
3. Çfarë mësuar nga qasja e përdorur për ofrimin e aftësive bazë gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse ku keni marrë pjesë?

Për inspektorët që marrin pjesë në shkëmbimin dhe vëzhgimin në praktikë të kolegëve gjatë vlerësimit të aftësive bazë, kjo ndikon jo vetëm në rritjen e kompetencave të tyre personale, por shërben edhe si një përvojë që vlen të ndahet me organizatën e tyre.

Ky projekt financohet nga projekti Erasmus+.

## 9. Digjitalizimi i proceseve

### 9.1. Digjitalizimi i proceseve për raportin e vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së – Kosovë\*

Autor: Donjeta Nimani Binçe

Korniza Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë (KKSC), si një grup standardesh dhe udhëzuesish për të promovuar dhe garantuar cilësinë e arsimit dhe formimit profesional në të gjithë vendin, zbatohet nga Institucionet Arsimore dhe Institucionet e Formimit Profesional që zbatojnë edhe Njohjen e Të Nxënit të Mëparshëm (*RPL*), si dhe institucionet që zbatojnë të nxënit nëpërmjet punës (*WBL*). Institucione zbatuese mund të jenë të gjitha shkollat publike të AFP-së, por edhe institucionet e tjera publike dhe private.

Me qëllim përmbushjen e standardit të cilësisë, Raporti i Vetëvlerësimit përdoret për të vlerësuar performancën e ofruesit të AFP-së për sa i përket cilësisë së ofertës arsimore dhe proceseve administrative. Raporti përfshin analizën e pikave të forta dhe të dobëta të ofruesit të AFP-së, vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve të tij dhe rekomandime për përmirësim. Raporti plotësohet nga ofruesi i AFP-së dhe zakonisht shqyrtohet nga vlerësuesit e jashtëm.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të kërkuara sipas kritereve të cilësisë, institucioni duhet të vlerësojë çdo parim/tregues të cilësisë. Për këtë qëllim përdoret një sistem vlerësimi me numra që fillojnë nga 1 deri në

4. Çdo vlerësim dhe klasifikim duhet të mbështetet me një përshkrim të shkurtër dhe të bazohet në evidenca.

Në platformën elektronike të AKSC-së, e cila është ende në zhvillim e sipër, në rastin e vlerësimit të treguesve me notë 1 ose 2, do të shfaqet një hapësirë ku ofruesit do të përshkruajnë (shkurtimisht) dhe do të listojnë pikat e dobëta në lidhje me vlerësimin e tyre. Mangësitë e identifikuara do të transferohen automatikisht në seksionin e planit të përmirësimit.

Mënyra më efektive e hartimit të raportit të vetëvlerësimit është përfshirja e drejtuesve, mësuesve/trajnerëve, koordinatorëve të sigurimit të cilësisë, nxënësve/kandidatëve për nxënës, këshillave të ndryshëm, bizneseve etj.

E gjithë përfshirja e palëve të interesuara ndikon në cilësinë e punës, sepse çdo palë e interesuar kontribuon me informacion rreth çështjeve që ata i konsiderojnë si pika të forta ose të dobëta.

Monitorimi dhe vlerësimi online kërkon përdorimin efektiv të teknologjisë për të thjeshtuar procesin, për të garantuar transparencën dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve të interesuara. Këto teknologji, kur integrohen në mënyrë efektive, mund të kontribuojnë për zhvillimin e suksesshëm të një platforme për të përfituar nga përdorimi i teknologjive me burim të hapur.

Cikli i jetës së aktiviteteve në kornizën kombëtare të platformës së sigurimit të cilësisë për paraqitjen e raportit të vetëvlerësimit përbëhet nga të gjitha kriteret që janë të parashikuara në kuadrin legjislativ dhe në dokumente të tjera, përfshirë edhe aspekte të tjera teknike si llogaria e përdoruesve, privilegjet, etj.

**Shtojca:**

- Udhëzues (Dokumenti nr.1).
- Raporti i vetëvlerësimit (Dokumenti nr.2).

## 9.2. Zbatimi digjital i vizitës në terren - Bullgari

Autor: Aneliya Andreeva, PhD

Në Bullgari, procesi i inspektimit organizohet në tre faza – faza përgatitore, faza e zbatimit dhe faza përfundimtare. Faza përgatitore dhe ajo përfundimtare zhvillohen tërësisht në një mjedis elektronik (analizimi i dokumenteve të shkollës, organizimi i takimeve për diskutimin e gjetjeve, organizimi i vizitës në terren/institucion, përgatitja e raportit). Për përgatitjen e raportit, ekipi i inspektorëve punon mbi një dokument të përbashkët në një hapësirë të përbashkët për çdo inspektim individual.

Gjatë fazës së zbatimit, ndiqen tre modele:

- 1) vëzhgimi në terren i institucionit dhe i situatave/orëve të mësimit dhe realizimi i takimeve ballë për ballë (fokus grupe);
- 2) procesi i kombinuar – vëzhgimi në terren i institucionit dhe i situatave/orëve të mësimit dhe organizimi i fokus grupeve me përfaqësues të nxënësve, prindër, specialistë pedagogjikë dhe ekipin drejtues duke përdorur platforma dhe video-aplikacione;
- 3) tërësisht në një mjedis elektronik – të gjitha aktivitetet (vëzhgimet dhe takimet) zhvillohen duke përdorur platforma elektronike.

Shkollat përdorin platforma elektronike për mësimin në distancë. Mësimi online zhvillohet në mënyrë sinkrone, ku edhe mësuesi edhe nxënësit mbajnë kamerën ndezur. Mësimet monitorohen pasi inspektorit i jepet e drejta e hyrjes në platformën ose aplikacionin e përdorur nga mësuesi (*Microsoft Teams, Zoom, Google classroom, G-Suite for Education, Moodle*). Inspektori merr leje nga drejtori i shkollës për të ndjekur mësimin online. Inspektorët e shohin të gjithë ambientin e klasës dhe mund të vëzhgojnë edhe punën e mësuesit dhe të nxënësve. Vëzhgimi nuk zgjat më shumë se 20 minuta.



Vëzhgimi i institucionit kryhet përmes vëzhgimit në kohë reale, nëpërmjet materialeve filmike ose prezantimeve të parapërgatitura.

Takimet zhvillohen online në platformën e përdorur nga shkolla, si p.sh. *Microsoft Teams*. Menaxhimi i takimeve në këtë formë është më i vështirë, sepse nuk mund të ndërpriten folësit sa herë që është e nevojshme dhe pengohet komunikimi joverbal. Për sa i përket kohëzgjatjes, për takimet nevojiten 5-10 minuta më shumë për të angazhuar pjesëmarrësit dhe për të zgjidhur problemet teknike fillestare. Dinamika varet edhe nga cilësia e lidhjes në internet.

Për të bërë vlerësimin, përdoren treguesit e miratuar dhe kriteret e vlerësimit, pavarësisht nga mjedisi i kryerjes së inspektimit.

Katër inspektime janë kryer online deri më tani.

Figura 1.



- Vlerësimi **Shumë mirë** për treguesin e vlerësuar mbi 81% për të gjithë nëntreguesit e tij, siç tregohet nga instrumentet e inspektimit;
- Vlerësimi **Mirë** (midis 61% dhe 80%) nga të gjitha instrumentet e përdorura për nëntreguesit e treguesit;
- Vlerësimi **I kënaqshëm** - rezultati nga të gjitha instrumentet e përdorura midis 41% dhe 60%;
- Vlerësimi **Jo i kënaqshëm** - performanca për treguesin e vlerësuar nën 40% për të gjithë nëntreguesit, siç tregohet nga instrumentet e inspektimit.

**Shtojcë:**

- Fushat, kriteret, treguesit dhe mjetet/ instrumentet e inspektimit - Fusha e procesit arsimor.

*9.3. Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Inspektimit – Bullgari*

Autor: Aneliya Andreeva, PhD

Inspektorati Kombëtar Bullgar i Arsimit (IKA) kryen inspektime në kopshte dhe shkolla dhe vlerëson cilësinë e ofertës arsimore në tre fusha - "Procesi Mësimor", "Menaxhimi" dhe "Mjedisi institucional". IKA krijon dhe mirëmban sistemin elektronik të menaxhimit të inspektimit (EIMS): <https://insp.mon.bg>.

Informacioni për çdo institucion të inspektuar vihet në dispozicion në systemin elektronik EIMS sipas seksioneve të mëposhtme:

- *Home* - përmban informacion të përgjithshëm.
- Inspektimet - urdhri i inspektimit, në formën e materialit të bashkëlidhur me dokumentacionin shoqërues, periudha kohore e inspektimit dhe informacioni për ekipin e inspektimit, programi i inspektimit.
- Plotësimi i pyetësorëve dhe rubrikave/skedave mund të realizohet dhe plotësohet për të gjitha fushat e vëzhgimit nga të gjithë aktorët në proces, të cilët kanë nivelet e duhura të aksesit sipas funksionit/pozitës së tyre. (Figura 1).
- Portofoli - përmban të dhënat statike të transferuara nga Sistemi Kombëtar i Informacionit Elektronik për Arsimin Parashkollor dhe Shkollor (NEISPSE) në momentin e hapjes së inspektimit dhe të pajisura me hapësira bosh, që do të plotësohen nga institucioni arsimor i inspektuar për temat e mëposhtme, në menutë në vijim: Të dhëna për shkollën; Të dhëna për personelin; Të dhëna për nxënësit; Rezultatet e vlerësimit të jashtëm/ provimeve të maturës shtetërore; Dokumentet; Dokumente të tjera.

Instrumentet e përdorura janë nga më të ndryshmet – analizimi i dokumenteve të shkollës, anketat vëzhguese (për specialistët pedagogjikë, nxënësit dhe prindërit), fokus grupet (me specialistë pedagogjikë, nxënës, prindër dhe anëtarë të ekipit drejtues). Formulari elektronik (skeda e vlerësimit) përdoret për të hedhur rezultatet e analizave, vëzhgimeve, anketave dhe fokus grupeve.<sup>22</sup>

---

<sup>22</sup> Shkalla e zbatimit të treguesit të evidentuar nga grupi i inspektimit është rezultat i sintezës së informacionit, të dhënave dhe rezultateve nga përdorimi i instrumenteve të ndryshme që lidhen me mekanizmin e vlerësimit. Instrumentet e inspektimit përdoren nga inspektorët për të vlerësuar treguesit në platformën elektronike EPIM. Rezultati i vlerësimit vendoset si më poshtë:

1. Secili anëtar i grupit të inspektimit plotëson hartat për monitorimin e situatës pedagogjike/ orëve të mësimit në shkollë dhe monitorimin e institucionit arsimor, duke vlerësuar çdo çështje sipas fakteve të monitorimit, si shkalla e zbatimit.
2. Ekipi i inspektimit duhet të plotësojë një hartë të përbashkët për secilin nga takimet e mbajtura pasi të jetë arritur konsensusi nga të gjithë anëtarët e ekipit. Shkalla e zbatimit të secilit tregues diskutohet, duke patur parasysh shembujt specifikë të shkëputur nga aktivitetet e institucionit.
3. Anëtarët e ekipit të inspektimit plotësojnë së bashku një hartë të përgjithshme me informacion, pas arritjes në konsensus, mbi bazën e dokumenteve dhe informacionit të siguruar në fazën përgatitore dhe në përputhje me vëzhgimet e proceseve në fazën aktuale të inspektimit.
4. Në ditën e fundit të fazës aktuale të zbatimit/ vizitës në terren (kur kryen aktivitetet nga faza aktuale tërësisht në terren, në institucionin arsimor të inspektuar), ekipi i inspektimit vlerëson çdo tregues bazuar në rezultatet e vlerësimit të nëntreguesve. Ekipi i inspektimit shqyrton rezultatet e instrumenteve të përdorura dhe përcakton shkallën e zbatimit të treguesit, në përputhje me mekanizmin për vlerësimin e ofertës arsimore.
5. Niveli i zbatimit të secilit tregues përcaktohet nga drejtuesi i ekipit të inspektimit në EPIM pas diskutimit në ekip. Informacioni i mbledhur nga burime të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme vlerësohet në katër faza. Vlerësimi i secilit kriter është shuma e pikëve të të gjithë treguesve për të. Numri total maksimal i pikëve për secilin kriter dhe shpërndarja e pikëve sipas treguesve në të përcaktohet nga drejtori i IKA. Rezultati i secilit kriter llogaritet automatikisht nga EPIM pas vlerësimit të treguesve. Vlerësimi i çdo fushe individuale të inspektimit formohet si përqindje e shumës së pikëve të marra sipas kriterëve të veçanta deri në numrin maksimal të pikëve për fushën. Ai llogaritet automatikisht nga sistemi EPIM. Vlerësimi i përgjithshëm i ekspertëve të pavarur për cilësinë e ofertës arsimore të kopshtit ose shkollës përmban vlerësimet e marra cilësore të fushave për inspektim - procesi mësimor, menaxhimi dhe mjedisi institucional, të përcaktuara në nenin 6 të Direktivës №18, të lëshuar më 9 shtator, 2021 për inspektimin e kopshteve dhe shkollave.

Metodat matematiko-statistikore programohen në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Inspektimit, i cili llogarit automatikisht rezultatet e shkallës së performancës të hedhur në skeda. Në raportin e inspektimit, vlerësimi i çdo fushe të inspektimit duhet të shkruhet me fjalë - "shumë mirë", "mirë", "nivel i kënaqshëm", "nivel jo i kënaqshëm" dhe në përqindje - sipas shkallës dhe rezultateve të sistemit elektronik të menaxhimit të inspektimit (rezultatet e agreguara nga pikët e llogaritura në mënyrë automatike).

## Pjesa VI: Aspektet Mjedisore, Sociale dhe Gjinore

### 1. Përfshirja Sociale dhe Mirëqenia

#### 1.1. *Procesi i vlerësimit të mirëqenies, barazisë dhe përfshirjes sociale - Skoci*

Autor: Tracie McEwan

Që nga viti 2006, Skocia ka përdorur një qasje kombëtare për plotësimin e nevojave të fëmijëve nëpërmjet nismës *Getting it Right for Every Child* (GIRFEC). Kjo qasje përbën angazhimin tonë për t'u ofruar të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre mbështetjen e duhur në kohën e duhur, me qëllim që çdo fëmijë dhe i ri në Skoci të arrijë potencialin e tij të plotë. Ne duam që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të jetojnë në një shoqëri të barabartë që krijon mundësi që ata të lulëzojnë, të trajtohen me dashamirësi, dinjitet dhe respekt dhe t'iu respektohen të drejtat në çdo kohë.

Ambicia jonë është të punojmë së bashku me fëmijët, të rinjtë, familjet, organizatat dhe komunitetet për ta bërë Skocinë vendin më të mirë për rritjen e tyre. Nëpërmjet qasjes GIRFEC, të gjithë aktorët e interesuar në Skoci mund të punojnë së bashku për të ndërtuar bazën e mbështetjes që iu nevojitet fëmijëve dhe të rinjve për t'u rritur me dashuri, të sigurt dhe të respektuar.

GIRFEC shërben si një kornizë e qëndrueshme dhe si një gjuhë e përbashkët për promovimin, mbështetjen dhe ruajtjen e mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve në Skoci. Ajo është e rrënjësuar në nivel lokal dhe është përqaftuar pozitivisht nga organizatat, shërbimet dhe profesionistët në të gjitha strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për fëmijët.

*Getting it right for every child (GIRFEC) - gov.scot ([www.gov.scot](http://www.gov.scot)).*

Inspektorët e Madhërisë së Tij për Arsimin e përdorin këtë kornizë për vlerësimin e shkollave në lidhje me aspektin e 'Garantimit të mirëqenies, barazisë dhe përfshirjes' (PI 3.1 Sa e mirë është shkolla jonë? 4)

Sa e mirë është shkolla jonë? (Edicioni i 4-të) ([education.gov.scot](http://education.gov.scot))

Linku i mësipërm përmban një listë të pyetjeve më sfiduese që përdoren për të vlerësuar nivelin e ndihmës dhe mbështetjes të ofruar nga shkollat për të përmirësuar mirëqenien, barazinë dhe përfshirjen.

Temat që përfshihen në këtë tregues janë tre. E para është "mirëqenia". Inspektorët e Madhërisë së Tij vlerësojnë mënyrën e përdorimit nga shkollat të treguesve të mirëqenies të evidentuara në GIRFEC për të promovuar mirëqenien, barazinë dhe përfshirjen. Këto njihen si treguesit *SHANARRI*:

- I sigurt – rritja në një mjedis ku një fëmijë ose i ri ndihet i sigurt, i ushqyer, i dëgjuar dhe në gjendje për të zhvilluar potencialin e tij të plotë. Kjo përfshin mungesën e abuzimit ose neglizhencës.
- I shëndetshëm – ekzistenca e standardeve më të larta të arritshme të shëndetit fizik dhe mendor, qasja te kujdesi i duhur shëndetësor dhe mbështetja gjatë procesit të të nxënies për të bërë zgjedhje të shëndetshme dhe të sigurta.
- I përbushur – mbështetja dhe orientimi në procesin e të nxënies dhe në zhvillimin e aftësive, besimit dhe vetëvlerësimit, në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.
- I edukuar – rritja, zhvillimi dhe kujdesi në një mjedis që ofron sigurinë fizike dhe emocionale, dhembshurinë dhe ngrohtësinë e nevojshme për një rritje të shëndetshme dhe për të zhvilluar reziliencën dhe identitetin pozitiv.
- Aktiv – mundësitë për të marrë pjesë në aktivitete të tilla si loja, çlodhja dhe sporti, të cilat kontribuojnë në rritje dhe zhvillim të shëndetshëm në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.
- I respektuar – përfshirja dhe dëgjimi i zërit të tyre në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre, me mbështetje aty ku është e nevojshme.
- I përgjegjshëm – mundësitë dhe inkurajimi për të luajtur role aktive dhe të përgjegjshme në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet, dhe aty ku është e nevojshme, orientimi dhe mbikëqyrja e duhur.
- I përfshirë – ndihma për të kapërcyer pabarazitë dhe pranimi i tyre si pjesë e familjes, shkollës dhe komunitetit.

Në praktikë, të të treguesit mund të ndërlidhen dhe të mbivendosen me njëri-tjetrin. Kur përdoren së bashku, ato paraqesin një tablo holistike të situatës së çdo fëmije apo të riu. Ato e ndihmojnë fëmijën ose të riun, si dhe të rriturit që i mbështesin ata, për të kuptuar më mirë se cilat janë pikat e tyre të forta, si dhe për të parashikuar çdo pengesë të mundshme në rrugën e tyre drejt rritjes dhe zhvillimit.

*Wellbeing (SHANARRI) - Getting it right for every child (GIRFEC) - [gov.scot](http://gov.scot) ([www.gov.scot](http://www.gov.scot))*

Ky link ofron informacion në lidhje me vlerësimin e mirëqenies në të gjitha institucionet që punojnë me fëmijë dhe të rinj.

## *1.2. Standardet dhe treguesit për përfshirjen sociale - Serbi*

Autorë: Milja Krivokuća, Gordana Čaprić, Vesna Šaponjić

Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të një **sistemi arsimor të drejtë, të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës**, ku respektohet perspektiva e fëmijëve dhe ku nxënësit janë pjesëmarrës aktivë në procesin arsimor, në përputhje me nevojat dhe veçoritë e tyre që i dallojnë nga të tjerët. Prandaj, krijimi i një mjedisi sa më të sigurt dhe stimulues për të gjithë nxënësit, pavarësisht dallimeve të tyre përkatëse, është përgjegjësi e çdo shkolle. Rregulloret në fuqi rregullojnë mbështetjen shtesë arsimore, shëndetësore dhe sociale për fëmijët dhe nxënësit, dhe secila shollë ka një ekip arsimor gjithëpërfshirës, i cili duhet të planifikojë aktivitete në nivel institucioni, që kontribuojnë në përfshirjen e institucionit dhe ofrimin e mbështetjes specifike për nxënës të caktuar.

Përveç kësaj, për të garantuar përfshirjen e plotë të fëmijëve nga grupet me problematika sociale, ekzistojnë edhe disa rregullore që përcaktojnë masat që duhen marrë për të garantuar sjelljen jodiskriminuese nga ana e institucioneve (ato përshkruajnë konceptin e diskriminimit, metodën e parandalimit që përfshin zhvillimin e një programi për parandalimin e diskriminimit që çdo institucion duhet të ketë, si dhe masat e ndërhyrjes në rast të dyshimit për sjellje diskriminuese).

Me qëllim ofrimin e mbështetjes shtesë për institucionet, përveç mbështetjes këshillimore profesionale të ofruar nga konsulentët arsimorë dhe konsulentët e arsimit gjithëpërfshirës, janë punësuar edhe disa bashkëpunëtorë mësues/ekspertë si konsulentë për arsimin gjithëpërfshirës – bashkëpunëtorë të jashtëm.

Në përputhje me politikën e lartpërmendur arsimore, korniza për vlerësimin e cilësisë së punës shkollore në Republikën e Serbisë është, në një pjesë të mirë të saj, e ngopur me standarde dhe tregues që verifikojnë praninë e kulturës gjithëpërfshirëse në shkolla. Kështu, midis 24 standardeve të shpërndara në gjashtë fusha, rreth 10 prej tyre dëshmojnë drejtpërdrejt ekzistencën e praktikës gjithëpërfshirëse të konstatuar në pesë fusha vlerësimi. Për kryerjen e monitorimit të thelluar, krahas standardeve dhe treguesve të lartpërmendur, përdoren edhe burime të tjera të dhënash, si dhe Manuali i përgatitur posaçërisht për këto qëllime. Lista e standardeve dhe treguesve për verifikimin e praktikave gjithëpërfshirëse që përdoren në procesin e vlerësimit të shkollës është pjesë e këtij Manuali.

Dokumente dhe linqe të dobishme:

- [Rulebook on detailed instructions for determining the right to an individual education plan, its application and evaluation](#) (në gjuhën serbe)
- [Rulebook on quality standards of the institution's work](#) (në gjuhën serbe)
- [Manual: How inclusive is our school](#) (në gjuhën serbe)

### 1.3. *Njohja e pabarazive sociale dhe gjinore*

Manuali *'Njohja e pabarazive sociale në procesin arsimor – Manual për mësuesit, bashkëpunëtorët ekspertë dhe personat e tjerë të punësuar në sektorin e arsimit dhe formimit'* u publikua në kuadër të projektit *'Përmirësimi i Cilësisë në Arsim dhe Formim në Evropën Juglindore – EQET SEE'*, zbatuar nga Nisma e Evropës Juglindore për Reformën Arsimore (ERI SEE).

Qëllimi i Manualit është të ndihmojë të gjithë personat dhe autoritete që luajnë një rol caktuar në sektorin e arsimit dhe formimit, me ndikim mbi cilësinë e tij, për të kuptuar dhe njohur pabarazitë sociale, përfshirë pabarazitë gjinore, dhe për të ofruar zgjidhje të mundshme praktike.

Manuali u përgjigjet pyetjeve:

- Çfarë janë pabarazitë sociale dhe si krijohen ato?
- Si riprodhohen pabarazitë sociale?
- Cili është roli i arsimit dhe formimit në riprodhimin e pabarazive?
- Si mund të punohet në procesin e arsimit dhe formimit për të ulur pabarazitë sociale?

Manuali mund t'i ndihmojë vlerësuesit e jashtëm në punën për vëzhgimin e klimës sociale në shkolla, t'i ndihmojë ata të kuptojnë dhe të dallojnë pabarazitë, ndonjëherë të dukshme dhe nganjëherë të ndërthurura në mënyrë delikate në procesin arsimor, dhe t'i ndihmojë ata për të komunikuar me stafin e shkollës në lidhje me konkluzionet dhe rekomandimet e tyre.

Publikimin në fjalë me titullin në origjinal '*Understanding social inequalities in the education process – Handbook for teachers, expert associate and others employed in the education and training sector*' mund ta gjeni në: <https://eqet.erisee.org/project-outputs2/> dhe <https://www.erisee.org/eri-see-publications/>

## 2. Treguesit për tolerancën zero ndaj dhunës (përfshirë dhunën digjitale)

### 2.1. Sigurimi dhe monitorimi i sistemit që mbështet tolerancën zero ndaj dhunës – Serbi

Autorë: Milja Krivokuća, Snežana Vuković, Gordana Čaprić, Vesna Šaponjić

*Rregullorja për protokollin e veprimeve brenda institucionit si reagim ndaj dhunës, abuzimit dhe neglizhencës* e Republikës së Serbisë përcakton procedurat për mbrojtjen nga dhuna në shkollë. Kjo garanton marrjen e masave të vazhdueshme, si për sa i përket parandalimit të dhunës ashtu edhe ndërhyrjes në rastin e konstatimit të dhunës. Të gjitha shkollat në Serbi përdorin një përkufizim të përbashkët të dhunës. Dhuna dhe abuzimi nënkuptojnë të gjitha format e sjelljes verbale ose joverbale të konstatuara një herë ose në mënyrë të përsëritur që çojnë në rrezik real ose të mundshëm për shëndetin, zhvillimin dhe dinjitetin e një fëmije, nxënësi apo punonjësi. Kjo rregullore përcakton edhe format e ndryshme të dhunës (psikologjike, fizike, seksuale, digjitale, trafikimi i fëmijëve, ekstremizmi i dhunshëm, etj.), si dhe ndërhyrjet përkatëse sipas marrëdhënieve (kush janë të gjithë pjesëmarrësit në dhunë). Çdo institucion është i detyruar të miratojë një program vjetor për mbrojtjen nga dhuna, bazuar në raportin dhe analizën e situatës së shkollës në lidhje me këtë aspekt. Ky program duhet të jetë specifik, të përfshijë aktivitete specifike me afate të përcaktuara si dhe promotorët e aktiviteteve, me përfshirjen e burimeve lokale, për shembull, nga sistemi shëndetësor dhe i mbrojtjes sociale, policia, OJQ-të dhe institucionet e tjera në komunitetin lokal, të cilat mund të kontribuojnë për parandalimin e sjelljeve të rrezikshme të fëmijëve dhe të rinjve. Një shembull që vlen të përmendet këtu është puna e rrjetit të jashtëm mbështetës për shkollat, kur ndodhin situata në të cilat kërkohet jo vetëm rritja e punës edukative me fëmijën, por edhe ndërhyrja e qendrës për punë sociale që ofron mbështetjen e familjes.

Aktivitetet parandaluese kanë për qëllim zhvillimin e tolerancës zero ndaj dhunës tek të gjitha grupet e interesit në shkollë dhe mbështetjen e zhvillimit të të nxënësve social-emocional te fëmijët. Nëpërmjet programeve për zhvillimin profesional të punonjësve përmirësohen vazhdimisht kompetencat e punonjësve në institucionet arsimore për të mbështetur zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe për krijimin e një mjedisi shkollor stimulues në të cilin vlerësohen dhe promovohen vlerat e shoqërisë moderne demokratike, respekti reciprok, empatia, komunikimi jo i dhunshëm dhe antidiskriminimi (për shembull: programi për zhvillimin profesional të punonjësve "Të nxënësve social-emocional në funksion të mbështetjes së zhvillimit të personalitetit të nxënësve", programi "Aftësitë e adoleshencës", "Familje të forta ", etj.). Gjithashtu, edhe procedurat që duhet të ndiqen në këtë rast për reagimin ndaj dhunës janë të përcaktuara qartë dhe uniforme, në mënyrë që të garantohet tolerancë zero ndaj situatave të dhunës, pra të gjithë janë të detyruar të raportojnë dhe të reagojnë pavarësisht nga vendi ku ka ndodhur dhuna. Në rastin e dhunës mes bashkëmoshatarëve, nivelet e dhunës vlerësohen mbi bazën e disa kritereve të caktuara, mbi të cilat planifikohen edhe ndërhyrjet përkatëse, duke qenë se merren parasysh mosha, pasojat, kohëzgjatja, intensiteti, shpeshtësia etj.

*Në nivelin e parë*, mësuesi kujdestar ndërhyr në bashkëpunim me prindërit dhe klasën, ndërsa në *nivelin e dytë* përfshihet ekipi mbrojtës, dhe në *nivelin e tretë* përfshihen institucione të tjera. Çdo veprim që përfshin nxënësit nënkupton edhe punë pedagogjike më intensive përmes një plani të përcaktuar qartë që përmban elemente të caktuara dhe përfshin vlerësimin. Ligji parashikon edhe marrjen e masave edukative dhe disiplinore. Çdo shkollë ka një ekip mbrojtës i cili koordinon parandalimin, por edhe vepron në situata specifike të dhunës. Ekipi në fjalë monitoron dhe vlerëson veprimet e veta dhe zbatimin e masave parandaluese përmes përgatitjes së raporteve për zbatimin e programit. Ekipi përfshin edhe këshillin e prindërve dhe parlamentin e nxënësve në planifikimin e punës dhe të masave parandaluese.

Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së punës për mbrojtjen nga dhuna në shkolla kryhet nga konsulentët arsimorë me mbështetjen e konsulentëve - bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe nga konsulentët për mbrojtjen nga dhuna, bazuar në standarde dhe tregues të caktuar (shih linqet më poshtë me dokumentet shtesë) në fushën e Etikës shkollore dhe në materialet mbështetëse shtesë. Shkollat të cilat veprojnë në përputhje me Rregulloren garantojnë plotësimin e treguesve të vlerësimit të cilësisë.

Për të përmirësuar dokumentimin, monitorimin e masave të ndërmarra dhe bashkëpunimin më të mirë ndërsektorial, Qeveria e Republikës së Serbisë ka krijuar Platformën Kombëtare 'Čuvam te' ('Kujdesem për ty'), e cila mbulon të gjitha situatat e dhunës që përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë. Kjo platformë bën të mundur komunikimin mes shkollave dhe ministrisë, por edhe mes shkollave dhe institucioneve të tjera (qendra shëndetësore, Ministria e Brendshme, qendrat e punës sociale etj.), si dhe ndërmjet ministrive përgjegjëse. Nëpërmjet përdorimit të një formulari specifik në këtë platformë, shkollat hedhin të gjithë elementët dhe detajet e situatës që nevojiten për të monitoruar veprimet përkatëse, pra elementë të cilët, përveç përshkrimit të ngjarjes, përfshijnë edhe masat që ndërmerren shkolla dhe ato që planifikon të ndërmarren në të ardhmen. Shkollat janë të detyruara të informojnë ministrinë për veprimet e tyre në nivelin e tretë të dhunës mes bashkëmoshatarëve, si dhe për rastet e dhunës ku përfshihen mësuesit, nxënësit dhe prindërit (mësues-nxënës, nxënës-mësues, prindër-mësues).

Platforma ofron edhe trajnime të posaçme për nxënës, prindër dhe mësues, të cilët kanë funksion edukativ dhe i udhëzojnë ata në lidhje me procedurat përkatëse që duhen ndjekur.

Përveç kësaj, ministria organizon edhe trajnime me rëndësi kombëtare për zhvillimin e procedurave për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës, të cilat përfshijnë edhe zhvillimin e disa detyrave mbi bazën e të cilave kontrollohet niveli i njohurive të marra.

Linqe shtesë:

- [Law on Fundamentals of Education System](#) (Republika e Serbisë)
- [Rulebook on the Protocol of Actions at an Institution as a Response to Violence, Abuse and Neglect](#) (Republika e Serbisë)
- Burimet arsimore
  - <https://prosveta.gov.rs/kategorija/publikacije/>
  - <https://prosveta.gov.rs/wp-content/uploads/2022/02/C8Ka-sigurnom-i-podsticajnom-skolskom-okruzenju.pdf>
- [National platform “Cuvam te”](#)
- [Trainings of public importance – a learning platform](#)
- [Quality Standards of Educational Institutions](#): Fusha 5 e cilësisë. Etika shkollore – standarde dhe tregues që synojnë vlerësimin e mjedisit të sigurt për nxënësit në shkollë.

### 3. Treguesit për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta/shkollat speciale

#### 3.1. Treguesit për vlerësimin e ofertës arsimore për fëmijët me nevoja të veçanta/shkollat speciale – Holandë

Autor: Herman Franssen

Përshkrimi i mëposhtëm i ofertës arsimore për fëmijët me nevoja të veçanta fokusohet në arsimin bazë. Edhe sektorët e tjerë arsimorë përmbajnë informacion në lidhje me këtë temë.

Llojet e shkollave të arsimit bazë në Holandë janë nga më të ndryshmet. Përveç **shkollave të zakonshme të arsimit bazë**, ekzistojnë edhe **shkollat speciale për arsimin bazë** dhe **shkollat për arsimin special**.

#### **Shkollat e zakonshme tradicionale: arsimit i duhur në shkollën e arsimit bazë**

Çdo fëmijë duhet të ndjekë një shkollë që ofron arsim të përshtatshëm për talentet dhe aftësitë e tij. Rreth një në çdo pesë nxënës ka nevojë për ndihmë shtesë gjatë arsimit bazë. Duke patur parasysh këtë, shkollat e përshtatin mësimdhënien e tyre me zhvillimin individual të fëmijës. Ligji i ri, i miratuar me datë 1 gusht 2014, i ngarkon të gjitha shkollat me detyrën për të ofruar një vend të përshtatshëm për arsimimin e fëmijëve. Me ardhjen në fuqi të Ligjit për Arsimin e Duhur, qeveria kërkon të bëjë të mundur që çdo fëmijë të marrë shkollimin e duhur, që çdo fëmijë të ndjekë një **shkollë të zakonshme** ose nëse kjo nuk është e mundur, një **shkollë speciale**. Puna do të fokusohet në potencialin dhe nevojat arsimore të fëmijëve dhe jo në problematikat apo paaftësitë e tyre.

Nëse një nxënës ka vështirësi në të nxënë, shkolla mund të:

- përshtasë kurrikulën me vështirësinë përkatëse të nxënësit për të nxënë;
- përshtasë mësimin me nevojat e fëmijëve;
- zhvillojë orë mësimi shtesë.

Çdo shkollë duhet të ofrojë mbështetjen bazë të ofruar nga konsorciumi rajonal të cilit i përket. Brenda çdo konsorciumi, shkollat bien dakord në lidhje me shërbimet që do të ofrojnë, të tilla si:

- mbështetja për nxënësit me disleksi ose diskalkuli;
- parandalimi dhe trajtimi i problemeve të sjelljes;
- mbikëqyrja shtesë për nxënësit me inteligjencë nën ose mbi mesataren.

Korniza për mbikëqyrjen e shkollave të zakonshme tradicionale përmban standardet e cilësisë që lidhen me ofertën e duhur arsimore (përfshirë mbështetjen bazë). Këto standarde vlerësohen gjatë procesit të inspektimit të shkollave. Më poshtë gjeni disa shembuj të këtyre standardeve, ku disa elemente i referohen përshtatjes së ofertës arsimore me nevojat e fëmijëve.

### **Oferta mësimore 1: Programet mësimore/Kurrikulat**

Oferta mësimore i përgatit nxënësit për arsimimin e tyre të mëvonshëm dhe për pjesëmarrjen në shoqëri.

#### **Standardi bazë i cilësisë**

Shkolla përgatit nxënësit për arsimimin e tyre të mëvonshëm dhe pjesëmarrjen në një shoqëri demokratike. Ai ofron një kurrikulë të gjerë mësimore të bazuar në objektivat e caktuara,<sup>23</sup> në përputhje me standardet e referencës për aftësitë në shkrim-lexim dhe arithmetikë. Me kurrikulë/program mësimor nënkuptojmë përmbajtjen e të gjitha mësimëve, duke përfshirë mësimet e ofruara në mënyrë digjitale ose online. Kurrikula e ofruar nga shkolla është e përshtatur me nxënësit dhe është në përputhje me aftësitë (gjuhësore) të nxënësve dhe nevojat e tyre mësimore. Kur është e nevojshme, kurrikula e shkollës thellohet dhe zgjerohet ndërsa nxënësit përparojnë në rrugëtimin e tyre shkollor, duke krijuar mundësi që ata t'i nënshtrohen një procesi të pandërprerë zhvillimi. Kurrikula është e shënjestruar, koherente dhe e dallueshme. Për më tepër, shkolla siguron që kurrikula të shpërndahet në mënyrë të barabartë dhe koherente ndër vite.

Kurrikula/programi mësimor ndihmon për transmetimin e njohurive dhe rrënjësimit të respektit për vlerat themelore të një shteti demokratik dhe kontribuon për zhvillimin e aftësive sociale dhe qytetare, të cilat i ndihmojnë nxënësit për të qenë pjesë e shoqërisë dhe për të dhënë kontributin e tyre.

### **Oferta mësimore 2: Monitorimi i Arritjeve dhe Mbështetja e Nxënësve**

Shkolla monitoron zhvillimin e nxënësve dhe ofron orientim dhe mbështetje shtesë, aty ku është e nevojshme.

#### **Standardi bazë i cilësisë**

Informacioni mbi njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me arsimin mblidhet në mënyrë sistematike, që nga momenti i hyrjes së nxënësve në shkollë. Mbledhja e të dhënave (për vlerësimin) kryhet në mënyrë sistematike dhe të kujdesshme, duke përdorur teste të standardizuara për fushat lëndore të gjuhës dhe matematikës. Shkolla përdor një sistem të veçantë për të mbledhur dhe regjistruar (vlerësuar) të dhënat për nxënësit. Shkolla krahason informacionin e mbledhur me zhvillimin e pritshëm të nxënësve. Kjo bën të mundur që shkolla të përshtasë mësimdhënien e saj me nevojat mësimore si të grupeve ashtu edhe të individëve dhe të sigurojë zhvillimin dhe mbështetjen e nxënësve. Prandaj, shkolla mund të garantojë përparimin dhe zhvillimin e pandërprerë të nxënësve të saj, duke promovuar edhe

<sup>23</sup> Shkollat në Frizlend iu mësojnë nxënësve gjuhën friziane, duke respektuar objektivat e caktuara, përveç rasteve kur janë përjashtuar nga kjo ofertë nga Organi Ekzekutiv i Provincës.

mundësitë e barabarta. Shkolla informon rregullisht prindërit në lidhje me zhvillimin dhe përparimin e fëmijës së tyre.

Nëse nxënësit individualë ose grupet e nxënësve nuk duket se po përfitojnë siç duhet nga arsimimi i tyre, shkolla identifikon fushat ku është konstatuar kjo prapambetje dhe arsyen/t e saj. Më pas shkolla vendos në lidhje me mënyrën më të mirë të reagimit në fusha të caktuara, si për nxënësit që kanë mbetur mbrapa ashtu edhe për ato që kanë përparuar më shpejt se parashikimi. Shkolla ofron mbështetje në mënyrë të strukturuar. Kur është e nevojshme, shkolla përfshin partneritetin ndërinstytucional, bashkinë dhe autoritetet shëndetësore për mbështetjen e nxënësve të saj.

Kjo u jep nxënësve mbështetjen që u nevojitet për të përfunduar shkollimin e tyre në mënyrë sa më efektive. Fokusi i punës së shkollës për të parandaluar prapambetjen e fëmijëve është i qartë dhe i strukturuar.

Shkolla ka përcaktuar vizionin e saj për këto aktivitete dhe ka përshkruar edhe mundësitë që mund të ofrojë në formën e një plani mbështetës për nevojat e veçanta. Për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë, shkolla ka hartuar një plan zhvillimi ku përcaktohet edhe mënyra e përshtatjes së ofertës arsimore me nevojat e nxënësve; shkolla e dokumenton këtë plan zhvillimi në BRON. Shkolla ofron mbështetjen sipas planit. Përmbajtja dhe zbatimi i këtij plani vlerësohet me prindërit të paktën çdo vit shkollor. Shkolla përmbush detyrën e saj për ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës. Nëse shkolla nuk është në gjendje të sigurojë mbështetjen e nevojshme shtesë për një nxënës, së bashku me prindërit e fëmijës dhe, nëse është e nevojshme, me partneritetin ndërinstytucional, ajo kërkon një shkollë ose qendër tjetër arsimore të përshtatshme.

### **Oferta mësimore 3: Mësimdhënia (Strategjitë)**

Qasja pedagogjiko-didaktike e mësuesve është konceptuar në atë mënyrë që garanton që nxënësit të zhvillohen dhe të përparojnë dhe të jenë në gjendje ta bëjnë këtë pa ndërprerje.

### **Standardi bazë i cilësisë**

Në klasat e tyre mësuesit krijojnë një mjedis mësimor të shëndoshë dhe stimulues nga ana pedagogjike dhe didaktike, i cili bën që nxënësit të ndihen të sigurt dhe të përfshihen në mënyrë sa më aktive. Mësuesit kanë pritshmëri të larta për të gjithë nxënësit. Ato garantojnë menaxhimin e duhur dhe të rregullt të orës së mësimin dhe përdorimin efikas të kohës së mësimdhënies. Mësuesit sigurohen që nxënësit të kuptojnë qartë objektivin e orës së mësimin. Gjatë orëve të mësimin, ata monitorojnë nëse përparimi i nxënësve drejt objektivave mësimore është i mjaftueshëm dhe e përshtasin mësimdhënien e tyre sipas nevojës. Mësuesit shpjegojnë temën e mësimin në mënyrë të qartë dhe u japin nxënësve kohë të mjaftueshme për t'u ushtruar me materialin mësimor. Ata përshtatin udhëzimet, përpunimin dhe kohën e planifikuar të mësimdhënies me nevojat e të nxënësve të grupeve dhe të nxënësve individualë. Mësuesit bëjnë edhe vërejtjet përkatëse për secilin nxënës për detyrat e përfunduara dhe për angazhimin e tyre në procesin mësimor. Ata i nxisin nxënësit për të reflektuar në lidhje me zhvillimin e tyre.

Shih linkun më poshtë për kornizën e plotë.

*Special schools for primary education and schools for special education*

Shkollat duhet të sigurojnë një vend të përshtatshëm për të gjithë nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë. Ky mund të jetë një vend në arsimin e zakonshëm ose në arsimin special. Shkollat speciale të arsimit bazë kanë klasa më të vogla, në mënyrë që fëmijët të kenë mundësi të angazhohen më shumë në procesin mësimor. Shkollat e arsimit special janë shkolla të posaçme për fëmijët me aftësi të kufizuara, sëmundje kronike ose probleme serioze të sjelljes. Nxënësit në shkollat speciale të arsimit bazë mësojnë të njëjtat lëndë si fëmijët në shkollat e zakonshme të arsimit bazë. Arsimi special është për ato nxënës që kanë nevojë për mbështetje të specializuar ose intensive për shkak të një paaftësie ose çrregullimi. Për ndjekjen e arsimit special nje fëmijë duhet të marrë miratimin e strukturave përkatëse. Kjo quhet deklarata e pranueshmërisë. Rregulla të ndryshme pranimi zbatohen për fëmijët që kanë probleme me shikimin ose që janë të verbër, apo probleme me dëgjimin ose që janë të shurdhër.

Për inspektimet në shkollat speciale, Inspektorati përdor një kornizë specifike. Kjo kornizë ka të njëjtën strukturë si korniza për shkollat e zakonshme, por përmbajtja është e përshtatur me legjislacionin për arsimin special. Shih linkun më poshtë.

<https://english.onderwijsinspectie.nl/documents/publications/2021/11/30/inspection-framework-special-education>

Shtojcat:

- [Framework Primary education](#)
- [Framework Special education](#)

### 3.2. Treguesit për vlerësimin e praktikave gjithëpërfshirëse të shkollave – Portugali

Autorë: Isabel Barata dhe Rosa Micaelo

Në Portugali, arsimit gjithëpërfshirës është sinonim i barazisë dhe cilësisë, i cili promovon mundësitë e të nxënësve gjatë gjithë jetës për të gjithë, duke përfshirë edhe personat nga grupet në nevojë, dhe përbën një prioritet në kuadrin e politikave të arsimit publik. Udhëzimet kryesore ligjore përcaktojnë, paralelisht dhe në mënyrë plotësuese, kurrikulën për arsimin bazë dhe të mesëm si dhe rregulloren për arsimin gjithëpërfshirës.

Një nga përgjegjësitë ligjore të Inspektoratit për Arsimin dhe Shkencën (IASH) është monitorimi dhe vlerësimi i praktikave gjithëpërfshirëse të çdo shkolle, veçanërisht i mënyrës se si organizohet dhe menaxhohet kurrikula, duke synuar rritjen e efektivitetit të masave mbështetëse për procesin e të nxënësve dhe garantimin e arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë. Në të njëjtën mënyrë, objektivi parësor i vlerësimit të jashtëm të shkollave, i realizuar nga Inspektorati i Përgjithshëm për Arsimin dhe Kërkimin, është promovimi i cilësisë së mësimdhënies, të nxënësve dhe përfshirjes së të gjithë nxënësve, duke kontribuar kështu në punën për zbatimin e politikave për gjithëpërfshirjen.

Në Portugali, koncepti i arsimit gjithëpërfshirës siç përcaktohet në legjislacion është i gjerë. Të gjitha shkollat publike mirëpresin të gjithë nxënësit, pavarësisht nga gjendja e tyre personale dhe sociale, dhe atyre u kërkohet të njohin vlerën e diversitetit dhe të gjejnë mënyra për të përballuar këtë ndryshim.

Edhe në rastet kur konstatohen vështirësi më të mëdha në pjesëmarrjen e nxënësve në programin mësimor/kurrikul, secila shkollë është përgjegjëse për përcaktimin e procesit me anë të të cilit identifikon pengesat ndaj procesit të të nxënësve me të cilat përballet nxënësi, duke përdorur një sërë strategjish për kapërcimin e tyre. Shkollat ofrojnë shtigje të diferencuara që bëjnë të mundur përparimin e çdo nxënësi në kurrikulë/programin mësimor drejt suksesit të tyre arsimor bazuar në potencialin e tyre.

Pra, nuk ekziston një model i vetëm i shkollës gjithëpërfshirëse, dhe për këtë arsye procesi i vlerësimit të jashtëm të shkollave e njih dhe e pranon autonominë e shkollave dhe të profesionistëve të tyre për përshtatjen e proceseve mësimore me karakteristikat dhe kushtet individuale të çdo nxënësi, duke mobilizuar burimet ekzistuese për të garantuar që të gjithë të mësojnë.

Treguesit e kornizës së vlerësimit të jashtëm të shkollave (linqet më poshtë) e orientojnë ekipin e vlerësimit për të kuptuar nivelin e gjithëpërfshirjes së shkollave, duke pranuar diversitetin e konteksteve dhe reagimet në nivel arsimor. Shumëllojshmëria e këtyre reagimeve të ofruara nga shkollat për të përmbushur nevojat specifike të nxënësve të tyre (bashkëlidhur) pasqyrohet në raportet përkatëse.

Këta tregues përfshijnë të katër fushat e kornizës, siç tregohet më poshtë:

- 1) Vetëvlerësimi – “Dëshmi e kontributit të vetëvlerësimit në përmirësimin e arsimit gjithëpërfshirës (zbatimi i masave kurrikulare, shpërndarja e burimeve dhe funksionimi i strukturave mbështetëse)”.
- 2) Udhëheqja dhe menaxhimi – “Inkurajimi i pjesëmarrjes në shkollë nga aktorë të ndryshëm arsimor” dhe “Partneritetet me institucione të tjera dhe agjentë të komunitetit që mobilizojnë burimet, duke promovuar kështu cilësinë e të nxënësve”.

3) Ofrimi i shërbimeve arsimore – “Masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga sjelljet e rrezikshme”; “Praktikat për organizimin dhe menaxhimin e kurrikulës dhe të të nxënit për arsimin gjithëpërfshirës”; “Përcaktimi i masave për të mbështetur procesin e të nxënit dhe gjithëpërfshirjen, që promovojnë mundësi të barabarta për qasjen tek programet mësimore”; “Masat për përmirësimin e rezultateve të fëmijëve dhe të nxënësve në rrezik, siç janë ata me prejardhje të pafavorshme social-ekonomike”; dhe “Efektiviteti i masave të marra nga shkolla për të përfshirë prindërit ose kujdestarët në monitorimin e përparimit arsimor të nxënësve të tyre”.

4) Rezultatet – “Rezultatet e nxënësve me prejardhje social-ekonomike të pafavorshme, prejardhje nga familje emigrantësh dhe nga grupe të ndryshme kulturore”.

**Shtojcat:**

- Korniza e vlerësimit të jashtëm të shkollave me treguesit e gjithëpërfshirjes të evidentuar.
- Shembuj të praktikave gjithëpërfshirëse në raportet e vlerësimit të jashtëm të shkollave.

## 4. Aspektet mjedisore

### 4.1. Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm – Projekti EQET SEE

Manuali 'Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm – Si të Përmirësojmë Performancën Mjedisore në Shkollat' u hartua në kuadrin e projektit 'Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit dhe Formimit në Evropën Juglindore – EQET SEE', zbatuar nga Nisma e Evropës Juglindore për Reformën Arsimore (ERI SEE), në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm në arsimin para-terciar nga Evropa Juglindore dhe Republika e Moldavisë, dhe me financim nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

Manuali për Zhvillimin e Qëndrueshëm është i ndarë në disa segmente:

- Prezantimi i konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Konceptet dhe strategjitë e qëndrueshmërisë dhe edukimit;
- Shkollat – arena e edukimit mjedisor;
- Shkollat si modele për qëndrueshmëri;
- Auditimi i Gjellbër i Shkollës.

Auditimi i Gjellbër i Shkollës përmban një listë kontrolli për shkollat që i ndihmon ato për të krijuar një shoqëri të qëndrueshme, si dhe rekomandime praktike për përmirësimin e mëtejshëm të punës në këtë aspekt. Ai është, në të njëjtën kohë, një mjet praktik për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm për të kuptuar sa 'e gjellbër' është një shkollë dhe çfarë mund të bëhet për të përmirësuar situatën. Si i tillë, ai është pjesë e fushave të sigurimit të cilësisë që kanë të bëjnë me etikën dhe kontekstin në të cilin funksionojnë shkollat dhe mund të përdoret për të vlerësuar performancën e shkollave në këto fusha të veçanta, duke i transformuar shkollat në modele për qëndrueshmëri.

Manuali mund të gjendet në linqet e mëposhtme: <https://eqet.erisee.org/project-outputs2/> dhe <https://www.erisee.org/eri-see-publications/>

---

\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe me mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.